



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE

# **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030**

**First Final Draft**

*Tetor 2023*

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>I.</b>	<b>KUADRI I PËRGJITHSHËM.....</b>	<b>4</b>
1.1.	KONTEKSTI EKONOMIK.....	4
1.2.	KONTEKSTI SOCIAL .....	8
1.3.	KONTEKSTI REFORMUES .....	10
1.4.	KONTEKSTI GJINOR .....	16
1.5.	PËRBALLJA ME EMERGJENCAT DHE SITUATAT E KRIZAVE .....	18
1.6.	KONTEKSTI STRATEGJIK.....	19
1.7.	KONTEKSTI INSTITUCIONAL .....	23
1.8.	KONTEKSTI LIGJOR .....	25
<b>II.</b>	<b>SITUATA AKTUALE E MBROJTJES SOCIALE NË SHQIPËRI.....</b>	<b>28</b>
2.1.	REFORMA E NDIHMËS EKONOMIKE DHE PËRFITIMEVE TË TJERA .....	28
2.2.	SKEMAT E MBËSHTETJES PËR AFTËSINË E KUFIZUAR.....	32
2.3.	SHËRBIMET E KUJDESIT SOCIAL DREJT DECENTRALIZIMIT, DIVERSIFIKIMIT DHE DEINSTITUCIONALIZIMIT .....	35
<b>III.</b>	<b>VIZIONI, SHTYLLAT OSE FUSHAT STRATEGJIKE DHE QËLLIMET E POLITIKAVE.....</b>	<b>40</b>
3.1.	VIZIONI.....	40
	<b>“MBROJTJE SOCIALE NË NJË MJEDIS MUNDËSUES DHE FUQIZUES PËR ÇDO INDIVID NË NEVOJË, DUKE GARANTUAR JETESË DINJITOZE PËRGJATË CIKLIT TË JETËS”.</b>	<b>40</b>
3.2.	QËLLIMET E POLITIKËS .....	40
	<i>Qëllimi i politikës A: Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të përgjegjshme gjinore, transparente për fuqizim dhe integrim, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave. ....</i>	<i>40</i>
	Objektivi specifik/strategjik A1: Të përmirësohet performanca, përshtatshmëria dhe përgjigjja ndaj krizave e skemave financiare për individët (burra, gra, djem dhe vajza) në skemën e ndihmës ekonomike.....	40
	Objektivi specifik/strategjik A2: Konsolidimi i vlerësimit bio-psikosocial dhe një sistem i qëndrueshëm dhe i mirëshënjestruar për Personat me Aftësi të Kufizuara. ....	40
	Objektivi specifik/strategjik A3: Përmirësimi i shënjestrimit të fëmijëve, vajza dhe djem përmes skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët .....	40
	<i>Qëllimi i politikës B: Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore si dhe avancimi i deinstitutionalizimit, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë. ....</i>	<i>45</i>
	Objektivi specifik/strategjik B.1: Konsolidimi i procesit të decentralizimit të shërbimeve të kujdesit social për financim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm gjinor, mbulim gjeografik, aksesueshmëri dhe që i përgjigjen krizave dhe emergjencave. ....	45
	Objektivi specifik/strategjik B.2: Zbatimi i standardeve dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore të personelit të shërbimeve të kujdesit social për shërbime efektive dhe të përgjegjshme gjinore.....	45
	Objektivi specifik/strategjik B.3: Deinstitutionalizimi i shërbimeve të kujdesit rezidencial dhe zhvillimi i shërbimeve në familje, komunitare dhe ditore duke respektuar parimin e të drejtave dhe lentet gjinore.....	45
<b>IV.</b>	<b>LLOGARIDHËNIA, MONITORIMI DHE ANALIZAT VLERËSUESE .....</b>	<b>50</b>
<b>V.</b>	<b>MONITORIMI DHE VLERËSIMI.....</b>	<b>51</b>
<b>VI.</b>	<b>BURIMET FINANCIARE PËR ZBATIMIN E STRATEGJISË .....</b>	<b>52</b>
<b>VII.</b>	<b>SHTOJCAT.....</b>	<b>53</b>

## SHKURTIMET

BE	Bashkimi Evropian
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
SHSSH	Shërbimi Social Shtetëror
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave Rajonale
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPSHS	Strukturat e posaçme të shërbimeve sociale
AKPA	Agjensia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësimit Profesional
PBA	Plani Buxhetor Afatmesëm
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
NE	Ndihma Ekonomike
SHIS	Shërbime të Integruara Sociale
SILK	Niveli i matjes së të ardhurave dhe kushteve të jetesës sipas BE-së
PPA	Përfitimi i Pagesës së Aftësisë
PBA	Projekt Buxheti Afatmesëm

## I. Kuadri i përgjithshëm

### 1.1. Konteksti ekonomik

**Rritja ekonomike.** Prej vitit 2019, ekonomia shqiptare ka mundur të përballojë disa kriza dhe të sigurojë një rritje të kënaqshme. Termeti i vitit 2019 dhe situata pandemike e krijuar nga Covid 19 shkaktuan rënien ekonomike prej 3.5% në vitin 2020. Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) pësoi rritje të ndjeshme në vitin 2021 (8.5%) dhe ndonëse lufta në Ukrainë krijoi kushte të pafavorshme për ekonominë për shkak të krizës në tregun e mallrave dhe të shërbimeve dhe rritjes së inflacionit (mesatarisht 7.4% në vitin 2022), ekonomia shqiptare ishte e aftë të rritej me 3.7% për vitin 2022<sup>1</sup>. Ekonomia pritet të rritet edhe në vitet në vijim, përkatësisht 3.8, 3.9 dhe 4.0 për qind, respektivisht për vitet 2024, 2025 dhe 2026<sup>2</sup>. Inflacioni parashikohet të rikthehet gradualisht në nivelin 3% në fund të vitit 2023 dhe të qendrojë në këtë nivel në periudhën afatmesme 2024–2026. Rritja ekonomike në periudhë afatmesme parashikohet të jetë kryesisht rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme, pra konsumit privat dhe investimeve të brendshme. Kërkesa e jashtme neto pritet të ketë kontributin e saj kryesisht për shkak të rritjes së eksporteve, veçanërisht nga turizmi, por rritja e parashikuar importeve pritet ta zbehtë këtë efekt. PBB për vitin 2022 ishte 6,757 USD për frymë krahasuar me 4,579 USD në vitin 2014.

Kontributi kryesor në rritjen e PBB i atribuohet zgjerimit të aktivitetit në sektorin e shërbimeve dhe të ndërtimit, ndërkohë që sektorët e industrisë dhe të bujqësisë kanë patur një ecuri më të ngadaltë dhe më të luhatshme. Rritja e kërkesës së brendshme ka buruar nga konsumi privat, ndërsa ecuria e investimeve ka qenë e luhatur në varësi të ecurisë së sektorit të ndërtimit (rritja e konsumit privat në vitin 2022 ishte 8.4% ndërsa norma mesatare e investimeve u rrit me 4.6%).

**Investimet e Huaja Direkte.** Fluksi i IHD-të është rritur ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit - i nxitur, ndër të tjera, nga reformat për përmirësimin e klimës së investimeve. Në vitin 2022, fluksi i IHD-ve arriti në rreth 1.44 miliard USD<sup>3</sup>. FDI-të neto përbëjnë 7.3% të PBB-së – një nga vlerat më të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor<sup>4</sup>. Kontribues në rritje kanë qenë kryesisht sektorët e “Pasurive të paluajtshme”, “Energjisë”, “Industrië nxjerrëse” dhe “Industrië përpunuese”, me ndikime pozitive me bazë të gjerë edhe nga degët e tjera. Burimi kryesor i IHD-ve në këtë periudhë, ka ardhur nga ri investimi i fitimeve të kompanive, duke reflektuar rentabilitetin e investimit në ekonomi. Vendet e BE-së (Zvicra - 18.9% të stokut, Holanda - 16.2%, Italia- 9.6 % dhe Turqia -7.2 %) zënë 54.2% të stokut total të IHD-ve. Burim i rendësishëm mbetet gjithashtu Kanadaja - 12.8 %<sup>5</sup>.

Klima e investimeve në Shqipëri është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Sipas Indeksit 2019 të OECD-së për Kufizimet Rregullatore të IHD-ve, regjimi i IHD-ve në Shqipëri është më pak kufizues se sa mesatarja e OECD-së apo ekonomisë së BE-së, por më pak i hapur ndaj IHD-ve se sa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor<sup>6</sup>. Niveli i kreditimit për ekonominë mbetet i ulët. Në vitin 2022 ai ishte 34% e PBB, cka është dhe një nga shifrat më të ulta të kreditimit në ekonomi në vendet e Ballkanit Perëndimor, por njëkohësisht dhe një potencial i rendësishëm financiar në dispozicion të rritjes ekonomike në vitet që vijnë.

<sup>1</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ekonomia në fokus, Dhjetor 2022.

<sup>2</sup> VKM 31 datë 27.01.2023 “Për miratimin e kuadrit makroekonomik e fiskal për periudhën 2024-2026”.

<sup>3</sup> Banka Botërore, <https://www.macrotrends.net/countries/ALB/albania/foreign-direct-investment>.

<sup>4</sup> Banka Botërore

<sup>5</sup> Banka e Shqipërisë, Raporti vjetor 2022.

<sup>6</sup> Indeksi 2019 i OECD-së për Kufizimet Rregullatore të IHD-ve i cili mat kufizimet ligjore në investimet e huaja direkte në 22 sektorë të ekonomisë në 69 vende. Kufizimet vlerësohen me një shkallë nga 0 (të hapura) në 1 (të mbyllura) Rezultati i përgjithshëm i Shqipërisë është 0.057 krahasuar me nivelin mesatar të OECD 0.064

**Të ardhurat buxhetore.** Të ardhurat totale të buxhetit për tre vjetët në vijim (2024–2026) parashikohet të rriten mesatarisht me rreth 3.7% në çdo vit. Më specifikisht 0.7% për vitin 2024; 4.9% për vitin 2025; dhe 5.5 % për vitin 2026. Të ardhurat tatimore për këtë periudhë parashikohen me një rritje mesatare vjetore prej rreth 4.9%. Burimet totale të qeverisë për t'u shpenzuar gjatë viteve 2024–2026 pritet të jenë mesatarisht 729.2 miliardë lekë në çdo vit ose mesatarisht rreth 30.3 për qind e PBB-së. Investimet publike janë programuar të mbahen në nivelin mesatar 5.1% të PBB-së në çdo vit (ato vetëm nga qeveria qendrore, pa përfshirë ato nga qeveria lokale), i cili konsiderohet një nivel i përshtatshëm për mbështetjen e një rritje ekonomike të lartë e të qëndrueshme.

Pavarësisht parashikimeve pozitive për rritjen ekonomike të Shqipërisë në vitet e ardhshme, vlerësohet që ekzistojnë faktorë rrezikues për këtë rritje. Të tillë janë ato që lidhen me rritjen e mëtejshme të çmimeve të ushqimeve dhe të energjisë çka do të ulte të ardhurat reale dhe do të dobësonte perspektivën rritëse të ekonomisë. Gjithashtu, masat shtrenguese në kushtet ndërkombëtare të financimit mund të vështirësojë aksesin e Shqipërisë në tregun financiar ndërkombëtar. Ekonomia shqiptare mbetet e brishtë edhe ndaj kushteve atmosferike të pafavorshme (përmbytje/thatësirë) apo tendencës së kundërt të rritjes së çmimeve të pasurisë së patundëshme që do të ulte kontributin e sektorëve në ekonomi si dhe do të rriste ekspozimin e bankave ndaj një risku të shtuar. Në matricën vlerësuese të risqeve, Shqipëria paraqitet me rrezik/ekspozim të lartë lidhur me faktorë të jashtëm si luhatjet në çmimet e mallrave, rënia ekonomike në vendet e Europës, efektet e tërmetit, pandemisë Covid 19, e më tej të luftës në Ukrainë apo lidhur me faktorë të brendshëm si borxhi publik, cilësia e ulët e PIM dhe PPP. Ajo kategorizohet me rrezik të mesëm lidhur me inflacionin, situatat e mundshme pandemike, katastrofat natyrore dhe kushtet klimaterike, brishtësinë financiare të popullatës, rritjen e pakënaqësisë sociale<sup>7</sup>.

**Tregu i punës dhe pagat.** Treguesit e tregut të punës janë përmirësuar vitet e fundit. Megjithatë, shkalla e ulët e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore dhe nivelet e larta të papunësisë vazhdojnë të karakterizojnë tregun kombëtar të punës. Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për popullsinë 15-64 vjeç në dekadën e fundit është luhatur midis 50-70% (52.4% në vitin 2013 dhe 69.3% në vitin 2021) dhe për meshkujt shkalla e pjesëmarrjes ishte 5,9 pikë përqindje më e lartë sesa për femrat<sup>8</sup>. Shkalla e pjesëmarrjes së të rinjve qëndron në një nivel shumë më të ulët se norma totale e pjesëmarrjes (56.7% tremujori i dytë 2023)<sup>9</sup>.

Të gjithë sektorët kanë patur normë punësimi të rritur (kryesisht në industri, ndërtim dhe shërbime), ndërsa parashikohet që kërkesa për punësim në periudhë afatmesme të jetë më së shumti në sektorin e shërbimeve<sup>10</sup>. Gjithashtu, produktiviteti pritet që të ketë një rritje të lehtë. Norma e papunësisë pritet të pësojë ulje nga 11.5% në vitin 2021 në 10.7% në vitin 2023 për të arritur në nivelin 9.8% në vitin 2025. Mbetet shqetësuese norma e papunësisë tek të rinjtë. Sipas INSTAT, shkalla zyrtare e papunësisë për të rinjtë 15-29 vjeç ishte rreth 20.7% për vitin 2022, shifër e lartë edhe ndër vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Megjithëse, përfshirja e grave në tregun e punës është rritur në mënyrë të qëndrueshme gjatë viteve të fundit, gratë në moshë pune ende përballen me pabarazi dhe diskriminim të vazhdueshëm në punësimin me pagesë, norma më të ulëta të punësimit, të ardhura më të ulëta dhe norma më të larta informaliteti<sup>11</sup>. Struktura e të punësuarve në Shqipëri sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,8% e grave janë të punësuar me pagë, ndërsa 21,9% e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht

<sup>7</sup> IMF Country Report No. 22/362 December 2022.

<sup>8</sup> INSTAT, Tregu i punës 2021, maj 2022.

<sup>9</sup> INSTAT, Anketa tremujore e Forcave të punës.

<sup>10</sup> Këshilli i Ministrave, Programi i reformës ekonomike 2023-2025, January 2023.

<sup>11</sup> ILO/Bureau for Employers' Activities (2017), *Women in Business and Management: Gaining Momentum in Eastern Europe and Central Asia*, International Labour Organization, Geneva.

43,2% dhe 11,4%. Një pjesë e konsiderueshme e burrave janë të vetëpunësuar 33,6%, ndërsa gratë e vetëpunësuar përbëjnë 19,9%<sup>12</sup>. Sipas informacionit të MFE, gjatë vitit 2021, në programet e Nxitjes së Punësimit janë punësuar gjithsej 2,240 punëkërkues të papunë nga të cilët 1,185 ishin nga kategoria femra<sup>13</sup>.

Në vitin 2021, gratë punëkërkuese të papuna morën pjesë më shumë se burrat në programet e nxitjes së punësimit, ndërsa burrat punëkërkues të papunë morën pjesë më shumë në kurset e formimit profesional. Numri i grave punëkërkuese të papuna, në përgjithësi, rritet me rritjen e moshës, ndërsa e kundërta ndodh për burrat. Të dhënat tregojnë se rreth gjysma e grave dhe burrave punëkërkues të papunë kanë arsim 8/9 vjeçar. Punëkërkues të papunë të regjistruar që përfitojnë ndihmë ekonomike për vitin 2021 janë 49,2% burra dhe 50,8 % gra, ndërsa përfitues të pagesës së papunësisë janë më shumë gra me 60,0%<sup>14</sup>. Sipas raportit të indeksit të hendekut gjinor të Forumit Ekonomik Botëror 2022, Shqipëria renditet në 18 nga 146 vende (krahasuar me 25 nga 153 vende për vitin 2021), duke reflektuar pasojat e vazhdueshme të krijuara nga tërmeti dhe pandemia COVID-19. Ndryshimet në Kodin e Punës përfshinë më shumë masa për të mbështetur barazinë gjinore në tregun e punës, megjithatë, nuk ka monitorim të vazhdueshëm të zbatimit të këtyre ndryshimeve në praktikë. Për më tepër, ekziston ende nevoja për të harmonizuar legjislacionin me direktivën e BE-së për balancën punë-jetë<sup>15</sup>.

Paga mesatare në Shqipëri ka pësuar rritje (23% në tremujorin e IV të vitit 2022 krahasuar me tremujorin e IV të vitit 2019) si në sektorin shtetëror (16%) dhe në sektorin privat (28%). Në terma absolutë paga mesatare mujore në tremujorin e dytë të vitit 2023 ishte 70,905 lek. Paga mesatare mujore në sektorin shtetëror në fund të vitit 2022 ishte 20% më e lartë se paga mesatare në sektorin privat. Megjithatë, pagat në sektorin privat vijojnë të kenë një rritje relativisht të shpejtë, mesatarisht 9.5% gjatë tremujorit të parë të vitit 2023<sup>16</sup>. Paga minimale ka pësuar rritje të herëpashërëshme. Aktualisht ajo është 40,000 AL apo 40% më e lartë se paga minimale në fund të vitit 2019. Paga minimale e rritur dhe përpjekjet e shtuara të dy viteve të fundit për të formalizuar deklarinimin e pagave kanë patur efektin e tyre në rritjen e pagave. Por këto nuk kanë qenë faktorët e vetëm të rritjes së pagave, por dhe zhvillimet pozitive në tregun e punës. Normat e larta të inflacionit kanë bërë që rritja reale mesatare e pagave të jetë 1.0% për të gjithë ekonominë dhe rreth 5.2% për sektorin privat. INSTAT raporton se për vitin 2022 shpenzimet mesatare mujore për konsum të familjeve shqiptare ishin 88,367 lek ndërsa të ardhurat mesatare mujore për frymë/të ekuivalentuara në vitin 2021 ishin 30,962 lek.

**Remitancat.** Që nga viti 1992, kur nisën flukset e para të prurjeve të emigrantëve janë futur në ekonominë shqiptare mbi 30 miliardë dollarë në formën e prurjeve të emigrantëve. Niveli i remitancave është shtuar ndjeshëm dy vitet e fundit çka korespondon me ciklin e ri të emigracionit të viteve të fundit. Ato kanë furnizuar me të ardhura 13% të buxhetit të familjeve. Gjysma e prurjeve kanë financuar konsumin e ushqimeve dhe pjesa e tjetër, është përdorur për t'u arsimuar dhe për shërbime të tjera<sup>17</sup>. Kontributi kryesor i remitancave lidhet me reduktimin e varfërisë të shumë familjeve. Një pjesë e vogël e tyre është investuar në ekonomi, kryesisht në biznese të vogla dhe ka qenë e pamjaftueshme për të rritur prodhimin vendas<sup>18</sup>.

**Zhvillimi rajonal.** Zhvillimi ekonomik rajonal dhe lokal është i një rendësie të posaçme kur bëhet fjalë për mbrojtjen sociale. Masa dhe cilësia e këtij zhvillimi kushtëzon punësimin e të papunëve veçanërisht nga kategoria e familjeve në ndihmë ekonomike, punësimin e personave me aftësi të kufizuara si dhe aftësinë e

<sup>12</sup> INSTAT, 2022. Burra dhe gra 2022.

<sup>13</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Strehimit (2021), shkrues nr 15934 Prot, datë 16.08.2022 me objekt "Mbi kërkesën për informacion".

<sup>14</sup> INSTAT, 2022. Burra dhe gra 2022.

<sup>15</sup> European Commission 2022. Albania 2022 report.

<sup>16</sup> Banka e Shqipërisë, njoftim për shtyp, 02.08.2023.

<sup>17</sup> Revista monitor.

<sup>18</sup> Revista monitor, Cikli i ri i emigracionit: Të ardhurat nga remitancat arrijnë në nivelin më të lartë nga 2010-a.

pushtetit vendor dhe të aktorëve të tjerë lokalë, për të venë në dispozicion burime njerëzore dhe financiare në mbështetje të grupeve vulnerabël.

Rezultoni që transformimet e shumanshme që ka pësuar vendi gjatë këtyre 30 viteve të fundit kanë theksuar pabarazitë dhe diferencat e mëdha demografike, ekonomike dhe zhvillimore. Zhvillimet demografike kanë krijuar shproporcione të rëndësishme. Kështu, në vitin 2021, vetëm në aksin Tiranë – Durrës – Fier janë të vendosur 1,490,221 banorë, pra pak më shumë 50% e popullsisë së vendit dhe vetëm qarku i Tiranës, ndër 12 qarqet, ka mbizotërim të popullsisë urbane (88.5% e popullsisë). Qarku i Durrësit dhe i Vlorës kategorizohen me popullsi të natyrës së ndërmjetme (respektivisht 24.7% dhe 43.9% popullsi rurale) ndërsa 9 qarqet e tjera mbizotërohen nga popullsi rurale<sup>19</sup>. Fondi për zhvillimin rajonal mbetet burimi më i madh i financimit për investimet kapitale dhe ndërhyrjet në infrastrukturën lokale dhe rajonale.

Rritja e PBB-së në nivel rajonal paraqet rezultate të përziera dhe mungesën e një tendence të qartë zhvillimi, gjë që flet për një ekonomi vendore të brishtë. Pësia e kontributit të Tiranës në PBB është në rritje (44% e PBB në 2021 krahasuar me 40% në 2016), ndërsa kontributi i qarqeve të tjera është në rënie. Rajoni i veriut kontribuon 22.3% në PBB vjetore ndërsa ai i jugut 27%. Bashkitë e veriut në përgjithësi dhe bashkia e Kukësit në veçanti mbeten më të varfërat në Shqipëri. PBB për frymë në qarkun e Kukësit është 59% e mesatares kombëtare<sup>20</sup>. Në 7 ndër 12 qarqe, mbi 50% e punësimit është në bujqësi (varion nga 51% në Gjirokastrë në 70% në Kukës). Qarku me punësimin më të madh në sektorin e industrisë është Durrësi, ndërsa 70% e punësimit në qarkun e Tiranës është në sektorin e shërbimeve.

Në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2023-2030, Shqipëria vlerësohet si një vend i polarizuar në përgjithësi dhe sidomos në aspektin e potencialit ekonomik i cili është i mbyllur kryesisht në trekëndëshin Durrës-Tirana-Laç. Strategjia vlerëson që “ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme midis qarqeve më të zhvilluara (Tiranës dhe Durrësit) dhe atyre më pak të zhvilluara (Kukësit dhe Dibër), si dhe midis zonave rurale dhe urbane. Ulja e papunësisë mbetet objektivi strategjik parësor. Tre nga katër rajonet statistikore kanë zona rurale dhe zona të largëta ku ofrimi dhe mundësia për shkollim është e pamjaftueshme. Pritet që zhvillimi i korridoreve të mëdha të transportit do të eliminojë pengesat infrastrukturore për rritjen socio-ekonomike, zhvillimi i shërbimeve publike do të ulë prirjet migratore të rinjve dhe nxitjen e investitorëve për të investuar ndërsa zhvillimi i zgjidhjeve novatore dhe të qëndrueshme nga autoritetet lokale do t'i bënte vendbanimet e largëta tërheqëse për të punuar dhe jetuar”<sup>21</sup>.

Nga pikpamja ligjore, Shqipëria ka miratuar ligjin “Për Zhvillimin Rajonal dhe Kohezionin”, i cili angazhon shtetin shqiptar për të kontribuar më shumë në arritjen e objektivave të përcaktuara në “Politikën Rajonale” të Bashkimit Europian e materializuar në pesë përparësi për periudhën 2021-2027<sup>22</sup> me mbështetjen e instrumentit financiar të Fondeve Strukturale. Gjithashtu, Shqipëria në vitin 2018, ka shkrirë në një të gjitha funksionet e agjencive të lidhura me zhvillimin rajonal duke i përqendruar tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit<sup>23</sup>. Shqipëria, në raportin e progresit të Komisionit Europian të vitit 2022, vlerësohet me progress të kufizuar lidhur me miratimin e legjislacionit që bën të zbatueshëm Ligjin për Zhvillimin dhe Kohezionin Rajonal. Raporti rekomandon vijimin e zbatimit të masave përafuese me Acquis të BE, kapitulli 22 dhe përgatitjen

<sup>19</sup> Zotaj, E, Sfidat e zhvillimit dhe zbatimit të Politikës Rajonale në Shqipëri një hap i rëndësishëm drejt integritit në Bashkimit Europian, Maj 2021.

<sup>20</sup> INSTAT

<sup>21</sup> VKM Nr. 88 “Per miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030”, shkurt 2023.

<sup>22</sup> Vizioni i BE përcakton pesë përparësi, “Europa inteligjente”, “Europa e gjelbër”, “Europa komunikuese”, “Europa më sociale” dhe “Europa më pranë qytetarëve”.

<sup>23</sup> Fondi Shqiptar i Zhvillimit, 2020.

institucionale të nevojshme për të ploësuar të gjitha kërkesat dhe standardet europiane për mobilizimin e fondeve të kohezionit social në të ardhmen. Qartësimi i përgjegjësive midis pushtetit qendror dhe lokal dhe fuqizimi i mëtejshëm i kapaciteteve administrative në nivelin qendror, rajonal dhe lokal vecanërisht në sigurimin e stafit të mjaftueshëm dhe rishikimin e pagave tek pushteti lokal dhe mbajtja e decentralizimit fiscal si një prioritet kryesor në axhendën qeverisëse.

## 1.2. Konteksti social

Në periudhën 2015-2019, zhvillimi dhe kohezioni social (shëndetësia, arsimi dhe mbrojtja sociale) kanë përthithur përafërsisht gjysmën e buxhetit të shtetit<sup>24</sup>. Shpenzimet publike për mbrojtjen sociale janë rritur vitet e fundit dhe aktualisht janë rreth 9% të PBB-së, ose sa gjysma e nivelit të mesatares Europiane të shpenzimeve në sektor (rreth 19% e PBB<sup>25</sup>), edhe pse me një rritje prej 36% ndaj nivelit 7.3% të PBB në fillimvitet 2000. Shpenzimet për asistencën sociale/skemat e mbështetjes financiare kanë mbetur përgjithësisht konstante (rreth 1.6% e PBB), ndërsa shpenzimet për shërbime sociale dhe politika të tregut të punës (respektivisht, me 0.05% e PBB) kanë mbetur përgjithësisht të ulëta ndër vite<sup>26</sup>. Shpenzimet e mbrojtjes sociale për vitin 2020, ishin pak më shumë se 40% të buxhetit, pjesa më e madhe e të cilave (26.3%) përdoren për sigurimet shoqërore dhe vetëm 14.9% për kujdesin dhe përfshirjen sociale. Aktualisht nuk ka parashikime për investime infrastrukturore për ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Varfëria.** Në Shqipëri në vitin 2021, treguesi i rrezikut për të qenë i varfër ishte 22%, rreziku për të qenë i varfër ose i përjashtuar social ishte 43.9%, rreth 622,700 individë jetonin nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër<sup>27</sup>. Është provuar që përfitimet sociale si pensionet e pleqërisë dhe ato familjare, të përfshira në të ardhurat familjare të disponueshme, ndikojnë në uljen e rrezikut për të qenë i varfër. Kështu, nëse në nivelin e të ardhurave nuk do të përfshiheshin të gjitha llojet e përfitimeve sociale, rreziku për të qenë i varfër në vitin 2021 është vlerësuar 39,0 % kundrejt 25,2 % në rastin kur përfshihen përfitimet sociale nga pensionet e pleqërisë dhe ato familjare. Kufiri financiar i rrezikut për të qenë i varfër në vitin 2021 është llogaritur 191,791 ALL për një familje me një person, ndërsa ai rritet me shtimin e numrit të anëtarëve si dhe në rastin kur personi është i papunë.

Vlerësimet tregojnë që në vitin 2020, pagesa e ndihmës ekonomike për një familje me dy të rritur dhe dy fëmijë në ngarkim përfaqëson 32.8 përqind të pragut të rrezikut të rënies në varfëri të një familjeje me të njëjtën përbërje pa konsideruar përfitimet shtesë që familja në ndihmë ekonomike merr, por që nuk figurojnë ende të monetarizuara. Buxheti total që shkon për ndihmën ekonomike është 0.3% e PBB, ndërsa rezulton që ndihma ekonomike të ketë një ndikim të kufizuar në uljen e varfërisë. Është rreth 9% e popullsisë përfituese e programit të ndihmës ekonomike (64,000 familje në vitin 2022 me 226.530 individë anëtarë) ndërsa janë edhe 4,348 familje që kanë përfituar nga fondi 6% në dispozicion të pushtetit vendor<sup>28</sup>. Vetëm 3% e popullsisë u nxorr nga rreziku i varfërisë nëpërmjet transfertave sociale (njëra prej të cilave është ndihma ekonomike). 95% e

<sup>24</sup> UN, 2021, Budget Analysis of SDG-related Spending in Albania: 2015-2019.

<sup>25</sup> Eurostat, 2022.

<sup>26</sup> World Bank Group, 2022, Albania Social Protection Situation Analysis.

<sup>27</sup> INSTAT, Matja e të Ardhurave dhe Nivelit të jetesës në Shqipëri 2021, Dhjetor 2022.

<sup>28</sup> Duke përfshirë përfituesit nga fondi 6 përqind, numri i përgjithshëm i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike ishte 59,546 në vitin 2018, 63,455 në vitin 2019, 66,472 në vitin 2020 dhe 68,246 në vitin 2021.



transfertave të programit të mbrojtjes sociale janë në cash, çka pohon që shërbimet sociale në nivel vendor aktualisht janë një ofertë e varfër.

Sipas INSTAT<sup>29</sup>, programi i Ndhmës Ekonomike mbulon 37.0 përqind të familjeve të decilit më të ulët të të ardhurave dhe 25.8 përqind të familjeve me kuintilin më të ulët të të ardhurave. 45.2 përqind e shpenzimeve për pagesën e Ndhmës Ekonomike shkojnë për decilin më të ulët dhe 61.5 përqind për kuintilin më të ulët. Ende një përqindje e konsiderueshme e familjeve me të ardhura të ulëta (vlerësuar në 63 përqind të decilit më të ulët dhe në 74 përqind të kuintilit më të ulët) rezultonin jashtë mbulimit të programit të Ndhmës Ekonomike në vitin 2021. Këto shifra provojnë që programi i Ndhmës Ekonomike ka një ndikim të kufizuar në reduktimin e rrezikut nga varfëria. Gjithashtu është provuar që: (i) rreziku i rënies në nivelin e varfërisë për individët ndryshon nga statusi i aktivitetit të tyre ekonomik. Në vitin 2020, shkalla e rrezikut të rënies në varfëri ishte 37.8 përqind për të papunët dhe 28.9 përqind për personat ekonomikisht joaktivë krahasuar me 12.7 përqind për të punësuarit. Nga ana tjetër, 11.6 përqind e popullsisë i përket familjeve me intensitet të ulët pune (një familje quhet me intensitet të ulët pune nëse numri i muajve të punës së të gjithë anëtarëve të familjes gjatë vitit paraardhës ishte më pak se 20 përqind); (ii) rreziku i rënies në varfëri rritet edhe në varësi të numrit të fëmijëve në ngarkim. Në vitin 2020, shkalla e rrezikut të rënies në varfëri për familjet me fëmijë në ngarkim ishte 26.0 përqind, ndërsa për familjet pa fëmijë në ngarkim ishte 13.0 përqind; (iii) norma e rrezikut të rënies në varfëri për popullsinë e moshës 65 vjeç e lart ose për pensionistët është dukshëm më e ulët se mesatarja, si rezultat i transferimit të të ardhurave nga pensionet. Sipas një ankete tjetër<sup>30</sup>, niveli i lartë i rrezikut të rënies në varfëri vërehet tek familjet me në krye gra ekonomikisht joaktive, veçanërisht për shkak të angazhimit të tyre në punë të papaguar në familje. Kjo nënkupton që shpërndarja e pabarabartë e punës përkujdesëse të papaguar pengon pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe çon në ekspozimin më të lartë të tyre ndaj rrezikut të rënies në varfëri.

**Aftësia e kufizuar.** Shqipëria është ndër vendet me përqindjen më të lartë të personave me aftësi të kufizuar në rrezik për të qenë të varfër apo për të provuar përjashtim social. Në vitin 2020, rreth 55% e popullsisë mbi 16 vjeç me aftësi të kufizuar në Shqipëri, jetojnë në familje, të cilat provojnë të paktën një ndër tre rreziqet e varfërisë dhe të përjashtimit social (rrezik për të qenë i varfër, individë thellësisht të privuar materialisht si dhe individë që jetojnë në familje me intensitet shumë të ulët në punësim). Kjo shifër është e lartë në të gjithë vendet e Ballkanit dhe është shumë më e lartë se në vendet e Bashkimit Europian (BE) (29.6%).

Skemat e mbështetjes financiare për personat me aftësi të kufizuara, përbëjnë një nga shtyllat kryesore të sistemit të mbrojtjes sociale në Shqipëri<sup>31</sup>. Shqipëria, në vitin 2022, shpenzoi rreth 10% të PBB-së për programet e mbrojtjes sociale, dhe programi i pagesave të aftësisë së kufizuar, ishte programi më i madh i zbatuar në këtë drejtim (63% totalit të shpenzimeve për ndihmën sociale në vitin 2022)<sup>32</sup>. Këto skema përfshijnë të gjitha llojet e përfitimeve për paaftësinë si pagesën për aftësinë e kufizuar, pensionin e invaliditetit dhe përfitime të tjera. Aktualisht niveli i përfitimeve për aftësinë e kufizuar është më i ulët se niveli AROPE i përcaktuar nga EU-SILC<sup>33</sup>. Studimet provojnë se PAK janë një prej kategorive më të brishtë ndaj situatave të krizave dhe emergjencave që shoqërohet me humbje punësimi, ulje të nivelit të të ardhurave dhe ekspozim ndaj problemeve financiare të lidhura kryesisht me mjekimin dhe shërbimet<sup>34</sup>.

<sup>29</sup> Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës, 2020.

<sup>30</sup> INSTAT-UN Women, 2021.

<sup>31</sup> World Bank Group, 2022. Albania – Social Protection Situational Analyses.

<sup>32</sup> World Bank Group, 2022. Albania – Social Protection Situational Analyses.

<sup>33</sup> European Commission-ESPN, Thematic Report on Social Protection for People with Disabilities, Albania, 2022.

<sup>34</sup> WFD, Impact of COVID 19 to People with Disabilities in Albania, 2021.

## 1.3. Konteksti reformues

### 1.3.1 Reformat në fushën e Mbrojtjes Sociale

**Ndihma ekonomike dhe përfitimet e tjera.** Përgjatë dekadës së fundit, Shqipëria ka avancuar në reformimin e programit të asistencës sociale, që është skema kryesore e mbështetjes sociale me vlerë monetare për familjet e varfëra në Shqipëri, ndërsa ka demonstruar një angazhim serioz në përmirësimin e efektivitetit, eficiencës dhe transparencës të programeve të asistencës sociale. Proçesi reformues nisi për të adresuar problematikat e vërejtura të programit si përjashtimi nga skema të aplikantëve, proçese të ndërlikuara të aplikimit, sisteme dhe kapacitete të dobta të mbikëqyrjes, kontrollit dhe informacionit. Në vitin 2012 nisi proçesi reformues i programit të ndihmës ekonomike<sup>35</sup>, fillimisht me krijimin e dispozitave ligjore<sup>36</sup>, më pas me pilotimin 3 vjeçar të skemës në tre rajone dhe për të vijuar më tej, në vitin 2018, me shtrirjen e skemës në të gjithë vendin.

Numri i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike në vitin 2021 u ul me 37.2 përqind krahasuar me vitin 2012. Numri i përgjithshëm i familjeve përfituese u zvogëlua me 25.3 përqind në vitin 2014 si rezultat i pilotimit të skemës së reformuar në Tiranë, Elbasan dhe Durrës), dhe me 33.3 përqind në vitin 2018, kur reforma u shtri në të gjithë vendin. Rënia e përqindjes ishte veçanërisht e konsiderueshme për familjet me një ose dy anëtarë. Sipas administratorëve shoqërorë, si rezultat i përdorimit të mekanizmit të ri për marrjen e vendimit në lidhje me kualifikueshmërinë e kandidatëve për përfitimin e NE-së, gabimet në aspektin e përfshirjes janë ulur ndjeshëm në zonat urbane, por ende ekzistojnë përjashtime në zonat rurale për shkak të mungesës së informacionit të saktë për asetet/ pasuritë si toka dhe blegtoaria<sup>37</sup>.

Zbatimi i programit të reformuar ka racionalizuar proçesin e aplikimit dhe të përzgjedhjes së përfituesve të Ndhmës Ekonomike, ka përmirësuar dukshëm proçesin e shënjestrimit dhe të përzgjedhjes së familjeve që janë nevojë duke përdorur një formulë pikëzimi (proxy means test) të inkorporuar në një Sistem Informativ të Menaxhimit administruar nga Shërbimi Social Shtetëror (ShSSH), ka rritur rolin e pushtetit vendor në administrimin e programit të ndihmës si dhe në vendimmarrjen e drejtpërdrejtë për familjet që padrejtësisht mund të rezultojnë të përjashtuara për shkak të formulës së pikëzimit, por që janë në nevojë për mbështetje duke i vendosur në dispozicion fondin prej 6% të buxhetit të Ndhmës Ekonomike për ofrimin e kësaj pagese. Ai ka rritur pagesat për familjet përfituese më të shenjestrhuara, ka eliminuar pagesat e pjesshme dhe është fokusuar në Programin Kombëtar për Daljen nga skema e ndihmës ekonomike, veçanërisht sa i takon riintegrimin ekonomik në tregun e punës të përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune. Pas vitit 2015, pati një avancim të dukshëm lidhur me decentralizimin fiskal dhe administrativ dhe në këtë kuadër administratorëve shoqërorë, iu besua një rol kyç në identifikimin e familjeve në nevojë, në menaxhimin e rasteve të tyre duke i referuar për mbështetje me shërbime sociale apo duke i orientuar drejt fuqizimit të tyre ekonomik. Programi i mbështetjes me ndihmë ekonomike, në situatën aktuale ka nevojë që të kalojë në një

<sup>35</sup> ILO, Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri, 2023.

<sup>36</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 904, datë 12.12.2012, "Për përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit të përfitimit të ndihmës ekonomike në zonat pilot".

<sup>37</sup> ILO, Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri, 2023.

fazë të re reformimi që do të adresonte disa aspekte kritike të tilla si: përshtatshmëria dhe mjaftueshmëria, indeksimi, harmonizimi i përfitimeve me skemat e tjera si dhe ndërlidhja me shërbimet e tjera sociale

**Aftësia e kufizuar.** Programi i mbështetjes së aftësisë së kufizuar, gjatë viteve të fundit, ka kaluar në një proces reformimi. Reforma e sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar u mbështet në përvojën ndërkombëtare të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe ofrimin e përfitimeve të aftësisë së kufizuar në sistemin jokontribues<sup>38</sup>, duke marrë në konsideratë kontekstin profesional, kulturor, socio-ekonomik, legjislativ dhe politiko-administrativ të Shqipërisë. Ajo u mbështet në *Dokumentin Politik mbi Reformën e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar* në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe në Planin e Veprimit 2019-2024<sup>39</sup>, is cili shërbeu si udhërrëfyes për aplikimin dhe shtrirjen e reformës në të gjithë vendin.

Qëllimi i reformes ishte të garantonte shpërndarjen e drejtë të fondeve për njerëzit me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme për plotësimin e nevojave të tyre të veçanta të shkaktuara nga aftësia e kufizuar, nxitjen e mbështetjes sociale dhe të ruajtjen në mënyrë progresive të një cilësie jetese të krahasueshme me standardin e jetesës të pjesës tjetër të popullsisë së vendit. Pas një pune intensive përgatitore në dizejnimin e proceseve, procedurave, sistemeve të skemës së re të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, reforma u pilotua në vitin 2020 në qarkun e Tiranës dhe në fund të vitit 2022 ajo u shtri në të gjithë Shqipërinë duke përfshirë 22,000 persona me aftësi të kufizuar<sup>40</sup> që iu nënshtruan vlerësimit sipas skemës së re në të gjithë vendin.

Pavarësisht tendencës për të standardizuar dhe për të vendosur barazi në procesin e vlerësimit mes grupeve të ndryshme të aftësisë së kufizuar, disa kategori të personave me aftësi të kufizuara nuk arritën t'i nënshtrohen procedurës së vlerësimit biopsikosocial, si: (i) përfituesit aktualë, por edhe aplikuesit e rinj që pretendojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e të verbërve<sup>41</sup>; (ii) përfituesit aktualë, por edhe aplikuesit e rinj që pretendojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidit para-tetraplegjik<sup>42</sup> dhe (iii) invalidët e punës që kërkojnë të përfitojnë sipas legjislacionit në fuqi për statusin e invalidëve të punës dhe që përfitojnë / aplikojnë për vlerësim në sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Aftësia e kufizuar për tre grupet e sipërcituara përcaktohet përmes kriteve, procedurave dhe strukturave të veçanta, të administruara nga Shërbimi Social Shtetëror dhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Në fundin e vitit 2022, sistemi i aplikuar i vlerësimit biopsikosocial të aftësisë së kufizuar në Shqipëri, përmbushi pritshmëritë e tij<sup>43</sup>: (i) procedura e aplikuar për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar u konsiderua përgjithësisht efektive; (ii) dokumentat e hartuara (udhëzuesit dhe formularët) për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, rezultuan funksionale; (iii) Sistemi i Menaxhimit të Informacionit, i krijuar për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, siguroi një proces më të lehtë si dhe më efikas; (iv) u krijuan kapacitete teknike për vlerësimin bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në nivele të ndryshme, nëpërmjet trajnimeve zyrtare dhe trajnimeve përgjatë punës; (v) u krijuan 36 zyra të reja të aksesueshme në 12 rajonet e vendit, për administrimin e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar me staf të dedikuar të

<sup>38</sup> MSHMS 2018, Raport i vlerësimit të zbatimit të Reformës së vlerësimit bi psiko social të aftësisë së kufizuar.

<sup>39</sup> VKM Nr. 360, datë 05.06.2019, "Për miratimin e dokumentit të politikave" Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe Planin e Veprimit të tij 2019-2024".

<sup>40</sup> Raporti i monitorimit për vitin 2022, i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019-2023.

<sup>41</sup> Personat me dëmtime të shikimit vlerësohen sipas VKM nr. 671, datë 15.12.2000 (i ndryshuar) "Për krijimin e Komisionit Mjekësor për Përcaktimin e Verbërisë". Ky komision administrohet nga SHSSH dhe mbledhet vetëm në Tiranë.

<sup>42</sup> Personat para-tetraplegjikë vlerësohen nga KMCAJ për paraplegjinë, tetraplegjinë dhe neurologjinë, të administruar nga SSS

<sup>43</sup> MSHMS 2022, Raport i vlerësimit të zbatimit të Reformës së vlerësimit bi psiko social të aftësisë së kufizuar.

punësuar në çdo zyrë; (vi) u promovua dhe u iniciua bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, për të shkuar më tej drejt jetesës së pavarur përmes shërbimeve, arsimit, punësimit, formimit profesional dhe teknologjive ndihmëse; (vii) skema e re e përfitimeve rezultoi të jetë efikase nga pikpamja e kostove; (viii) është pranuar në përgjithësi procesi i ri i vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar nga përdoruesit. Gjithashtu, testimi i qasjes së vlerësimit bio-psiko-social<sup>44</sup> tregoi se: (a) qasja integrohet mirë në një kuadër koherent të modelit të Klasifikimit Ndërkombëtar të Funkcionimit, Paaftësisë dhe Shëndetit; (b) ka aftësinë për të vlerësuar si prezencën ashtu edhe nivelin e aftësisë së kufizuar të aplikantëve; (c) ka aftësinë për të vlerësuar nevojën për asistencë personale dhe përfitime të tjera dhe (d) është në gjendje të zbulojë abuzimet përgjatë procesit të vlerësimit; (e) skema e përfitimit të propozuar me katër nivele të aftësisë së kufizuar dhe dy nivele të shërbimeve të asistencës personale drejton fondet në dispozicion sipas nivelit të nevojave duke rritur përfitimet për njerëzit me nivele më të larta të nevojave, pa ngarkuar buxhetin e shtetit<sup>45</sup>.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social, ndikoi në përshkallëzim të pagesave të aftësisë së kufizuar në katër nivele<sup>46</sup> dhe ato të ndihmës personal në dy nivele. Pagesa bazë e përfitimit mujor, sipas këtij modeli, është sa 150% të pensionit social<sup>47</sup>. Personat me aftësi të kufizuara, në bazë të statusit të veçantë që ato kanë, mbështeten edhe me bonuse dhe rimbursime si me pagesën e energjisë elektrike, telefonisë, ndihmës ekonomike për invalidët e punës që i përkasin skemës së ISSH, rimbursimin e karburantit për personat para dhe tetraplegjikë, që kanë edhe statusin e invalidit të punës. Skema mbështetëse financiare ofrohen për nxënësit me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, si (i) transport falas<sup>48</sup>; (ii) trajtim falas në institucionet e arsimit special<sup>49</sup>; (iii) tekste falas<sup>50</sup>; (iv) pagesa për mbështetje për nevojat që lidhen me arsimimin, për fëmijët me aftësi të kufizuara në moshë shkollore, që ndjekin arsimin në ciklin e ulët, ciklin e mesëm të ulët, ciklin e mesëm të lartë, arsimin universitar dhe në arsimin pasuniversitar, si shpjeguar në paragrafin më lart; (v) përjashtim nga tarifa vjetore e studimit<sup>51</sup> për studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga ekipet e vlerësimit, si përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe studentët që kanë të paktën njërin nga të dy prindërit me aftësi të kufizuara. Një mbështetje shtesë financiare u ofrua gjatë periudhës së pandemisë për të përballuar situatën e jashtëzakonshme dhe më pas, për zvogëluar efektet e krizës të shkaktuar nga lufta në Ukrainë.

**Shërbimet e kujdesit social.** Me zbatimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2015-2020-2023, Shqipëria ka avancuar me reformimin e sistemit të shërbimeve sociale, duke zhvilluar një qasje të integruar dhe decetralizuar në ofrimin e kujdesit social, paralelisht dhe në mbështetje të skemave të reformuara të asistencës sociale (përkatësisht, NE dhe PAK), si dhe në funksion të fuqizimit të individit dhe familjes, për kapërcimin e

<sup>44</sup> MSHMS 2018, Raport i vlerësimit të zbatimit të Reformës së vlerësimit bi psiko social të aftësisë së kufizuar.

<sup>45</sup> MSHMS 2018, Raport i vlerësimit të zbatimit të Reformës së vlerësimit bi psiko social të aftësisë së kufizuar.

<sup>46</sup> The measure of disability severity is distinguished between light (5-24%), moderate (25-49%), heavy (50-95%) and full (96-100%) disability. Income support varies in accordance with the severity of disability and the same will happen regarding other non-cash benefits.

<sup>47</sup> VKM Nr. 360, datë 05.06.2019, "Për miratimin e dokumentit të politikave" Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe Planin e Veprimit të tij 2019-2024".

<sup>48</sup> VKM-së Nr 682, datë 29/07/2015 i ndryshuar, "PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT".

<sup>49</sup> VKM-në Nr. 753 datë 13/12/2017, "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE".

<sup>50</sup> bazuar në VKM-në e përvitshme për tekstet shkollore falas për grupet e prekshme

<sup>51</sup> VKM-së Nr. 269, datë 29.03.2017 ndryshuar me VKM-në Nr. 40 datë 23.01.2019 dhe VKM-në Nr. 251 datë 27.03.2020, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifat vjetore të shkollimit".

situatave të përjashtimit social dhe ri-integrimit. Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror në vitet e fundit është udhëhequr nga tre parime thelbësore, përshkruar gjithashtu si Reforma 3D-dimensionale (deinstitutionalizim, diversifikim dhe decentralizim).

Ligji 121/2016 hodhi themelet për formësimin e një sistemi të ri shërbimesh të integruara komunitare, çka përbën një hap thelbësor drejt një sistemi modern të mbrojtjes sociale. Shërbimet e Kujdesit Shoqëror kanë pësuar një zhvillim të ndjeshëm në vitet e fundit, sa u takon tipologjive dhe financimit të tyre, por edhe aksesit dhe shtrirjes në territor. Nisur edhe nga praktikatat Europiane, shërbimet sociale janë nga natyra më komplekse krahasuar me skemat e mbështetjes financiare, pasi hartimi, financimi, zbatimi dhe ndjekja e tyre kërkon koordinim të shumë aktorëve, në të gjitha nivelet dhe sektorët. Reformimi i sistemit të shërbimeve sociale është shoqëruar me forcimin e kapaciteteve dhe proceseve në MSHMS dhe në agjensitë në varësi të saj, krijimin e strukturave dhe të kapaciteteve në njësitë e pushtetit vendor si dhe me përpjekjet për të zhvilluar modelet e para të planeve sociale lokale dhe të proceseve planifikuese, financuese, zbatuese, monitoruese, inspektuese dhe vlerësuese të tyre. Aktualisht mbulimi i shërbimeve sociale mbetet i ulët dhe shërbimet sociale kanë qenë dhe mbeten aktualisht të nënfinancuara. Për të mbështetur shtrirjen e shërbimeve dhe krijimin e modeleve të avancuara të shërbimeve sociale është krijuar një instrument financiar i posaçëm, Fondi Social për financimin e shërbimeve të kujdesit social.

Nisja e punës me procesin e negociimit dhe përafrimi për kapitujt 19 dhe 23 të integritimit në BE, e për më tepër, harmonizimi i vijuar me dokumentet politike të BE-së, me parimet e Shtyllës Europiane për të drejtat sociale<sup>52</sup> dhe Strategjinë përkatëse<sup>53</sup>, si dhe me politikatat dhe praktikatat Europiane<sup>54</sup> për mbrojtjen sociale ka ndikuar pozitivisht që mbrojtja dhe përfshirja sociale e grupeve në nevojë në Shqipërinë e viteve të fundit, të marrin një tjetër dimension, orientuar kryesisht te veprimet konkrete dhe masat e integruara me në qendër individin dhe familjen, te rikonceptimi i burimeve dhe financimit, te futja e instrumenteve të reja të mbulimit, te transformimi i shërbimeve sociale përmes digjitalizimit duke rritur aksesin dhe qëndrueshmërinë, por edhe te mbështetja dhe tërheqja e punonjësve socialë në sektor<sup>55</sup>. Në linjë me objektivat e PKIE 2023-2025 dhe IPA, rekomandimi përkatës në Programin Afatmesëm të Reformave Ekonomike i dedikohet ndërtimit të kapaciteteve të qeverisjes lokale për planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve sociale, në mënyrë specifike edhe për mbështetjen përmes Fondit Social, me qëllim adresimin e sfidës kyçe të rritjes së mbulimit dhe përshtatshmërisë së mbrojtjes sociale<sup>56</sup>.

### 1.3.2 Instrumentet mbështetëse të reformave

**Programi i daljes nga skema e NE.** Punësimi i anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike ka qenë vijmësisht në vemendje të qeverisë qendrore dhe asaj vendore. Mekanizmi më i përdorur i punësimit ka qenë angazhimi në punët publike, por ndonëse janë zbatuar disa iniciativa pilot, ato nuk kanë arritur të prodhojnë punësim të qëndrueshëm për anëtarët në moshë pune dhe nxjerrje nga varfëria të familjeve

<sup>52</sup> Qasja e integruar e shërbimeve me në qendër individin, për të mbështetur investimin në kapitalin social, përfshirjen e individit në matjen e performancës së sistemit të mbrojtje sociale.

<sup>53</sup> EC, 2022, European Care Strategy for Caregivers and Care receivers.

<sup>54</sup> Fondi Social European, 25% e të cilit është përdorur për zhvillimin dhe modernizimin e shërbimeve sociale të integruara dhe cilësore, në kushtet e pabarazive mes vendeve anëtare.

<sup>55</sup> <https://www.esn-eu.org/videos/30th-european-social-services-conference>

<sup>56</sup> MFE, 2022, Programi i Reformave Ekonomike, ERP 2022-2024

të tyre<sup>57</sup>. Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale”<sup>58</sup> ka parashikuar që pagesa e Ndhmës Ekonomike kufizohet në kohë për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) vjet, me përjashtim të përfituesve mbi moshën e pensionit dhe nënave me fëmijë në ngarkim. Kjo nënkupton që përfituesit në moshë pune duhet të dalin të pavarur dhe të ri integrohen në tregun e punës brenda kësaj periudhe pesëvjeçare. Në zbatim të ligjit, u përcaktua mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike<sup>59</sup>, i cili parashikon Programin Kombëtar për Daljen nga skema e Ndhmës Ekonomike për përfituesit në moshë pune, që përfshin: (i) programet e punës publike; (ii) subvencionimin e punësimit për kompanitë që punësojnë anëtarë të familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike për pagën e tyre të plotë dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe pikë bonus për kompanitë në procedurat e prokurimit publik; dhe (iii) mbështetje me arsim dhe formim profesional për përfituesit e Ndhmës Ekonomike në moshë pune. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e skemës së daljes nga ndihma ekonomike nëpunësimit janë MSHMS dhe AKPA. Programi i riintegritimit në punësim në periudhën 2020-2021 nuk pati ndonjë zhvillim për shkak të krizës së krijuar nga situata e pandemisë COVID 19 si dhe mungesës së kapaciteteve të dy institucioneve në nivel qendror dhe vendor për të zbatuar një sistem efektiv referimi të përfituesve në moshë pune në ndihmë ekonomike. Mekanizmi i referimit u rivitalizua në vitin 2022 kur Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratuan mekanizmin e referimit për punësimin dhe integrimin social të përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune<sup>60</sup>. Mekanizmi i referimit për vitin 2022 përfshin: (i) krijimin e mekanizmit të referimit të përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune ndërmjet Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi; (ii) përgatitjen e kuadrit të nevojshëm ligjor; (iii) ri-integrimin e përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune nga grupet rajonale të punës të mbështetur nga Shërbimi Social Shtetëror, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi dhe pushteti vendor; dhe (iv) monitorimin dhe zbatimin e programit për daljen nga skema e Ndhmës Ekonomike. Mbi bazën e këtij mekanizmi referimi funksionojnë 12 komisione rajonale vlerësimi<sup>61</sup>, është miratuar protokollin e punës për referimin për punësim të përfituesve në moshë pune si dhe AKPA ka hartuar formularin e gjurmimit të përfituesve të NE në moshë pune. Gjatë vitit 2022 komisiomet rajonale kanë përgatitur 17,000 profile të përfituesve dhe i kanë referuar pranë Zyrrave të Punësimit, janë punësuar 2,501 individë nga skema e NE dhe janë regjistruar në formim profesional 1,077 individë<sup>62</sup>.

**Garancia rinore.** Parimi i katërt i Shtyllës Europiane e të Drejtave Sociale thekson të drejtën e çdo qytetari të BE-së për mbështetje për punësim, të ofruar në kohën e duhur dhe të përshtatur për të përmirësuar perspektivat e punësimit apo të vetëpunësimit. Sipas këtij parimi, të rinjve u garantohet e drejta ose për të vazhduar arsimimin, trajnimin ose iu ofrohet një punë, brenda katër katër muajve nga momenti kur mbeten të papunë ose largohen nga arsimi nëpërmjet një programi të quajtur “Garancia Rinore”. Personat e papunë kanë të drejtë për mbështetje të personalizuar, të vazhdueshme dhe të qëndrueshme, ndërsa të papunët afatgjatë kanë të drejtën e një vlerësimi individual të thelluar, jo më vonë se 18 muaj nga të qenit i papunë<sup>63</sup>.

<sup>57</sup> Banka Botërore, Rishikim i Shpenzimeve Publike, 2006.

<sup>58</sup> Shih edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.09.2019, “Për procedurat, dokumentacionin dhe masën mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e ndihmës ekonomike të kushtëzuar”.

<sup>59</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.882, datë 24.12.2019

<sup>60</sup> Urdhër i përbashkët nr.52, datë 26.01.2022.

<sup>61</sup> Urdhërit të Përbashkët të MSHMS dhe MFE nr.148, datë 28.02.2022.

<sup>62</sup> UNICEF, Raporti Progresit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019-2023, viti 2022.

<sup>63</sup> Disa nga objektivat e rëndësishëm të vendosura në nivel BE-je janë: deri në vitin 2030 të ulët shkalla e të rinjve NEET të moshës 15-29 vjeç në 9% nga 13.1% në vitin 2021; të rritet % e popullsisë së moshës 20 deri në 64 vjeç të punësuar në 78% nga 73.1% në vitin 2021; të rritet % e të gjithë të rriturve që marrin pjesë në mësim çdo vit në 60% nga 44% në vitin 2019.

Qeveria shqiptare dhe institucionet e lidhura me punësimin, arsimin dhe aftësimin, në linjë me rekomandimet e Komisionit European janë angazhuar që çdo i ri nën moshën 29 vjeç (NEET) të ketë një ofertë të denjë punësimi, trajnimi apo arsimit, brenda një periudhe të arsyeshme kohore prej disa muajsh nga momenti i identifikimit. Për këtë, në bashkëpunim me ministritë e linjës është hartuar **një plan kombëtar për Zbatimin e Garancisë Rinore**, i cili është pjesë përbërëse e Strategjisë Kombëtare për Aftësim dhe Punësim 2023-2030. Plani parashikon disa reforma të ndara në katër faza: *hartëzimi* (parandalimi i rritjes së numrit NEET, monitorimi i braktisjes së shkollës, ofrimi i këshillimit në karrierë), *angazhimi* (fushata informuese përfshirë ato me metoda inovatore metoda inovatore nëpërmjet faqeve online), *përgatitja* (zhvillimi i instrumenteve të reja të regjistrimit në portalin e AKPA-s, rritja e kapaciteteve të zyrave të punës, dhe zhvillimi i partneriteteve për realizimin e shërbimeve më të specializuara për NEET) dhe *ofrimi* (zhvillimi dhe përshtatja e programeve për nxitjen e punësimit). Për të menaxhuar dhe monitoruar Garancinë Rinore do të zgjerohet sistemi i menaxhimit të informacionit të tregut të punës për të gjurmuar rrugëtimin e të rinjve NEET para, gjatë dhe pas përfshirjes në skemën e Garancisë Rinore.

Në Janar 2023 ishin 17,381 të regjistruar NEET. Është zhvilluar modeli i zbatimit të Programit të Garancisë Rinore dhe institucioni përgjegjës që është AKPA nën kordinimin e MEF. Dy task forca janë krijuar për të punuar për krijimin e partneriteteve midis institucioneve publike dhe ofruesve privatë të shërbimeve. Ky instrument punësimi merr një rendësi të posaçme për të rinjtë në familjet përfituese të ndihmës ekonomike.

**Fondi Social i Punësimit.** Në vitin 2019, Ligji për Nxitjen e Punësimit<sup>64</sup>, parashikoi krijimin e Fondit Social të Punësimit me qëllim sigurimin dhe administrimin e mekanizmave financiare për nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Fondi Social i Punësimit, do të financohet nga punëdhënësit<sup>65</sup> si dhe nga kontribute të tjera përfshirë dhe ato të donatëve dhe do të menaxhohet nga AKPA për të financuar punësimin, trajnimin, vetëpunësimin si dhe programet e modifikimit të vendeve të punës për personat me aftësi të kufizuara. Ky fond synon nxitjen punësimin për të paktën 9,030 persona me aftësi të kufizuara në institucionet publike dhe në sektorin privat. Operacionalizimi i aktivitetit të Fondit të Punësimit u vonua për shkak të problematikës së krijuar për sektorin privat nga situata e Pandemisë dhe kriza e çmimeve. Aktualisht është bërë plotësimi i kuadrit nënligjor dhe rregullator për funksionimin e fondit dhe duke filluar nga Janari i vitit 2024, subjektet ekonomike shtetërore dhe private do të fillojnë të punësojnë numrin e personave me aftësi të kufizuara të parashikuar për to, ose në të kundërt, do të derdhin detyrimet në Fondin e punësimit tek agjenti i deleguar për mbledhjen e kontributit (Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve). Fondet do të administrohen nga Bordi i Administrimit të Fondit Social i krijuar në shkurt të vitit 2020<sup>66</sup>. Institucionet parashikohet të ndërmarrin fushata informuese dhe ndërgjegjësuese për punëdhënësit dhe sektorin privat me qëllim avancimin e kulturës gjithëpërfshirëse në vendet e punës dhe ato trajnuese ose arsimore.

**Fondi social i shërbimeve sociale.** Fondi Social për financimin e ngritjes së shërbimeve të reja sociale apo konsolidimin e atyre ekzistuese si pjesë e fondit social vendor është sanksionuar me ligj në vitin 2016. Fondi

---

<sup>64</sup> Ligji nr. 15/2019 “Për Nxitjen e Punësimit”.

<sup>65</sup> The quota/levy scheme introduced for public and private employers envisages that each employer with more than 25 employees should employ one person with disabilities, and an additional one for every 50 employees thereafter. If employers fail to fulfil this obligation, they will have to contribute to the ESF an amount equal to 100% of the minimum wage for every month in which they do not employ the appropriate quota of people with disabilities.

<sup>66</sup> DCM No. 177/2020.

Social është një instrument i rëndësishëm financiar, efikasiteti i përdorimit të të cilit varet nga përgatitja e NjQV-ve për zbatimin e funksioneve të shërbimeve sociale, por edhe nga vendimet strategjike dhe modalitetet e përdorimit të këtij fondi që përcakton qeveria qendrore.

Fondi social për financimin e shërbimeve shoqërore u aktivizua për herë të parë në dhjetor 2019, me një buxhet dedikuar bashkive për financimin e ngritjes së shërbimeve, me synimin që, deri në vitin 2022, të financoheshin 35 bashki, duke pasur përparësi ato njësi vendore që nuk ofrojnë asnjë shërbim. Me një rritje të disbursimit të fondit për vitin 2022, fondi total i disbursuar për pushtetin vendor nga Fondi Social gjatë viteve 2019-2022 është 539 milionë lekë. Në partneritet me OJF vendase dhe ndërkombëtare, Fondi ka mbështetur ngritjen e 40 shërbimeve të kujdesit shoqëror, prej tyre 27 shërbime shoqërore në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në 6 qarqe, të ofruara për 10,744 përfitues, duke përfshirë këtu fëmijë në situatë rreziku, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, viktima dhune dhe trafikimi, familje në nevojë Rome dhe Egjiptiane, si dhe individë LGBTI+<sup>67</sup>. Janë nxjerrë disa mësimë nga eksperiencia e deritanishme me projektet dhe modelet e shërbimeve të ofruara si rezultat i financimit të tij, të cilat po përdoren për të bërë rishikimet e nevojshme për të rritur eficiencën, ndikimin dhe qëndrueshmërinë e shërbimeve.

**Ndërmarrjet sociale.** Ndërmarrjet Sociale janë një mundësi për punësimin e individëve të pafavorizuar nëpërmjet përdorimit të subvencioneve nga një fond i posaçëm i dedikuar për këtë qëllim që quhet Fondi i Ndërmarrjeve Sociale. Ligji për “Ndërmarrjet Sociale”<sup>68</sup> është miratuar në vitin 2016, por aktivizimi i tij është kryer për herë të parë në vitin 2018 mbi bazën e një vendimi “për krijimin e fondit në mbështetje të ndërmarrjeve sociale dhe format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale” dhe një udhëzimi që rregullonte modalitetet e përdorimit të tij<sup>69</sup>. Fondi i miratuar për të subvencionuar ndërmarrjet sociale për periudhën 2019-2021 ishte 249,76 milionë lekë<sup>70</sup>, por ky fond nuk u përdor. Aktualisht janë 9 OJF kanë marrë statusin e Ndërmarrjeve Sociale, por financimi i tyre ende nuk ka filluar. MSHMS ka rishikuar VKM që lidhet me subvencionin e ndërmarrjeve sociale dhe pritet që në vitin 2023 nëpërmjet buxhetit të shtetit të mbështeten financiarisht aktiviteti i OJF-ve që kanë marrë apo do të marrin statusin e ndërmarrjeve sociale. Në mars të vitit 2023 Qeveria Shqiptare ka miratuar format e mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023-2025<sup>71</sup>. Fondi në mbështetje të ndërmarrjeve sociale, sipas produktit përkatës të parashikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm “Përkujdesja sociale” për periudhën 2023–2025 është vendosur të jetë 240 000 000 (dyqind e dyzet milionë) lekë.

#### 1.4. Konteksti Gjiner

**Kujdesi dhe puna e papaguar.** Normat sociale të rrënjosura thellë dhe stereotipet gjinore, formojnë perceptimet e njerëzve se kush është përgjegjës për plotësimin e nevojave të kujdesit, kush ka nevojë për kujdes dhe si duhet ofruar ai kujdes. Përgjegjësia e grave për kujdesin ndaj anëtarëve të familjes, konsiderohet e mirëqenë në shumicën e shoqërive dhe pranohet si një pjesë e padiskutueshme e jetës së përditshme. Megjithatë, normat gjinore ndryshojnë dhe politikat mund të ofrojnë një shkas për ndryshime të tilla<sup>72</sup>. Në

<sup>67</sup> MSHMS, 2023, Raporti i monitorimit i SKMS për vitin 2022.

<sup>68</sup> Ligji 65/2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>69</sup> Udhëzimi nr. 602, datë 1.8.2018 për procedurat dhe dokumentacioni për marrjen e statusit të ndërmarrjes sociale.

<sup>70</sup> Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 789, datë 26.12.2018.

<sup>71</sup> VKM 174, 24.03.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023-2025”.

<sup>72</sup> UN Women, 2016. Policy Brief, No. 5. Redistributing unpaid care and sustaining quality care services: a prerequisite for gender e quality.



zonat rurale, mbizotërojnë stereotipat dhe pritshmëritë e forta gjinore mbi rolet e grave dhe burrave në familje. Gratë zakonisht janë përgjegjëse për t'u kujdesur për familjen, fëmijët dhe personat në ngarkim. Burrat konsiderohen de-fakto kryefamiljarë, kanë kontroll mbi të ardhurat e familjes dhe zgjedhin se ku të jetojnë<sup>73</sup>.

Për të kompesuar punën e papaguar të grave, MSHMS<sup>74</sup> ka nxjerrë një udhëzim që parashikon se gratë e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç, ku njeri prej fëmijëve është nën moshën 5 vjeç dhe familja ka të ardhura nën 100 mijë lekë bruto në muaj, të cilat janë kategori ekonomikisht joaktive, mbulohen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe shëndetësor. Pagesa e kontributeve të tyre financohet nga buxheti i shtetit, për periudhën e kujdesit ndaj fëmijës deri në moshën 5-vjeçare.

**Martetat e hershme.** Rreziku i braktisjes të shkollës, për shkak të përgjegjësisë në familje, punëve shtëpiake dhe të kujdesit, si dhe presionet për t'u martuar që fëmijë (në rastin e vajzave) dhe për të mbështetur jetesën e familjes (në rastin e djemve dhe në disa kontekste, vajzave), është një sfidë e madhe, me të cilën përballen shumë adoleshentë. Duhet theksuar se në Shqipëri, është bërë njëfarë progresi në ngritjen e kapaciteteve institucionale për zbatimin efektiv të kuadri ligjor dhe të politikave që rregullon të drejtat e fëmijësve. Praktika e martesës së hershme ende ekziston, dhe nxitet kryesisht nga pabarazia gjinore, varfëria dhe përjashtimi social. Mungesa e të dhënave zyrtare, nuk lejon dhënien e një pasqyre të saktë të prevalencës së martesave të fëmijëve. Sidoqoftë, duhet theksuar se jo gjithmonë, ligjet për mbrojtjen e adoleshentëve nga martesat e hershme, janë efektive ose nuk zbatohen plotësisht. Megjithatë, gjatë gjithë vitit 2021, qeveria i dha prioritet adresimit të martesave të hershme, në kuadrin e saj të politikave kombëtare të buxhetuar për herë të parë. Po kështu, axhenda kombëtare për të drejtat e fëmijës 2021-2026, e miratuar në vitin 2021, përmban objektiva dhe masa për të luftuar këtë praktikë të dëmshme<sup>75</sup>.

**Dhuna me bazë gjinore.** Në fushën e barazisë gjinore dhe eliminimit të dhunës ndaj grave, Shqipëria është palë në dy nga instrumentet më të rëndësishme: Konventën e Stambollit dhe Konventën për Eliminimin e të Gjithë Formave të Diskriminimit ndaj Grave. Vitet e fundit, vendi ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm drejt eliminimit të diskriminimit me bazë gjinore dhe arritjes së barazisë gjinore, sidomos sa i përket kuadrit ligjor dhe të politikave. Megjithatë, sfidat dhe problemet vazhdojnë, për shkaqe historike, sociale, ekonomike e kulturore. Format e ndërthurura të diskriminimit, me të cilat përballen shumë gra, për shkak të gjinisë dhe arsyeve të tjera (etnisë, aftësisë së kufizuar, orientimit seksual, moshës, situatës socio-ekonomike) mbeten të patrajtuara<sup>76</sup>.

Për vitin 2021, nga Programi i Ndhmës Juridike, kanë përfituar gjithsej ndihmë juridike parësore 8,153 individë, subjekte të ligjit nr. 111/2017, nga të cilët 3263 përfitues janë gra dhe vajza në nevojë. E shprehur në përqindje, gratë dhe vajzat përbëjnë 40 % të përfituesve të programit të ndihmës juridike (shërbimi i ndihmës juridike parësore) për vitin 2021. Nga këto, 463 gra dhe vajza i përkisnin kategorisë së viktimave dhe dhunës në familje<sup>77</sup>.

Nga të dhënat e MFE, për vitin 2021, rezulton se nga 2,700 përfitues nga programi i Strehimit, 302 ose 11.2% e përfituesve janë gra kryefamiljare dhe viktimat e dhunës në familje<sup>78</sup>. Gjithsesi, buxheti i planifikuar për

<sup>73</sup> OECD, 2019. Gender index. <https://ëëë.genderindex.org/ëp-content/uploads/files/datasheets/2019/AL.pdf>

<sup>74</sup> Udhëzim i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.670, datë 13.12.2022 "Për procedurën e aplikimit dhe përfitimit nga programi i mbrojtjes së veçantë nga shteti, për grate e papuna, me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç".

<sup>75</sup> European Commission 2022. Albania 2022 report.

<sup>76</sup> UN, 2022. Common country analysis 2022, Albania.

<sup>77</sup> Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, Shkresë nr. 1323/1 Prot datë 13.06.2022 me objekt " Kthim përgjigje mbi kërkesën për informacion".

<sup>78</sup> Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit, Drejtoria e Strehimit (2021), shkresë nr 15934 Prot, datë 16.08.2022 me objekt "Mbi kërkesën për informacion".

realizimin e programeve të strehimit është i ndarë sipas zërave të programit dhe nuk ka një fond të dedikuar vetëm për përfitueset gra<sup>79</sup>.

**Mbrojtja e nënës dhe fëmijës.** Mbrojtja dhe kujdesi ndaj nënës e fëmijës është thelbësore për ushqyerjen dhe shëndetin e mirë, mirëqenien e nënave dhe fëmijëve të tyre, parandalimin dhe reduktimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit, si dhe arritjen e barazisë gjinore në tregun e punës.

Numri i lindjeve në vitin 2021 është 27.211 lindje. Raporti gjinor në lindje është 108, që tregon se për çdo 100 vajza të lindura, lindin 108 djem. Ky raport është më i lartë se raporti natyral, i cili është 105. Në vlera absolute, rënia e numrit të lindjeve krahasuar me vitin 2020 është 864. Për lindjet djem kemi një rënie prej 2,7%, ndërsa për lindjet vajza rënia është 3,5%. Lindshmëria në adoleshencë është zvogëluar në krahasim me një vit më parë. Në vitin 2021, ka 12,1 lindje për çdo 1.000 vajza të grup-moshës 15-19 vjeç nga 13,3 lindje që ishin në 2020<sup>80</sup>.

Në vijim të prioriteteve strategjike dhe politikave mbështetëse të Qeverisë Shqiptare, që nga Janari i vitit 2019 e në vazhdimësi, po aplikohet “bonusi i bebes” i cili është në stimul financiar për mbështetjen e familjeve të reja, rritjen e numrit të lindjeve dhe zhvillimin e shoqërisë. Bonusi i bebes ka patur një rritje të përfituesve të saj nga vlera e planifikuar sipas fazës së tretë të PBA (2,820,290,000 leke) në rishikimin gjatë vitit 2021 në vlerën e rishikuar 3,303,110,000 Lek për 43,441 bebe<sup>81</sup>. Masa në lidhje me sigurimin e paketave të kujdesit për bebe dhe nëna u zbatua me shumë sukses edhe për nënat rome dhe egjiptiane që lindin në spital. Gjatë vitit 2016, u raportuan 1,961 nëna rome dhe egjiptiane përfituese, gjatë 2017 kjo shifër është rritur në 2,059, ndërkoh që viti 2018 numëron 7,080 përfitues në këtë kategori<sup>82</sup>.

### 1.5. Përballja me emergjencat dhe situatat e krizave

Ndikimet e pandemisë COVID-19, emergjenca klimatike dhe konfliktet gjeopolitike kërcënojnë ekonominë, zhvillimin dhe mbrojtjen sociale ndaj qeveritë lipset të zhvillojnë strategji për parandalimin dhe trajtimin e emergjencave. Këto strategji duhet t’i përgjigjen kontekstit gjinor, të integruara, elastike dhe fleksibël.

Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm përfshin gjithsej 25 objektiva për reduktimin e rreziqeve klimatike dhe hartimin e masave fleksibël dhe elastike në komunitetet e cenueshme. Këto përfshijnë forcimin e kapaciteteve përshtatëse ndaj rreziqeve dhe fatkeqësive të lidhura me klimën në Objektivin 13 (Marrja e veprimeve urgjente për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e tij); ndërtimi i qëndrueshmërisë në të gjitha vendet për menaxhimin e rreziqeve shëndetësore kombëtare dhe globale në Objektivin 3 (Sigurimi i jetëve të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat); dhe reduktimin e ekspozimit dhe cenueshmërisë ndaj fatkeqësive duke ndërtuar infrastrukturë elastike dhe të qëndrueshme në Objektivin 11 (Të bëjmë qytetet dhe vendbanimet njerëzore gjithëpërfshirëse, të sigurta, elastike dhe të qëndrueshme)<sup>83</sup>.

Pas tërmetit në vitin 2019, qeveria dhe autoritetet lokale u mbështetën nga partnerët ndërkombëtarë për të zhvilluar strategji dhe plane veprimi për t’iu përgjigjur çështjeve sociale në raste emergjente, njerëzve dhe familjeve të prekura nga tërmeti dhe atyre që jetojnë në varfëri<sup>84</sup>. U hartuan “protokollet për ofruesit e shërbimeve sociale në nivel lokal” dhe “planet emergjente sociale” të cilat u përdoren si mekanizma

<sup>79</sup> UN Women & Avokati i Popullit 2023, Shpenzimet publike gjinore në fushën e shërbimeve sociale.

<sup>80</sup> INSTAT, 2022. Burra dhe gra 2022.

<sup>81</sup> MSHMS, 2022. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020-2-23). Raport Progresi 2021.

<sup>82</sup> MSHMS, 2021. Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri (2021-2025).

<sup>83</sup> World Bank & GFDRR, 2022. Entry Points for Social Inclusion and Gender in Disaster Risk Management and Climate Resilience Development Policy Operations.

<sup>84</sup> UN, 2022. Albania progress report.

mbështetës për personelin përkatës gjatë dhe pas emergjencave dhe fatkeqësive natyrore<sup>85</sup>. Individët dhe grupet me një vendbanim, gjini, status punësimi, status të aftësisë së kufizuar dhe identitete të tjera mund të përballen me ndikime më të mëdha dhe më të rënda të fatkeqësive, të cilat mund të rezultojnë në një propabilitet më të lartë për të rënë në varfëri. Gjithashtu, është provuar që emergjencat ndikojnë në një akses të kufizuar të grave dhe vajzave në strehëza dhe të ardhura, si dhe rritjen e ngarkesës në familje dhe cenueshmërinë e tyre ndaj dhunës me bazë gjinore gjatë dhe pas fatkeqësive<sup>86</sup>. Ndaj, është e pashmangshme që të konsiderohet e rëndësishme ndërtimi i skenareve për mbrojtjen sociale në raste krizash dhe emergjencash si dhe të parashikohen buxhete të dedikuara me qëllim që mbrojtja sociale të jetë e përgjegjshme dhe adaptive, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të menaxhuar goditjet që prekin një pjesë të konsiderueshme të popullsisë. Ndërhyrjet duhet të ndihmojnë familjet dhe komunitetet që të kenë akses në burime për të ndërtuar resiliencën dhe për të rikuperuar mjetet e tyre të jetesës kundër fatkeqësive natyrore dhe goditjeve<sup>87</sup>. Njëkohësisht është e nevojshme që shërbimet e kujdesit social të ndërtojnë standarte, plane të trajnimit të personelit si dhe standarte për tu përgjigjur në situata krize dhe emergjencash duke garantuar mbrojtjen sociale për çdo individ në nevojë.

Strategjia Kombëtare për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë 2023–2030 ka evidentuar rëndësinë që aktivitetet e saj t'u përmbahen nevojave dhe kërkesave të grupeve të cënueshme dhe t'i përgjigjen në kohë këtyre nevojave përfshirë personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, fëmijëve, grave dhe vajzave<sup>88</sup>. Strategjia adreson rritjen e aftësive të grave dhe komuniteteve për t'u përgatitur dhe rikuperuar nga fatkeqësitë, dhe i kushton një vëmendje të vecantë adresimit të pabarazive gjinore që shkaktojnë humbje dhe ekspozim më të madh të fëmijëve grave dhe vajzave ndaj rreziqeve.

## 1.6. Konteksti Strategjik

Mbrojtja sociale është shumë komplekse pasi është e ndërvarur dhe e lidhur me një kuadër kompleks politik, strategjik dhe institucional të lidhur pazgjidhshmërisht me detyrimet ndërkombëtare, ndër të cilat dhe Axhenda 2030 e Kombeve të Bashkuara për zhvillimin e qëndrueshëm dhe anëtarësimi i Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

### Referencat strategjike ndërkombëtare

Strategjia kombëtare për mbrojtjen sociale 2024-2030 hartohet në përputhje me nenet 70 dhe 99, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, dokumentin i Partneritetit 2007 dhe është pjesë thelbësore e kuadrit afatgjatë strategjik të Shqipërisë të përcaktuar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE 2030).

Dokumentet kryesorë strategjik Evropian janë: (i) **Shtylla Evropiane për të Drejtat Sociale**<sup>89</sup> për një Evropë të Drejtë dhe Gjithëpërfshirëse përmes 20 parimeve të rëndësishme që synon të ndërtojë tregje pune funksionale dhe të drejta si dhe të ndërtojë sisteme të mirëqënies sociale ku çdo individ të përfitojë dhe askush të mos mbetet pas; (ii) **Karta Evropiane për të Drejtat e Njeriut; Plani Ekonomik dhe i Investimeve për**

<sup>85</sup> UN, 2022. Albania progress report.

<sup>86</sup> World Bank & GFDRR, 2022. Entry Points for Social Inclusion and Gender in Disaster Risk Management and Climate Resilience Development Policy Operations.

<sup>87</sup> World Bank & GFDRR, 2022. Entry Points for Social Inclusion and Gender in Disaster Risk Management and Climate Resilience Development Policy Operations.

<sup>88</sup> UN, 2022. Albania progress report.

<sup>89</sup> <https://ec.europa.eu/social>

**Ballkanin Perëndimor**<sup>90</sup> që synon integrimin e sukseshëm ekonomik të rajonit, përshpejtimin e harmonizimit me BE-në; reduktimin e hendekut dhe përshpejtimin e procesit të integritit në BE. Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor është plani i Komisionit Evropian nëpërmjet të cilit kërkohet të forcohet dialogu me Ballkanin Perëndimor për të zbatuar shtyllën Evropiane për të Drejtat Sociale dhe të përshpejtohet zbatimi i reformave prioritare në Programin e Reformës Ekonomike të çdo vendi në fushën e arsimit dhe aftësive, punësimit, mbrojtjes dhe përfshirjes sociale; (iii) **Strategjia Evropiane për Kujdesin**<sup>91</sup> që synon të sigurojë shërbime me cilësi të lartë, të mjaftueshme (affordable) dhe të aksesueshme për vendet e Unionit si dhe vendet aspiruese për t'u anëtarësuar ; (iv) **Strategjia Evropiane për të Drejtat e Fëmijës dhe Garancia për Fëmijën**<sup>92</sup> që synon të thyejë ciklin e varfërisë ndërbrezore, përjashtimin social si dhe promovon të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve. Kjo nismë e re e BE-së synon të plotësojë dhe ndërmarë veprime konkrete për realizimin e parimit 11 të Shtyllës Evropiane për të Drejtat Sociale të lidhur me “Kujdesin dhe mbështetjen për fëmijët”; (v) **Strategjia për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara 2021-2030**<sup>93</sup> që synon të promovjë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe të nxisë ndryshime konkrete përfshirë ata me aftësi të kufizuara intelektuale, përmes nismave që synojnë: nxitjen e pjesëmarrjes në vendimarrje, adresimin e dhunës ndaj grave me aftësi të kufizuara, njohja e rolit të familjes në plotësimin e të drejtave dhe ofrimin e mbështetjes për personat me aftësi të kufizuara, nxitjen e jetesës së pavarur, identifikimi i hershëm dhe një sërë prioritetesh të lidhura me aksesueshmërinë fizike, të informacionit etj. Në vecanti vëmendje i kushtohet fëmijëve dhe familjeve të tyre, grave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe individëve me nevoja komplekse për t'u adresuar si dhe familjet e tyre. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka nisur procesin e hartimit të planit për përafrimin me BE-në në vecanti në kapitujt 19 dhe 23 të cilat janë ngushtësisht të lidhura me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale. Ky plan pasi të finalizohet do të zbatohet përgjatë zbatimit të strategjisë dhe do të shërbejë më tej për informuar masa të caktuara të parashikuara në strategji.

Politikat dhe objektivat specifikë të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe Plani i Veprimit, janë, gjithashtu, në linjë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ/SDG)<sup>94</sup>, më konkretisht: (i) OZHQ 1: **Zhdukja e varfërisë kudo dhe në të gjitha format**; (ii) OZHQ 5: **Arritje e barazisë gjinore dhe fuqizim i grave**; (iii) OZHQ 8: **Promovim i rritjes së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike, punësim dhe punë për të gjithë**; (iv) OZHQ 10: **Reduktimi i pabarazive**; (v) OZHQ 4: **Sigurimi i arsimimit gjithëpërfshirës dhe krijimi i mundësive për të mësuarit gjatë gjithë jetës, për të gjithë**; (vi) OZHQ 16: **Paqe, drejtësi dhe institucione të forta**; (vii) OZHQ 17: **Partneritet për Objektivat**;

## Referencat Strategjike Kombëtare

Strategjia e Mbrojtjes Shoqërore lidhet drejtpërdrejtë me 16 strategji, dokumente politikash apo plane veprimi kombëtare. Konkretisht: (i) **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2030**<sup>95</sup> shtylla e tretë e së cilës ka në qendër burimet njerëzore si kapitalin më të cmuar në vend, duke synuar ofrimin e shërbimeve bazë publike, luftën kundër varfërisë dhe nxitjen e punësimit ,fuqizimit të sistemit të mbrojtjes shoqërore dhe mbështetjen e shtresave të veçanta më në nevojë të shoqërisë. Një nga drejtimet e Mbrojtjes Sociale nën shtyllën e Kohezionit Social është *Zhvillimi i Shërbimeve Shoqërore të Integuara*; (ii) **Plani Kombëtar për**

<sup>90</sup> <https://www.wbif.eu/eip>

<sup>91</sup> European Commission adopts the EU Strategy on the Rights of the Child and proposes a Council Recommendation for a European Child Guarantee - Employment, Social Affairs & Inclusion - European Commission (europa.eu)

<sup>92</sup> Council Recommendation 2021/1005 on Child Guarantee.

<sup>93</sup> A new ambitious EU Disability Strategy for 2021-2030

<sup>94</sup> <https://albania.un.org/sq/sdgs>

<sup>95</sup> VKM nr.80, datë 22.02.2023 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2022-2023.

**Integrim European (PKIE)2023<sup>96</sup>**, Kapitulli 19 “Politikat sociale dhe punësimi”, nënkaptulli mundësi të barabarta dhe antidiskrimi, përfshirja sociale, mbrojtja sociale, aftësia e kufizuar, mundësi punësimi që i kushton një fokus të veçantë decentralizimit lokal dhe zhvillimit të shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror dhe komunitar për të gjitha kategoritë vulnerabël, Kapitulli 23” Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”, që thekson nevojën për zgjerimin e rrjetit të shërbimeve të kujdesit shoqëror të integruara me synim formimin profesional dhe punësimin e shtresave në nevojë ( përfitues të ndihmës ekonomike, persona me aftësi të kufizuar, gratë e dhunuara, personat LGBTI+, Romët dhe Egjiptianët, etj.), Kapitulli 28 – “Shëndeti dhe Mbrojtja e Konsumatorit ku theksohet nevoja për të garantuar akses të barabartë në shërbimet cilësore të integruara socio- shëndetësore për shtresat vulnerabël, përfshirë minoritetin Rom dhe Egjiptian, të moshuarit, personat me probleme të shëndetit mendor, personat me aftësi të kufizuara, popullsinë rurale dhe që jeton në zona të largëta, dhe në veçanti gratë dhe vajzat që i përkasin grupeve që shpesh herë janë subjekti formave të shumëfishta të diskriminimit;

(iii) **Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe Planin e saj të Veprimit<sup>97</sup>** drejtimi strategjik 3 “ Zvogëlimi i të gjitha formave dhe praktikave të dëmshme , dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje”, objektivi specifik II.2 “ Rritja e aksesit në shërbimet mbështetëse të specializuara për gratë , burrat, të rinjtë, vajzat dhe djemtë nga të gjitha grupet , të cilat përjetojnë praktika të dëmshme , dhunë seksuale dhe forma të tjera të dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje , si në situatë normale ashtu dhe në situatë të krizave humanitare e gjendjeve të fatkeqësive natyrore”. Disa prej masave të parashikuara janë shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për të mbijetuarit e sulmeve seksuale dhe trafikimit për qëllime të shfrytëzimit seksual, nga të gjithë grupet; shtimin/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara të strehimit emergjent; shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara të strehimit afatgjatë; mbështetja financiare për OJF, të cilat ofrojnë shërbime të specializuara të formave të ndryshme, për rastet e dhunës me bazë gjinore , dhunës në familje e trafikimit;

(iv) **Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030<sup>98</sup>**, drejtimi i dytë strategjik - ofrimi cilësor i shërbimeve vendore sipas standarteve kombëtare, shoqëruar me rritje të performancës së bashkive dhe manaxhimit të burimeve njerëzore. Konsolidimi i rolit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore në ushtrimin e funksioneve të tyre, duke qartësuar mangësitë dhe mbivendosjet ligjore, institucionale dhe mekanizmat e financimit në marrëdhëniet ndërqeveritare; përmirësimi i manaxhimit të burimeve njerëzore në nivel vendor , shoqëruar me rritje të kapaciteteve administrative vendore me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike; përmirësimin e eficiencës së shërbimeve , përmirësimi i performancës së qeverisjes vendore janë disa prej objektivave. Në këtë strategji janë vendosur tregues specifik të lidhur me ngritjen e shërbimeve sociale në nivel vendor nëpërmjet financimit nga Fondi Social; (v) **Plani Kombëtar i Deinstitutionalizimit 2020-2022**. Proçesi i deinstitutionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, ndërtimi i një sistemi të përkujdesjes sociale të integruar funksionale dhe gjithëpërfshirëse, të deinstitutionalizuar zë një vend të rëndësishëm në këtë dokument; (vi) **Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025<sup>99</sup>**, I cili është i orientuar drejt 8 objektivave strategjike për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar. Objektivi strategjik 5 “ Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve /përfitimeve të aksesueshme , të

<sup>96</sup> VKM nr. 91, datë 9.02.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Integrim European 2022-2024 » <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2022/02/09/91>

<sup>97</sup> <https://shendetesia.gov.al/sp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx>

<sup>98</sup> [https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK\\_567\\_SKNDQV-2023-2030.pdf](https://konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_567_SKNDQV-2023-2030.pdf)

<sup>99</sup> VKM Nr.276, datë 12.05.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025” [https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-\\_2021-2025\\_AL.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/Plani-Kombetar-PAK-_2021-2025_AL.pdf)

përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin”, parashikon disa objektiva si monitorimi i efekteve të vlerësimit të aftësisë së kufizuar nga komisionet e reja, sipas modelit të drejtave të njeriut që përcakton KDKPAK-un, ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (cash) me kujdesin social cilësor, promovimi dhe nxitja e jetesës së pavarur nëpërmjet ofrimit të llojeve të reja të shërbimeve komunitare;

(vii) **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025**<sup>100</sup>, objektivi strategjik 6 që parashikon Përmirësimin e qasjes dhe rritjen e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale dhe objektivit specifik 3, rritjen e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e kujdesit shoqëror dhe modelimi i shërbimeve të reja të ofruara në komunitet; (viii) **Dokumenti Politik për Moshimin 2020-2024**<sup>101</sup> që parashikon që shërbimet sociale për të moshuarit realizohen nëpërmjet Shërbimeve të kujdesit shoqëror, që ofrohen në qendrat publike të shërbimeve si; qendrat komunitare, qendrat rezidenciale, qendrat ditore ose shërbime në shtëpi dhe financohen nga buxheti i shtetit dhe nga buxhetet vendore të organeve të qeverisjes vendore si dhe shërbimet e kujdesit shoqëror që ofrohen në qendra jopublike, nga organizata fitimprurëse dhe jofitimprurëse; (ix) **Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+**<sup>102</sup>, **2021-2027**, shtylla e parë “përmirësimi i aksesit të personave LGBTI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin, në përputhje me nevojat specifike të tyre dhe me standartet kombëtare të harmonizuara me ato evropiane/ndërkombëtare”; (x) **Strategjia e Zhvillimit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor Parësor në Shqipëri 2020-2025**<sup>103</sup>, objektivin Strategjik 5 “Mbulim shëndetësor universal“, shtimi i shërbimeve të reja dhe integrimi i shërbimeve shëndetësore me shërbimet psiko-sociale (kujdesi paliativ, kujdesi psikologjik, rehabilitimi fizik (fizioterapi), sigurimi i një bashkëpunimi të qëndrueshëm mes individëve, familjeve, komuniteteve dhe Kujdesit Shëndetësor Parësor si dhe objektivi VII.1 “Të organizojmë shërbimet e Kujdesit shëndetësor Parësor, gjithmonë e më të integruara me kujdesin social në nivel vendor; (xi) **Strategjia për Punësim dhe Formim Profesional 2021-2026**<sup>104</sup>, ku materializohet rëndësia e zgjerimit të mekanizmit të vlerësimit dhe referimit të rastit në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në njësitë administrative në nivel vendor dhe forcimit të bashkërendimit institucional për ofrimin e shërbimeve mbështetëse sociale, shëndetësore e arsimore që do të mundësonin krijimin e kushteve për punësim. Strategjia parashikon që në bashkëpunim me ofrues publikë, jopublikë dhe privatë të hartohen programe të nxitjes së punësimit dhe aftësisimit profesional për grupet e cënueshme, si të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara (si pjesë e fondit social të punësimit), përfituesit në moshë pune nga familjet e mbështetura me ndihmë ekonomike, punëkërkuarit afatgjatë, pakicat etnike, ata me arsim e kualifikim të ulët (si pjesë e ndërmarrjeve sociale, programeve të punës në komunitet, aktivizimit në punët publike të financuara nga bashkitë); (xii) **Strategjia Kombëtare për Rininë 2022-2029**, politika 3 “Mirëqënie aktive, e shëndetëshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave /rinjve, siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave /të rinjve /në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti); (xiii) **Strategjia Kombëtare të Arsimit 2021-2026**<sup>105</sup>, **vizioni** për një sistem arsimor cilësor i bazuar në parimet e gjithpërfshirjes dhe të të mësuarit gjatë të gjithë ciklit të jetës, që mundëson zhvillimin e potencialit të individit, duke kontribuar në mirëqënien personale të tij, si dhe forcimin e demokracisë dhe

<sup>100</sup><https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/46eb57a0095aac6d46fe42b6cfb302f66368453e0c284a07c0c7c9fd8d43760b.pdf>

<sup>101</sup> <http://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2020/01/vendim-2019-12-24-864.pdf>

<sup>102</sup> <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/01/LGBTI-NAP-2021-2027-AL-final.pdf>

<sup>103</sup> <https://qbz.gov.al/previe/f61689e7-a6b0-4e0a-95a1-ec652c465d3f/fz>

<sup>104</sup> <https://www.konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

<sup>105</sup> VKM nr 621, datë 22.10.2021 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026 dhe të Planit të Veprimit për Zbatimin e saj”

integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Rritja e bashkëpunimit me strukturat arsimore do të ketë si qëllim shkëmbimin reciprok të informacionit për fëmijët e moshës parashkollore dhe shkollore, për të realizuar vlerësimin e drejtë të aftësive, për kryerjen e veprimtarive bazë të jetës, në përputhje me grup-moshat, si dhe për të siguruar identifikimin dhe plotësimin e nevojave aftësuese të këtyre fëmijëve, në kuadrin e sistemit arsimor gjithëpërfshirës e special; (xiv) **Strategjia Ndërsëktoriale e Drejtësisë për të Mitur (2022-2026)**<sup>106</sup> synon të forcojë dhe të konsolidojë arritjet në fushën e drejtësisë penale për të mitur, aksesin në drejtësinë penale për të miturit, me qëllim për t'i mbajtur ata larg nga ripërfshirja në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre, që çdo fëmijë të ketë në çdo kohë akses tek një sistem miqësor për të rivendosur të drejtat e tij/e saj të cenuara në fushën familjare, civile, administrative dhe penale. SDM 2022-2026” adreson përparësitë e Qeverisë Shqiptare të mishëruara edhe në “Agjendën Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026”. Një sërë masash në këtë strategji lidhen me funksionet e pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve parandaluese dhe riintegruese për grupet në nevojë ku një ndër këto grupe janë të rinjtë në kontakt me ligjin;

(xv) **Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër trafikimit të personave (2021-2023)**. Misioni i PKV është promovimi i një reagimi efektiv, adekuat dhe të bashkërenduar për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave të bazuar në bashkëpunimin ndërkombëtar, bashkëpunimin efektiv ndër-institucional brenda vendit, pjesëmarrjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe përfshirjen së shoqërisë civile dhe komunitetit. Objektivi specifik 2 parashikon parandalimin, trajnimin e punonjësve të sistemit të mbrojtjes sociale, mbështetja e shërbimeve sociale si dhe bashkëpunimin ndërinstitucional; (xvi) **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021-2026)** e cila ka një pikëprerje të rëndësishme me strategjinë e mbrojtjes sociale të fokusuar në krijimin e një sistemi të mbrojtjes sociale me qendër fëmijët dhe trajtimin përgjatë ciklit të jetës, si dhe, fokusin tek procesi i deinstitucionalizimit të sistemit të kujdesit rezidencial për fëmijët;

(xvii) **Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030**, e cila përcakton objektivat dhe veprimet e formalizuara për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe vendos drejtimin strategjik për zhvillimet e mëtejshme të sistemit kombëtar. Strategjia i kushton vëmendje të posaçmë dhe adresimit të nevojave të grupeve të cënueshme dhe vulnerabël.

## 1.7. Konteksti institucional

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale** është institucioni kryesor, përgjegjës për hartimin dhe monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes, kujdesit dhe integritit të individëve dhe grupeve në nevojë.

**Shërbimi Social Shtetëror** është institucion në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, përgjegjës për zbatimin e politikave të ministrisë përgjegjëse për çështjet e ndihmës ekonomike, të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve të kujdesit shoqëror.

**Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve** është institucioni përgjegjës për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

<sup>106</sup> Në këtë Strategji dhe Planin e saj të Veprimit termat ‘i/e mitur’ dhe ‘fëmijë’ janë përdorur si sinonime ekuivalente të njëri-tjetrit dhe nënkuptojnë individin që nuk ka mbushur ende moshën 18 vjeç.

**Njësitë e Qeverisjes Vendore.** Sipas Reformës Territoriale të miratuar nëpërmjet ligjit nr. 115/2014, “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë dhe bazuar në ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, sigurimi dhe funksionimi i shërbimeve shoqërore për kategoritë në nevojë, përfshirë të moshuarit, është përgjegjësi e njërive të vetëqeverisjes vendore, përkatësisht për: - Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, - Ndërtimin dhe administrimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve sociale vendore, - Krijimin, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për çështjet sociale, të fondit social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj. Drejtoritë e Shërbimeve Sociale në nivel vendor kanë përgjegjësi për planifikimin, administrimin dhe ofrimin e asistencës sociale dhe shërbimeve sociale në nivel lokal. Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NjVRN), Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF), koordinatorët lokal përgjegjës për dhunën në familje dhe ndaj grave dhe punonjës të tjerë të shërbimeve sociale janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale komunitare, në nivel lokal, ndërtimin dhe administrimin e qendrave komunitare për ofrimin e shërbimeve sociale vendore si dhe krijimin e shërbimeve dhe tipologjive të ndryshme të shërbimit për t'u përgjigjur nevojave të grupeve të ndryshme në kontekstin lokal.

**Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor** është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributit dhe përfitimit të kujdesit shëndetësor, për të gjitha grupet përfituese.

**Instituti i Sigurimeve Shoqërore**, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është institucioni përgjegjës për zbatimin e politikave kombëtare të kontributeve dhe përfitimeve.

**Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore**<sup>107</sup>, është institucion në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përgjegjëse për kontrollin dhe verifikimin e zbatimit të standarteve të shërbimeve të kujdesit shoqëror në përputhje me standartet dhe kërkesat e ligjit “Për Shërbimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.

**Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror**,<sup>108</sup> është agjensi në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ngarkuar për garantimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore dhe shoqërore bazuar në standarte, nëpërmjet edukimit, certifikimit, akreditimit dhe kontrollit të sigurisë së shërbimeve për strukturat dhe profesionistët .

**Urdhëri i Punonjësve Social-** është ent publik jobuxhetor i pavarur, i krijuar përmes Ligjit Nr.10 171, datë 22.10.2009 PËR PROFESIONET E RREGULLUARA NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË por, ngushtësisht i lidhur me garantimin dhe ruajtjen në vazhdimësi e standardeve dhe praktikave të mira të ushtrimit të profesionit në fushën e punës sociale dhe mbrojtja e publikut nga veprimet joprofessionale dhe joetike të punonjësve sociale.

**Institucionet Publike Partnerë** në zbatimin e strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2024-2030 janë:

- Ministria e Financave dhe Ekonomisë
- Ministria e Arsimit dhe Sportit
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Drejtësisë
- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësisimit Profesional ( AKPA)

<sup>107</sup> VKM nr. 295/2013 “Për krijimin , organizimin dhe funksionimin e inspektoriait shtetëror të punës dhe shërbimeve shoqërore”

<sup>108</sup> VKM nr.637/2021” Për krijimin dhe funksionimin e Agjencisë së sigurimit të cilësisë së kujdesit shëndetësor dhe shoqëror



- Agjensia e Mbështetjes së Vetëqeverisjes Vendore
- Agjensia Kombëtare e Shërbimeve të Informacionit
- Instituti i Sigurimeve Shoqërore
- Inspektoriati i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
- Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
- Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor
- Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Palujtshme
- 61 Njësitë Vendore

## 1.8. Konteksti ligjor

- Ligji nr. 8417, datë 22.11.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar; (në veçanti Nenet 49, 51, 52, 55);
- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës (OKB)”;
- Ligji nr.7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në Konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”;
- Ligji nr. 104/2012, datë 8.11.2012 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”;
- Ligji nr. 108 , datë 2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB -së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”;
- Ligji nr. 8137, datë 31.07.1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut” dhe Protokollin nr. 7 i KEDNj;
- Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut;
- Ligji nr. 8774, datë 23.4.2001 “Për ratifikimin e Konventës nr.182 “Format më të këqija të punës së fëmijëve, 1999” të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”;
- Ligji nr. 9359, datë 24.3.2005 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët” ;
- Ligji nr. 10 071, datë 9.2.2009 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual”;
- Ligji nr. 10 425, datë 2/6/2011 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve;
- Ligji nr. 121, datë 24.11.2016, ”Mbi Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 163/2014 “Për urdhërin e punonjësve social në Republikën e Shqipërisë “;
- Ligji nr. 40/2016, i ndryshuar “Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë »;
- Ligji 18/2017 ”Për të drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”;
- Ligji nr.9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”;
- Ligji nr. 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar ;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”;

- Ligj nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbrit”, i ndryshuar;
- Ligj nr. 8626, datë 22.06.2000 “Për statusin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- Ligj Nr. 65/2016 datë 9.6.2016 “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”;
- Karta Europiane për Autonomi Lokale;
- VKM nr 597, datë 4.9.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” (ndryshuar me vendimin nr. 85, datë 10.2.2021; nr. 868, datë 29.12.2021; nr. 617, datë 22.9.2022);
- VKM nr. 182, datë 26.2.2020 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitim të pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal” i ndryshuar;
- VKM nr. 722, datë 11.11.2019 “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitim të aftësisë së kufizuar e të ndihmës personal, dhe të strukturave përgjegjëse e të detyrave të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr.31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, i ndryshuar;
- VKM nr.78, datë 7.2.2007 “Për masën, kriteret dhe procedurat e përfitimit të një pakete të veçantë higjieno-sanitare, për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë”, i ndryshuar;
- VKM nr.869, datë 18.6.2008 “Për zbatimin e ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “statusi i invalidit”, i ndryshuar;
- VKM nr.277 date 18.6.1997 “Për përfitimet nga statusi i të verbërit”;
- Vendim nr. 257, datë 5.5.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të asistencës sociale”;
- Vendim nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”, i ndryshuar;
- Vendim nr. 617, datë 20.10.2021 “Për treguesit statistikorë të vlerësimit e të monitorimit të programeve të ndihmës ekonomike, të pagesës për personat me aftësi të kufizuara dhe shërbimeve shoqërore, si edhe periodicitetin e mbledhjes së tyre”;
- Vendim nr. 751, datë 1.12.2022 “Për një mbrojtje të veçantë nga shteti për gratë e papuna me tre apo më shumë fëmijë të moshës deri në 18 vjeç”;
- Vendim nr. 56, datë 31.1.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”;
- Vendim nr. 174, datë 24.3.2023 “Për përcaktimin e formave të mbështetjes nëpërmjet subvencionit për ndërmarrjet sociale, për periudhën 2023–2025”;
- VKM Nr. 768 datë 15.12.2021 “Për përcaktimin e llojeve të shërbimeve sociale dhe shërbimeve të tjera specifike, llojeve të shërbimeve të vecanta”;
- VKM 518/2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar dhe rezidencial, kriteret, procedurat për përfitim të tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”;
- VKM Nr. 149, datë 13.3.2018 “Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare”;

- VKM 136/2018 “Për funksionimin dhe administrimin e regjistrit elektronik kombëtar të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;
- VKM Nr. 135, datë 7.3.2018 “Për miratimin e statutit të shërbimit social shtetëror”;
- VKM Nr. 848, datë 28.10.2020 “Për standardet, kriteret e procedurat e akreditimit të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror, si dhe të ofruesve të tyre”;
- VKM Nr. 624, datë 29.07.2020 “Për kriteret dhe procedurën e programit të certifikimit të profesionistëve të shërbimeve të kujdesit shoqëror”;
- VKM nr. 111 datë 23 shkurt 2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social;
- VKM Nr. 150 datë 20/03/2019 “Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

DRAFT

## II. Situata aktuale e Mbrojtjes Sociale në Shqipëri

### 2.1. Reforma e Ndhmës Ekonomike dhe përfitimeve të tjera

**Shënjestrimi.** Është 9% e popullsisë përfituese nga programi i ndihmës ekonomike (64,000 familje në vitin 2022 me 226.530 individë anëtarë), ndërsa janë edhe 4,348 familje që kanë përfituar nga fondi 6% në dispozicion të pushtetit vendor<sup>109</sup>. Gjatë vitit 2021 krahasuar me vitin 2019, pati rritje të numrit të familjeve rome dhe egjiptiane përfituese të skemës së ndihmës ekonomike (736 familje më shumë), i familjeve që kishin anëtarë me aftësi të kufizuara perkatësisht (1,044 familje më shumë)<sup>110</sup>. Për vitin 2019, rezultojnë 4,932 gra përfituese nga skema e Ndhmës Ekonomike (NE)<sup>111</sup>. Numri i përfituesve që janë mbështetur nga kategoritë viktime të dhunës, trafikimit dhe përfitues që kanë lindur 3 ose më shumë fëmijë është 1,956. Vitet e fundit, një numër në rritje e grave rome dhe egjiptiane janë mbështetur me ndihmë/përfitime ekonomike apo janë përfshirë në programet e riintegritimit (nga 112 gra rome dhe 89 gra egjiptiane në vitin 2016 në 1,785 gra rome dhe 846 gra egjiptiane në vitin 2019)<sup>112</sup>. Në lidhje me mbështetjen e grave të dhunuara, të cilat kanë një urdhër mbrojtjeje, janë trajtuar me pagesë 3,000 lekë (rreth 25 euro) në muaj 408 gra në vitin 2018, 509 gra në vitin 2019, dhe 603 gra në vitin 2020. Kurse viktime të trafikimit të trajtuara me pagesën 3,000 lekë (rreth 25 euro) në muaj janë 11 raste për vitin 2018, 9 raste për vitin 2019 dhe 10 raste për vitin 2020<sup>113</sup>. Kjo masë është rritur në vitin 2022, në trefishim të saj, 9000 lekë.

Rajonet me numër të lartë përfituesish të Ndhmës Ekonomike janë Elbasani, Dibra, Korça dhe Kukësi. Këto katër rajone janë kryesisht rurale dhe përbëjnë më shumë se 70 përqind të numrit të përgjithshëm të përfituesve të Ndhmës Ekonomike. Gjithashtu, në këto qarqe vihet re edhe një përqindje e lartë e përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune. Përbërja gjinore e përfituesve të ndihmës ekonomike është pothuajse e barabartë edhe pse numri i burrave është paksa më i lartë se i grave. Më shumë se 75 përqind e përfituesve të Ndhmës Ekonomike në moshë pune i përkasin grupmoshës nga 18 deri në 50 vjeç. Një pjesë e madhe e përfituesve të NE kanë përfunduar arsimin 8-9-vjeçar ose atë të mesëm. Rreth 5 përqind kanë përfunduar shkollën fillore dhe vetëm rreth 4 përqind nuk kanë mbaruar asnjë lloj shkolle<sup>114</sup>. Për vitin 2022 ishin 10,008 persona me aftësi të kufizuara anëtarë të familjeve në ndihmë ekonomike ose 4.4 % të numrit të përgjithshëm të individëve. Numri i fëmijëve 0-18 vjeç në skemën e Ndhmës Ekonomike është 77,033 fëmijë, nga të cilët 54% e tyre ose 42,025 janë të grupmoshës 6-14 vjeç<sup>115</sup>.

Në vitin 2020 dhe 2021 pati një rritje të numrit të familjeve përfituese kryesisht për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-9 (shifra maksimale e përfituesve të Ndhmës Ekonomike u arrit në muajin qershor 2020 me 71,091 familje). Për të njëjtin shkak në vitin 2020 u rrit numri i familjeve që përfituan nga fondi 6 përqind (2,533 familje në muajin janar 2020 dhe 4,102 familje në muajin dhjetor 2020)<sup>116</sup>.

<sup>109</sup> Duke përfshirë përfituesit nga fondi 6 përqind, numri i përgjithshëm i familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike ishte 59,546 në vitin 2018, 63,455 në vitin 2019, 66,472 në vitin 2020 dhe 68,246 në vitin 2021.

<sup>110</sup> MSHMS, 2021. Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale (2020-2-23). Raport Progresi 2020.

<sup>111</sup> MSHMS, 2021. Raport mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga komiteti i palëve të konventës së këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

<sup>112</sup> UN, 2021. Fifth National Periodic Report on the implementation of the Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination against Women to the Committee on the Elimination of Discrimination against Women.

<sup>113</sup> MSHMS, 2021. Raport mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga komiteti i palëve të konventës së këshillit të Evropës për arandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

<sup>114</sup> ILO, Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri, 2023.

<sup>115</sup> UNICEF, Raporti Progresit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019-2023, viti 2022.

<sup>116</sup> Të dhënat i referohen statistikave të SHSSH.

Për vitin 2020, u rrit me 32% numri i grave kryefamiljare përfituese të skemës së ndihmës ekonomike (gjithsej 6,492 përfituese për këtë vit), të cilat gjatë periudhës mars-qershor përfituan dyfishin e masës së ndihmës ekonomike<sup>117</sup>.

95% e familjeve që aplikojnë për ndihmë ekonomike e përfitojnë atë. Për familjet aplikante të refuzuara nga sistemi i pikëzimit ekziston dhe funksionon mekanizmi i ankimimit dhe i apelimit. Në periudhën kohore 2015-2021, rezultoi që numri total i aplikimeve të refuzuara dhe po kështu numri total i ankesave të jetë në ulje. Zyrat bashkiake deklarojnë se numri i ankesave të rregjistruara është i ulët për shkak se aplikantët nuk preferojnë të paraqesin zyrtarisht ankimimin e tyre si dhe fondi 6% në dispozicion të bashkisë apo fonde të veta të alokuara prej tyre, kanë ndihmuar për trajtimin e familjeve të refuzuara nga formula e pikëzimit, por që janë në nevojë për ndihmë sociale. Ekziston sistemi i ankimimit dhe i kontrollit mbi lighshmërinë e përfitimit të ndihmës ekonomike nga ana e familjeve. Në rast të konstatimit të paligshmërisë vendosen penalitete për administratorët dhe familjeve u hiqet ndihma. Nuk ka statistika periodike të përpunuara lidhur me rastet e abuzimeve sipas njësive në raport me numrin e aplikimeve, duke vështirësuar qartësinë për përmasën e këtij fenomeni.

Rezultoi që gabimet në aspektin e përfshirjes së familjeve në NE janë ulur ndjeshëm në zonat urbane, por ende ekzistojnë përjashtime në zonat rurale për shkak të mungesës së informacionit të saktë për asetet/pasuritë si toka dhe blegtoria<sup>118</sup>. Ka fakte që provojnë që ekziston mundësia e përjashtimit të familjeve të varfëra, vecanërisht në zona rurale, familje me një person dhe ato që kanë në përbërje të tyre anëtarë të grupmoshës 50-55 vjeç që hasin vështirësi për t'u punësuar. Rregjistri elektronik i ndihmës ekonomike në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit, prej vitit 2018, ka një modul të vecantë për rregjistrimin e ankimeve, por popullimi i tij me të dhëna është i paplotë dhe rastësor dhe përpunimi i tyre gjithashtu<sup>119</sup>. Për të gjithë ata që nuk gjejnë zgjidhje në institucionet qendrore dhe vendore të ngarkuara drejtpërdrejtë me zbatimin e skemës së NE, Qeveria Shqiptare ka krijuar platformën e bashkëqeverisjes si një portë ku qytetarët mund të shprehin shqetësimet e tyre për institucionet publike. Ulja e ankimeve mund të jetë pasojë e presionit që ky kanal komunikimi ka ushtruar mbi institucionet publike për të kryer në kohë funksionet e tyre.

**Përshtatshmëria e përfitimeve në skemën e Ndhmës Ekonomike.** Legjislacioni shqiptar përcakton masën e përfitimit nga programi i ndihmës ekonomike që ka për bazë përbërjen e familjes dhe madhësinë e saj. Vlera e përfitimit të NE është si më poshtë: (i) 1,800.00 lek për familjet me një të rritur, 3,060.00 lek për familjet me dy të rritur, 4,320.00 lek për familjet me 3 të rritur dhe 5,580.00 lek për familjet me katër të rritur; (ii) 2,700.00 lek për familjet me një të rritur dhe një fëmijë; (iii) 3,960 lek për familjet me dy të rritur dhe një fëmijë; (iv) 4,860.00 lek për familjet me dy të rritur dhe dy fëmijë; (v) 5,760.00 lek për familjet me dy të rritur dhe tre fëmijë. Familjet përfituese të NE janë më së shumti me 3, 4 dhe 5 anëtarë<sup>120</sup>. Shuma maksimale e ndihmës ekonomike është vendosur në masën 150 për qind të pensionit social. Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale” shfuqizoi dispozitën për ofrimin e pagesës së pjeshme të Ndhmës Ekonomike, duke parashikuar kështu ofrimin e pagesës së plotë për të gjithë përfituesit<sup>121</sup>.

<sup>117</sup> MSHMS, 2021. Raport mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga komiteti i palëve të konventës së këshillit të Evropës për arandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

<sup>118</sup> ILO, Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri, 2023.

<sup>119</sup> 129 ankime rezultojnë në total gjatë periudhës 2019-2020 nga të cilat 69 rregjistruar në vitin 2020.

<sup>120</sup> NE benefit levels are generated from MIS, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.9.2019, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 617, datë 22.9.2022 dhe Udhëzimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 4, datë 17.02.2017 “Për përllogaritjen e përfitimit të ndihmës ekonomike.

<sup>121</sup> Si rezultat, 15,000 familje kaluan nga përfitimet e pjeshme në përfitime të plota. Raportohet se rreth gjysma e familjeve përfituese të Ndhmës Ekonomike kanë marrë përfitime të pjeshme në vitin 2013.

Në vitin 2021 u bënë disa rishikime të masës së NE për kategori të caktuara si: dyfishimi i masës së NE për familjet me 3 e më shumë fëmijë ndërsa familjet e tjera një shtesë prej 10%, dhe trefishim të pagesës përjetimët, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare<sup>122</sup>. Në vitin 2022 u krye një rritje tjetër e masës së NE për kategori të tjera si dyfishim i pagesës për gratë kryefamiljare me deri dy fëmijë dhe dyfishim për personat mbi 65 vjeç, të cilët nuk përfitojnë pension pleqërie apo pension social. Familjet e tjera të skemës përfituan edhe 10% më shumë mbi rritjen e fillim vitit 2022<sup>123</sup>. Vitet e fundit, një numër në rritje e grave rome dhe egjiptiane janë mbështetur me ndihmë/përfitime ekonomike apo janë përfshirë në programet e riintegrit (nga 112 gra rome dhe 89 gra egjiptiane në vitin 2016 në 1,785 gra rome dhe 846 gra egjiptiane në vitin 2019)<sup>124</sup>. Në lidhje me mbështetjen e grave të dhunuara, të cilat kanë një urdhër mbrojtjeje, janë trajtuar me pagesë 3,000 lekë (rreth 25 euro) në muaj 408 gra në vitin 2018, 509 gra në vitin 2019, dhe 603 gra në vitin 2020. Kurse viktimat e trafikimit të trajtuara me pagesën 3,000 lekë (rreth 25 euro) në muaj janë 11 raste për vitin 2018, 9 raste për vitin 2019 dhe 10 raste për vitin 2020<sup>125</sup>. Në vitin 2022 u trefishua pagesa e tyre.

Familjet përfituese të ndihmës ekonomike janë përfituese dhe të një numri përfitimesh të tjera si kompensimi për konsumin e energjisë elektrike; subvencionimi i familjeve me fëmijë në masën 300 lekë për çdo fëmijë deri në moshën 15 vjeç që ndjek shkollën; kompensimi me 110 lekë për çdo vaksinim të kryer; 100 lekë shtesë për fëmijë në muaj për familjet me trenjakë, katërnjakë dhe pesënjakë; 9,900 lekë në muaj për gratë e trafikuar dhe viktimat e dhunës në familje; shërbime shëndetësore falas në institucionet e kujdesit shëndetësor parësor dhe sekondar; Çerdhe dhe kopshte falas; Shkollim universitar falas; Bursa për studime universitare; Tekstet shkollore falas për arsimin e detyrueshëm; Përfitime nga programet sociale të strehimit; (vii) Përrjashtim nga tarifatat për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Vlera totale e pagesës së Ndihmës Ekonomike do të ishte më e lartë nëse vlerësoheshin në lek përfitimet shtesë në vlerë dhe në natyrë.

Ndonëse legjislacioni nuk përcakton minimumin e nevojave që duhen plotësuar nëpërmjet NE, ekziston kufiri i varfërisë që përfaqëson minimumin e të ardhurave që një individ duhet të disponojë për të mos u konsideruar në rrezik varfërie. Ky nivel të ardhurash ka rezultuar 191.791 lek/year në vitin 2021 dhe është orientues në vlerësimin se nivelit të NE. Në vlerat e vitit 2022, pagesa e Ndihmës Ekonomike rezulton ende e ulët në raport me kufirin e të ardhurave në rrezik varfërie apo me pagën minimale.

**Dalja nga skema e NE.** Ligji nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale”<sup>126</sup> parashikon që pagesa e Ndihmës Ekonomike kufizohet në kohë për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) vjet, me përjashtim të përfituesve mbi moshën e pensionit dhe nënave me fëmijë në ngarkim. Kjo nënkupton që përfituesit në moshë pune pritet të dalin të pavarur dhe të ri integrohen në tregun e punës brenda kësaj periudhe pesëvjeçare. Në zbatim të ligjit, me një vendim të qeverisë<sup>127</sup> u përcaktua mekanizmi i bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese

<sup>122</sup> Vendimi nr.868, datë 29.12.2021, “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” .

<sup>123</sup> Vendimi nr. 617 ,datë 22.9.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike.

<sup>124</sup> UN, 2021. Fifth National Periodic Report on the implementation of the Convention on the Elimination of all Forms of Discrimination against Women to the Committee on the Elimination of Discrimination against Women.

<sup>125</sup> MSHMS, 2021. Raport mbi zbatimin e rekomandimeve adresuar Shqipërisë nga komiteti i palëve të konventës së këshillit të Evropës për arandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (Konventa e Stambollit).

<sup>126</sup> Shih edhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 597, datë 4.09.2019, “Për procedurat, dokumentacionin dhe masën mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e ndihmës ekonomike të kushtëzuar”.

<sup>127</sup> Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.882, datë 24.12.2019

të ndihmës ekonomike, i cili parashikonte Programin Kombëtar për Daljen nga skema e Ndhmës Ekonomike për përfituesit në moshë pune. Aktualisht është aktivizuar mekanizmi i referimit mbi bazën e të cilit funksionojnë 12 komisione rajonale vlerësimi<sup>128</sup> që kryejnë referimin për punësim të përfituesve në moshë pune. Gjatë vitit 2022 komisionet rajonale kanë përgatitur 17,000 profile të përfituesve dhe i kanë referuar pranë Zyra të Punësimit, janë punësuar 2,501 individë nga skema e NE dhe janë regjistruar në formim profesional 1,077 individë<sup>129</sup>.

**Administrimi i Programit të Ndhmës Ekonomike.** Sipas ligjit nr. 57/2019 “Për Asistencën Sociale”, grupet që përfitojnë nga skema e mbështetjes me ndihmë ekonomike janë: familjet në nevojë me të ardhura të pamjaftueshme; jetimët që nuk janë të sistemuar në institucionet e përkujdesit social; prindërit me më shumë se dy fëmijë të lindur në të njëjtën kohë; viktimat e trafikimit; dhe viktimat e dhunës në familje. Proçesi i aplikimit për mbështetje nga programi i ndihmës ekonomike fillon nga kryefamiljari, asistohet dhe verifikohet nga administratori shoqëror, përpunohet përmes formulës së pikëzimit nga zyra rajonale e Shërbimit Social. Familjet e pa kualifikuara kanë të drejtë të ndjekin sistemin e apelimit të vendimit të Zyrës Rajonale të Shërbimit Social. Këshilli bashkiak është autoriteti që vendos mbështetjen e familjeve të skualifikuara në kuadrin e fondit 6% të vendosur në dispozicion të tij. Në rast refuzimi të aplikantit për shkak të deklaramit të rremë ose mospërbushjes së kërkesës në lidhje me punën, pagesa pezullohet për 6 ose 12 muaj<sup>130</sup>.

Proçesi i aplikimit, verifikimit dhe kualifikimit/refuzimit është lehtësuar për shkak të dixhitalizimit. Dixhitalizimi i skemës së ndihmës ekonomike ka mundësuar verifikimin në kohë reale të informacioneve të aplikuesit nga komunikimi me sistemet e tjera elektronike duke siguruar shpejtësinë, transparencën e proçesit dhe raportimet periodike si dhe nëpërmjet një moduli të ri të shtuar në të për kontrollin dhe profilin e riskut është mundësuar zbulimi i rasteve të mundshme të abuzimit<sup>131</sup>. Përdorimi i formulës së pikëzimit ka prodhuar një rezultat të rëndësishëm lidhur me zvogëlimin e përfitimit të padrejtë të ndihmës ekonomike nga ana e shumë aplikuesve.

MSHMS dhe SHSSH kanë punuar me qëllim ngritjen e kapaciteteve duke trajnuar 100% punonjësit për monitorimin dhe vlerësimin e skemës së ndihmës ekonomike në 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH<sup>132</sup>. Buxheti për pagesat e Ndhmës Ekonomike, që nga viti 2010, përcaktohet në bazë të vlerësimeve të nivelit të varfërisë dhe shifrave historike të përfituesve për secilën bashki. Decentralizimi fiskal dhe administrativ pas vitit 2015 i ngarkoi një rol kyç njësisve vendore në administrimin e ndihmës ekonomike nëpërmjet administratorëve shoqërorë, si pjesë e Njësisve të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit, të cilët duhej të krijoheshin në secilën njësi administrative<sup>133</sup>. Rezulton që këto njësi nuk janë krijuar ende në 37 përqind të njësisve administrative dhe detyrat e administratorit në këto njësi kryhet nga punonjësit socialë. Nga rezultatet e një anketimi të kryer në 61 bashkitë rezulton që ka 450 administratorë socialë, por pjesa më e madhe e tyre kryejnë më shumë se një funksion, ndërsa për 80% të bashkive numri aktual i stafit përgjegjës për administrimin e Ndhmës Ekonomike është i pamjaftueshëm. Sa i përket zhvillimit të stafit, 56 përqind e bashkive nuk ofrojnë asnjë mundësi trajnimi për stafin e tyre<sup>134</sup>.

<sup>128</sup> Urdhërit të Përbashkët të MSHMS dhe MFE nr.148, datë 28.02.2022.

<sup>129</sup> UNICEF, Raporti Progresit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019-2023, viti 2022.

<sup>130</sup> ILO, Reforma e Programit të Ndhmës Ekonomike në Shqipëri, 2023.

<sup>131</sup> UNICEF, Raporti Progresit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019-2023, viti 2022.

<sup>132</sup> UNICEF, Raporti Progresit të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2019-2023, viti 2022.

<sup>133</sup> Në zbatim të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit social”, çdo njësi të pushtetit vendor i kërkohet të krijojë Njësinë e Vlerësimit të Nevojave dhe të Referimit.

<sup>134</sup> UNICEF, Kujdesi shoqëror në bashki-mjedisi institucional, kaacitetet, problematika, qershor 2022.

## 2.2. Skemat e mbështetjes për Aftësinë e Kufizuar

**Mbështetja financiare.** Numri i personave me aftësi të kufizuara<sup>135</sup>, që përfituan pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar nga buxheti shtetit për vitin 2022 ishte 143,973, prej të cilëve 72,838 invalidë pune dhe 71,135 përfitues nga skemat jokontributive të aftësisë së kufizuar (52,562 sipas skemës së vlerësimit bio psiko social; 12,696 sipas statusit të të verbërit; 5,871 sipas stasit të individëve para e tetraplegjikë). 17,848 përfitues të skemave jokontributive, përfituan pagesën për ndihmësin personal. 19,369 persona me aftësi të kufizuara përfituan kompensime të paketës higjeno-sanitare, kompesim të energjisë elektrike dhe telefonisë<sup>136</sup>. Numri i fëmijëve që përfituan pagesa për shkak të aftësisë së kufizuar ishte 14,106.

Aplikimi i modelit bio-psiko-social, ndikoi në përshkallëzimin e pagesave të aftësisë së kufizuar në katër nivele dhe ato të ndihmësit personal në dy nivele. Pagesa bazë e përfitimit mujor, sipas këtij modeli, është sa 150% të pensionit social<sup>137</sup>. Nisur nga niveli i aftësisë së kufizuar (4 nivele), përfitimet mujore mund të variojnë nga 7,292 lekë për persona me aftësi të kufizuara të lehta deri në 14,584 lekë për ata me aftësi të kufizuara të thella<sup>138</sup>. Pagesa e ndihmësit personal, zakonisht një anëtar i familjes së personit me aftësi të kufizuara, ofrohet në dy nivele, dhe është përkatësisht 9,723 lekë për shërbime të herëpashershme dhe 14, 584 lekë për shërbime të përherëshme. Personat me aftësi të kufizuara që ndjekin shkollën ose trajnimin profesional përfitojnë 200% të përfitimit bazë të aftësisë së kufizuar, ndërsa ata që ndjekin universitetin përfitojnë 300% të përfitimit bazë. Personat me aftësi të kufizuara i nënshtrohen riekzaminimeve periodike<sup>139</sup> për të përfituar pagesa nga skema e mbrojtjes sociale.

**Përfitime të tjera.** Personat me aftësi të kufizuara, në bazë të statusit që ato kanë, mbështeten edhe me bonuse dhe rimbursime si me pagesën e energjisë elektrike, telefonisë, ndihmës ekonomike për invalidët e punës që i përkasin skemës së ISSH, rimbursimin e karburantit për personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që kanë edhe statusin e invalidit të punës. Një mbështetje shtesë financiare u ofrua gjatë periudhës së pandemisë për të përballuar situatën e jashtëzakonshme dhe më pas, për zvogëluar efektet e krizës të shkaktuar nga lufta në Ukrainë.

Skema mbështetëse financiare ofrohet për nxënësit me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor, si masa lehtësuese të nevojshme për të përshpejtuar apo arritur de facto barazinë, sikurse parashikohet në KDPAK. Skemat e mbështetjes garantojnë: (i) transport falas<sup>140</sup>; (ii) trajtim falas në institucionet e arsimit special<sup>141</sup>; (iii) tekste falas<sup>142</sup>; (iv) pagesa për mbështetje për nevojat që lidhen me arsimimin, për fëmijët me aftësi të kufizuara në moshë shkollore, që ndjekin arsimin në ciklin e ulët, ciklin e mesëm të ulët, ciklin e mesëm të lartë, arsimin universitar dhe në arsimin pasuniversitar, si shpjeguar në paragrafin më lart; (v) përjashtim nga tarifa vjetore e studimit<sup>143</sup> për studentët, persona me aftësi të kufizuara, të vërtetuar nga

<sup>135</sup> Të dhëna MSHMS, janar- shkurt 2023.

<sup>136</sup> Të dhëna të MSHMS, janar-shkurt 2023.

<sup>137</sup> VKM Nr. 360, datë 05.06.2019, "Për miratimin e dokumentit të politikave" Reforma e Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar në Sistemin e Mbrojtjes Sociale dhe Planin e Veprimit të tij 2019-2024".

<sup>138</sup> Të dhëna të MSHMS, Nëntor 2022, por pyet Enin për VKM përkatës.

<sup>139</sup> Raporti i monitorimit për vitin 2022, i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019-2023.

<sup>140</sup> VKM-së Nr 682, datë 29/07/2015 i ndryshuar, "PËR PËRDORIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR TRANSPORTIMIN E PUNONJËSVE ARSIMORË QË PUNOJNË DHE TË NXËNËSVE QË MËSOJNË JASHTË VENDBANIMIT".

<sup>141</sup> VKM-në Nr. 753 datë 13/12/2017, "PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE, PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE".

<sup>142</sup> Bazuar në VKM-në e përvitshme për tekstet shkollore falas për grupet e prekshme.

<sup>143</sup> VKM-së Nr. 269, datë 29.03.2017 ndryshuar me VKM-në Nr. 40 datë 23.01.2019 dhe VKM-në Nr. 251 datë 27.03.2020, "Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale në pamundësi financiare për të mbuluar tarifën vjetore të shkollimit".



ekipet e vlerësimit, si përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe studentët që kanë të paktën njërin nga të dy prindërit me aftësi të kufizuara.

**Mbështetja për punësim.** Personat me aftësi të kufizuara, punëkërkues të papunë, të regjistruar pranë zyrave të punësimit, përfitojnë pagesë papunësie. Niveli i përfitimit të pagesës së papunësisë është i njëjtë për të gjithë punëkërkuesit e tjerë<sup>144</sup>. Ndërkohë, në përpjekje për zbatimin e Strategjisë për Punësim dhe Formim Profesional 2021-2026<sup>145</sup>, Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me aftësi të Kufizuara 2021-2030<sup>146</sup>, dhe Ligjit për Nxitjen e Punësimit<sup>147</sup>, si edhe shtrirjes së efektit të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar, po punohet për krijimin dhe zgjerimin e mekanizmit të vlerësimit dhe referimit të rastit, në bashkëpunim me njësitë e vlerësimit të nevojave dhe referimit në njësitë administrative në nivel vendor, si edhe forcimin e bashkërendimit institucional për ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe shërbimeve të tjera mbështetëse, që do të mundësonin krijimin e kushteve për punësim për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara. Në kuadër të zbatimit të reformës e të modelit të ri të shërbimeve në tre nivele<sup>148</sup>, ka filluar puna edhe për të reformuar sistemin e vlerësimit të kapaciteteve për punë dhe profilizimin e punëkërkuesve të papunë me aftësi të kufizuara, që do të vazhdojë me hartimin dhe ndjekjen e planeve individuale të punësimit për të ofruar mbështetjen e nevojshme për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësit.

Kuadri operacional për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit është plotësuar me programe që variojnë nga mbështetje me subvencionim të kostos së punësimit, trajnim në vendin e punës, praktika profesionale, deri në programe të tilla si: vetëpunësimi dhe puna në komunitet<sup>149</sup>. Përpjekje janë bërë për të nxitur përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha programet e nxitjes së punësimit. Ligji i ri nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", parashikon dhënien e shërbimeve mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara për aftësimin dhe rehabilitimin e tyre për punë, si dhe asistencë për vlerësimin e aftësisë për punë të personit me aftësi të kufizuara dhe njëkohësisht mundëson krijimin e Fondit Social të Punësimit, të dedikuar për aftësinë e kufizuar, i cili do të shërbejë për të siguruar nxitjen e punësimit, integrimin dhe përfshirjen sociale të personave me aftësi të kufizuara. Në proces reformimi është edhe sistemi i arsimit e formimit profesional për të garantuar mbështetjen e nevojshme për aftësimin profesional të aksesueshëm, gjithëpërfshirës e cilësor për personat me aftësi të kufizuara.

Një element mbështetës dhe inkurajues i politikës së re të punësimit për personat me aftësi të kufizuar është vazhdimi i përfitimit të pagesës për aftësinë e kufizuar edhe pas punësimit për personat me aftësi të kufizuara që e marrin këtë pagesë nga skema jokontributive.

MSHMS raporton të ketë lidhur 72 marrëveshje bashkëpunimi më fokus menaxhimin e rastit të personave me aftësi të kufizuara të referuar nga ekipet e vlerësimit bio psiko social të aftësisë së kufizuar, përfshirë edhe ato me institucione në fushën e arsimit, formimit profesional dhe punësimit. Marrëveshjet janë lidhur mes Shërbimi Social Shtetëror dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Drejtoritë Rajonale të Punësimit e Arsimit dhe Formimit Profesional, Bashkitë<sup>150</sup> dhe synojnë ngritjen e mekanizmit të referimit për punësimin e personave me aftësi të kufizuara, koordinimin e përpjekjeve për arsimin e formimin profesional gjithëpërfshirës, orientimin drejt shërbimeve mbështetëse për punësim dhe atyre në komunitet.

---

<sup>144</sup> VKM Nr. 161/2018, "Për pagesën e të ardhurës nga papunësia".

<sup>145</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

<sup>146</sup> VKM Nr. 276, datë 12.5.2021 për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025.

<sup>147</sup> Ligj. Nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit".

<sup>148</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

<sup>149</sup> <https://konsultimipublik.gov.al/Konsultime/Detaje/561>

<sup>150</sup> 60 marrëveshje bashkëpunimi të firmosura me bashkitë.

**Zgjerimi i shërbimeve, deinstitutionalizimi dhe krijimi i shërbimeve të reja.** Personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për shërbime përgjatë të gjithë ciklit të jetës<sup>151</sup>. Gjatë shtrirjes së reformës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror, MSHMS ka pasur në vëmendje që të jenë përfitues të gjithë grupmoshat e personave me aftësi të kufizuara. Fëmijet me aftësi të kufizuara përbëjnë 9% të numrit të përfituesve (n=3819) nga shërbimet shoqërore në shkallë vendi<sup>152</sup>. Funkcionojnë 87 shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara në të gjithë vendin, të cilat përbëjnë rreth 17.6% të numrit të përgjithshëm të shërbimeve shoqërore të ofruara në vend (493).

Të rriturit me aftësi të kufizuara përbëjnë 4% të numrit të përfituesve nga shërbimet e përkujdesit shoqëror në shkallë vendi. Numri shërbimeve të dedikuara për ta është 29 ose 5.8% e numrit total të shërbimeve të ofruara në vend, nga të cilat përfitojnë 1,524 të rritur me aftësi të kufizuara.

Aktualisht, ka ende shumë bashki, në të cilat shërbimet për personat me aftësi të kufizuara mungojnë krejtësisht, qofshin ata fëmijë apo të rritur. 47 bashki nuk kanë asnjë shërbim për të rriturit me aftësi të kufizuara dhe 27 bashki nuk kanë asnjë shërbim për fëmijët me aftësi të kufizuara<sup>153</sup>. Fondi social ka shërbyer si një mundësi modeste për zhvillimin e këtyre shërbimeve. 9.3% e fondit social<sup>154</sup> të vitit 2022 u alokua për shërbime për personat me aftësi të kufizuara në katër bashki të vendit nga të cilat morën shërbime 1,048 persona me aftësi të kufizuara (ose 14% e numrit të përgjithshëm të personave që morrën shërbime nga shërbimet e krijuara në kuadrin e këtij Fondi).

**Deinstitutionalizimi i shërbimeve të përkujdesit shoqëror,** ka qenë dhe vazhdon të jetë një nga objektivat prioritarë të reformës së shërbimeve të përkujdesit shoqëror. Shërbimet për personat me aftësi të kufizuara të të gjitha moshave, qofshin ato gjithëpërfshirëse apo specifike, kontribuojnë në perfshirjen e pjesëmarrjen e tyre, duke synuar parandalimin e institutionalizimit dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse dhe ndihmës së nevojshme në komunitet. Në rastin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, fokusi i mbështetjes është familja, me të gjitha tipologjitë e shërbimeve për të cilat ajo ka nevojë, për të parandaluar ndarjen e fëmijës prej saj.

Reformimi i sistemit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, ka pasur një vëmendje të shtuar në zbatimin e planit të deinstitutionalizimit të shërbimeve rezidenciale të përkujdesit shoqëror<sup>155</sup>, sidomos për fëmijët pa kujdes prindëror, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara të vendosur në institucionet rezidenciale të përkujdesit. Nën zbatim të planit të deinstitutionalizimit, 143 fëmijë me aftësi të kufizuara u mbështetën me shërbime të specializuara lëvizëse për të parandaluar vendosjen e tyre në institucionet e përkujdesit shoqëror, si edhe 46 fëmijë me aftësi të kufizuara (4.2% e numrit total të fëmijëve të vendosur në familje kujdestare në të njëjtën periudhë) u vendosën në familje kujdestare gjatë periudhës 2020-2023.

Fëmijët e të rriturit me aftësi të kufizuara në Shqipëri marrin shërbime edhe nga qendra të përkujdesit shoqëror, të cilat funksionojnë në të gjithë territorin e vendit. Shërbimet tradicionale në qendra të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, kanë ardhur duke u zgjeruar. Qendrat e përkujdesit shoqëror janë rezidenciale apo ditore e komunitare, me financim publik apo privat. Në vitin 2022 numri i qendrave që ofronin shërbime të përkujdesit shoqëror në vend ishte 250, me një numër

<sup>151</sup> KDKPAK, Neni 28.

<sup>152</sup> UNDP 2021. Mapping the social services in Albania.

<sup>153</sup> UNDP 2021. Mapping the social services in Albania.

<sup>154</sup> Vlera e financuar për vitin 2022 nga Fondi Social për shërbimet e kujdesit shoqëror për Personat me Aftësi të Kufizuar është 14 794 184 lekë, për Bashkitë Librazhd, Lezhë, Rrogozhinë, Tiranë, Patos.

<sup>155</sup> VKM "PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË DE-INSTITUCIONALIZIMIT 2020-2022 DHE TË PLANIT TË VEPRIMIT PËR ZBATIMIN E TIJ"

përfituesish 15,177 persona<sup>156</sup>. 62 prej këtyre qendrave (24.8%), ofruan shërbime për 2,503 përfitues me aftësi të kufizuara (16.4% e numrit të përgjithshëm të përfituesve).

Janë bërë përparime drejt ofrimit të shërbimeve në shtëpi dhe në komunitet për fëmijët dhe të rriturit me aftësi të kufizuara. Në disa bashki të vendit po zbatohen disa projekte pilot të fokusuara tek ndërhyrja e hershme për fëmijët nga 0-8 vjeç, shërbime rehabilitimi të ofruara në familje ose komunitet për persona që jetojnë në zona të largëta, si edhe shërbimet e jetesës së pavaruar për të rinjtë me aftësi të kufizuara.

Numri i qendrave komunitare për personat me aftësi të kufizuara është në rritje si pasojë e bashkëpunimit dhe mbështetjes me partnerë ndërkombëtarë përmes dhënies së granteve, si një formë financimi e Fondit Social për pushtetin vendor. Rreth 190 fëmijë me aftësi të kufizuara kanë marrë shërbime në këto qendra komunitare<sup>157</sup>. Këto janë modele shumë të mira që mund të zgjerohen më tej.

Gjithashtu, në vazhden e përpjekjeve për të diversifikuar gamën e shërbimeve të përkujdesit shoqëror për personat me aftësi të kufizuara, tre modele të reja shërbimesh iu shtuan Fondit Social në vitin 2022, nga aplikimi i dy prej të cilave përfituesit kryesorë janë personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre: (i) shërbimet lëvizëse, shërbimet në familje për fëmijët me aftësi të kufizuara, për të moshuarit dhe për personat me çrregullime psiko sociale; (ii) shërbimet multidisiplinare komunitare për fëmijët dhe familjet. Po ashtu, 5 ekipe lëvizëse të specializuara u krijuan për herë të parë në vend dhe iu ofruan shërbime rreth 600 personave me aftësi të kufizuara në pesë bashki të vendit<sup>158</sup>.

**Përmirësimi i standardeve të shërbimeve.** Zgjerimi i reformës së shërbimeve sociale, zhvillimi i tipologjive të reja dhe zgjerimi i shtrirjes, është kryer paralelisht me përmirësimet e standardeve të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Gjatë vitit 2022, ndër katër standarde të reja të shërbimeve shoqërore, njëri ishte i fokusuar në shërbimet për personat me aftësi të kufizuara, specifikisht në shërbimet e specializuara lëvizëse për fëmijët me aftësi të kufizuara<sup>159</sup>. MSHMS është në procesin e përmirësimit të 21 standardeve ekzistuese të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, përfshirë edhe kostimin.

### 2.3. Shërbimet e Kujdesit Social drejt decentralizimit, diversifikimit dhe deinsitucionalizimit

**Mbulimi me shërbime.** Mbulimi i popullsisë me shërbime sociale ka pësuar rritje përgjatë viteve si nga pikëpamja e përfituesve dhe nga pikëpamja gjeografike. Nga 10,000 përfitues në vitin 2019 ose 0.35% e popullsisë në 42,553 përfitues në vitin 2022, ose 1.5% e popullsisë (objektivi i strategjisë së mbrojtjes sociale 2023 ishte një nivel mbulimi 0.5% të popullsisë për vitin 2022)<sup>160</sup>. Është rritur gjithashtu numri i bashkive (25 në 2022, pra 41% e totalit) që sigurojnë shërbime sociale komunitare për të paktën 3 kategori përfituesish (PAK, fëmijë, të moshuar), por mbulimi në zonat rurale mbetet i ulët. Shërbimet lëvizëse për të mbështetur zonat periferike e rurale, shërbimet në familje janë ende të pazhvilluara dhe të pamjaftueshme.

**Hartëzimi i shërbimeve.** Sipas një vlerësimi të vitit 2021<sup>161</sup>, në Shqipëri ofrohen 493 shërbime sociale nga 339 institucione: (a) 46% e shërbimeve nga institucione publike; (b) 42% nga institucione jopublike; dhe (c) vetëm 12% nga institucione të formës së përzier (publike dhe jopublike). Nga totali i shërbimeve

<sup>156</sup> Të dhëna të MSHMS, Qershor 2023.

<sup>157</sup> Të dhënat nga raport i MSHMS/LNB për qendrat komunitare (por duhet saktësuar Shkodra dhe Ura Vajgurore).

<sup>158</sup> MSHMS, qershor 2023.

<sup>159</sup> Raporti i monitorimit për vitin 2022, i Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019-2023.

<sup>160</sup> MSHMS, 2023, Raporti i monitorimit të SKMS për vitin 2022.

<sup>161</sup> SHSSH, 2021, Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri.

të ofruara në bazë vendi, sipas tipologjisë, hartëzimi provoi se: (a) 21% janë shërbime komunitare; (b) 17% shërbime parashoqërore; (c) 14% shërbime të emergjencës; (d) 14% shërbime rezidenciale; (e) 11% shërbime në familje; (f) më pak se 10% shërbime të kujdesit alternativ; (g) më pak se 10% shërbime të këshillimit online; dhe (h) më pak se 10% shërbime të specializuara. Sipas përfituesve, shërbimet sociale mbështesin kryesisht familjet në nevojë (rreth 20% e totalit) dhe fëmijët me AK (17% e totalit).

Hartëzimi i vitit 2023 evidenton se pavarësisht përmirësimeve një mbulim dhe akses të pabarabartë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në numrat dhe kategoritë e shërbimeve dhe përfituesve, që ndryshojnë ndjeshëm në të gjithë vendin. Kështu, rreth 60% e bashkive ofronin deri në 3 tipologji shërbimesh, dmth më pak se 40% të tipologjive të përcaktuara në ligj. Ndërkohë, 5 bashki nuk ofronin asnjë shërbim; gjysma e bashkive (31) ofronin shërbime për 2-4 grupe në nevojë; dhe vetëm 3 bashki ofronin shërbime për 10-11 grupe në nevojë. Ka një variacion të lartë të përfituesve sipas qarqeve, pasi në vetëm 3 qarqe gjenden rreth 75% e totalit të përfituesve në rang vendi, nga të cilët gjysma (35%) vetëm në Tiranë. Në total, 63% e përfituesve marrin shërbime parashoqërore dhe vetëm 9% shërbim në familje. Më shumë se gjysma e tyre (53%) marrin shërbime sociale nga institucionet publike; 27% nga institucione jopublike dhe pjesa tjetër (20%) nga institucione të formës së përzier. Në qarkun e Tiranës ofrohet numri më i madh i shërbimeve, duke qenë i vetmi qark që ofron të gjitha tipologjitë e tyre (bashkia Tiranë), për të gjithë kategoritë e përfituesve.

Një hap shumë pozitiv ka qënë ngritja e shërbimeve të integruara socio-shëndetësore në 50 qendra shëndetësore të shtrira në gjithë territorin. 19 nga këto qendra janë të klasifikuara në kategorinë e qendrave socio-shëndetësore, ndërsa të tjerat 24/7 janë qendra që kanë në strukturën e tyre punonjës socialë dhe/ose psikologë për ofrimin e shërbimit social krahas shërbimit shëndetësor.

**Standardet e shërbimeve sociale.** Ligji nr. 121/2016 “Mbi shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, neni 8, përshkruan 7 kategoritë e shërbimeve të kujdesit shoqëror të cilat kërkojnë standarte. Shërbime parashoqërore; Shërbime në qendrat komunitare; Shërbime në qendrat rezidenciale; Shërbimet në situata emergjente; Shërbimet e kujdesit alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror; Shërbimet e specializuara; Shërbime të telefonisë /online( pa nen, por një përkufizim sipas nenit 3) të Ligjit “Për Shërbimet Shoqërore në RSH”. Deri më tani, nuk ka pasur një vlerësim të plotë në 61 bashkitë e vendit se sa prej shërbimeve të ngritura kanë qënë në përputhje me standardet në fuqi. Gjatë vitit të fundit, ka pasur një sërë përpjekjesh nga ana e MSHMS për rishikim të akteve ligjore dhe nënligjore për përmirësimin e standardeve të shërbimeve, duke miratuar gjithashtu 4 modele të reja standardesh dhe metodologji për zbatimin e tyre.

Aktualisht, po punohet për të hartuar një metodologji të përcaktimit të kostos për njësi për shërbimet e kujdesit social bazuar në standardet minimale strukturore dhe standardet minimale funksionale. Vlerësohet se nevojitet: (a) vendosje e standardeve minimale për të gjithë shërbimet, bazuar në kategorizimin e tyre<sup>162</sup>; (b) rishikimin nga ana e MSHMS të standardeve minimale ekzistuese për 21 shërbime të kujdesit social; dhe (c) identifikimin e standardeve të reja funksionale dhe strukturore sipas rastit dhe tipologjive të shërbimit, përfshirë këtu standartet e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror<sup>163</sup>.

**Planifikimi i shërbimeve sociale.** NJQV kanë krijuar eksperiencat e para për hartimin e planeve sociale lokale si baza e planifikimit vjetor të shërbimeve sociale. Të gjithë bashkitë kanë plane sociale, ndërsa një

<sup>162</sup> World Bank Group, 2022, Albania Social Protection Situation Analysis.

<sup>163</sup> EU4SI in Albania / GOPA, 2022, Functional Assessment Report.

pjesë e tyre i kanë rihartuar ato. Pas krijimit të eksperiencës së parë, planet e reja janë më cilësore në planifikimin e nevojave dhe më realiste në financimin e tyre. Megjithatë, bashkitë vazhdojnë të kenë nevojë për rritje kapacitetesh për vlerësimin e vazhdueshëm të nevojave të qytetarëve, të hartojnë plane të vazhdueshme si dhe të krijojnë fondin social lokal për të garantuar financimin e tyre në vazhdimësi. Njëkohësisht, Shërbimi Social Shtetëror ka nevojë të zhvillojë më tej kapacitetet për të mbështetur dhe udhëzuar njësitë e pushtetit vendor në hartimin e planeve lokale sociale.

**Fondi Social Kombëtar, si mekanizëm financimi.** Fondi Social, vlerësohet të jetë një mekanizëm i rëndësishëm financimi i shërbimeve sociale në nivel rajonal dhe lokal, në përputhje me qasjen decentralizuese. Çdo financim tjetër në nivel lokal vjen si rezultat i projekteve të caktuara të donatorëve, e kësaj nuk shkon në financimin e përbashkët të shërbimeve të qëndrueshme të kujdesit shoqëror për këto komunitete në nivel lokal, gjë që do të plotësonte dhe përmirësonte përdorimin dhe ndikimin e këtij fondi për këto komunitete në nevojë.

Me një rritje të disbursimit të fondit për vitin 2022, fondi total i disbursuar për pushtetin vendor nga Fondi Social gjatë viteve 2019-2022 është 539 milionë lekë. Në partneritet me OJF vendase dhe ndërkombëtare, Fondi ka mbështetur ngritjen e 40 shërbimeve të kujdesit shoqëror (indikatori i synuar në SKMS ka qenë 45, pra arritur në masën 88%), prej tyre 27 shërbime shoqërore në nivel bashkie dhe 13 shërbime të specializuara në 6 qarqe, të ofruara për 10,744 përfitues, duke përfshirë këtu fëmijë në situatë rreziku, persona me aftësi të kufizuara, të moshuar, fëmijët në nevojë për mbrojtje, viktime dhune dhe trafikimi, familje në nevojë Rome dhe Egjiptiane, si dhe individët e komunitetit LGBTI+<sup>164</sup>.

Janë nxjerrë disa mësimë nga eksperiencia e deritanishme me projektet dhe modelet e shërbimeve të ofruara si rezultat i financimit të tij, të reflektuara në disa raporte vlerësuese. Efikasiteti i përdorimit të këtij fondi mbetet aktualisht i kufizuar dhe varet kryesisht nga 2 faktorë kryesorë<sup>165</sup>: (a) kapacitetet e NJQV-ve për ushtrimin e funksioneve të shërbimeve sociale, që prej aplikimit për projekte deri te zbatimi dhe manaxhimi i tyre në territor; dhe (b) modalitetet e rregullimit dhe përdorimit të këtij fondi, sipas përcaktimeve në nivel qendror, përfshirë këtu pamjaftueshmërinë e tij në raport me nevojat e parashikuara në planet sociale lokale. Përdorimi i një mekanizmi shpërndarës që garanton përmbushjen e synimeve strategjike në përdorimin e Fondit Social (veçanërisht deinstitutionalizimin, qëndrueshmërinë e shërbimeve, qasjen e integruar dhe harmonizimin e shërbimeve shoqërore me ato shëndetësore, si dhe mbështetjen me shërbime të skemës së reformuar të vlerësimit të aftësisë së kufizuar) është domosdoshmëri.

**Hapësira fiskale lokale.** NJQV kanë një hapësirë fiskale të shtrënguar për të siguruar një rritje të qënësishme të financimit të shërbimeve sociale vit pas viti. Analizat provojnë se kjo hapësirë fiskale do të vijojë të jetë e ngushtë, pavarësisht tendencës së rritjes së taksave, përsa kohë pritet vetëm një rritje e lehtë e të ardhurave me 0.21% të PBB nga rritja me 2% e taksave lokale, apo vetëm 0.8% e PBB rritje në të ardhura lokale, si rezultat i futjes së taksës së pronës<sup>166</sup>. Të ardhurat totale të qeverisjes lokale u rritën nga 2.4% e PBB në 2015 në 3.7% të PBB në 2021, ku transfertat nga qeverisja qendrore mbeten zëri më i rëndësishëm i tyre (60% e totalit). Kapaciteti i bashkive për të krijuar të ardhurat e veta ndryshon shumë nga njëra bashki te tjetra, duke mbetur në çdo rast, tejet i ulët dhe i pamjaftueshëm. Ndërkohë që, përkushtimi i bashkive për të përdorur të ardhurat e veta për financimin e shërbimeve shoqërore është shpesh i kufizuar. Përgjatë viteve 2019-2021, rezulton se përqindja e të ardhurave të veta të bashkive e

<sup>164</sup> MSHMS, 2023, Raporti i monitorimit i SKMS për vitin 2022.

<sup>165</sup> UNICEF, 2021, Fondi social, nje realitet mes sfidash lokale.

<sup>166</sup> ILO, 2022, Fiscal space for social protection in Albania.

përdorur për të financuar aktivitetet e planit social është rritur përkatësisht nga 4.8% në vitin 2019, në 6.1 % në vitin 2021. Megjithatë ende në vitin 2021, 65% e bashkive i kishin të ardhurat e veta për të financuar planin social më pak se 2%<sup>167</sup>. Bashkitë janë financuesit kryesorë të shërbimeve publike (54% e totalit), të pasuara nga format “mikse” të financimit (24%), MSHMS (19%) dhe në fund, qarqet (3%). Sa i përket financimit të shërbimeve jopublike, 55% mbështeten nga OJF, 21% nga fondacionet, 16% nga organizatat ndërkombëtare dhe 8% nga forma “mikse” (më shumë se një burim)<sup>168</sup>.

### **Forcimi i statusit të personelit të shërbimeve të kujdesit social dhe profesionalizimi i personelit.**

Ligji nr. 40/2016 “Për urdhërin e psikologut në Republikën e Shqipërisë” “Ligji nr. 163/2014 i ndryshuar në vitin 2020 “Për urdhërin e punonjësit social në Republikën e Shqipërisë”, kanë bërë të mundur fillimin e procesit të licensimit të profesionistëve të fushës së përkujdesit shoqëror. Rreth 500 punonjës socialë janë licensuar, duke i dhënë kështu mundësinë strukturave në nivel qendror dhe vendor, si dhe institucioneve të përkujdesit shoqëror të punësimit të profesionistëve të kualifikuar të fushës. Megjithatë trajnimi i personelit të shërbimeve të kujdesit social mbetet i fragmentuar dhe mungon një kornizë e plotë e edukimit në vazhdimësi dhe zhvillimit në karrierë. Njëkohësisht nevojitet të ndërtohet një lidhje mes kualifikimit akademik, procesit të licensimit të profesionistëve dhe edukimit e trajnimit në vazhdimësi. Partnerë të ndryshëm strategjik dhe organizatat e shoqërisë civile kanë hartuar programe të ndryshme trajnimi për aspekte të ofrimit të shërbimeve, praktikën e punës, për zhvillimin modeleve të shërbimeve të integruara dhe menaxhimin e rastit, megjithatë mungon një vlerësim i plotë i personelit të shërbimeve sociale, profileve të tyre, si dhe një kornizë e plotë për zhvillimin e aftësive bazë thelbësore për ofrimin e shërbimeve sociale. Në vitin 2021, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale krijoi Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Kujdesit Shëndetësor dhe Shoqëror, agjenci e cila ka një rol të rëndësishëm në hartimin e kornizave kualifikuese si dhe në akreditimin e programeve të edukimit në vazhdimësi për profesionistët e kësaj fushe, si dhe të ngrejë mekanizma për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve shoqërore në cdo nivel. Si një Agjenci e re, del domosdoshmëri që të ndërmerret një vlerësim i plotë në nivel kombëtar për nevojat dhe mundësitë për të hartuar një kornizë të plotë të edukimit në vazhdimësi për personelin e shërbimeve sociale si dhe të kostohet kjo nevojë dhe të parashikohet si pjesë integrale e reformës së shërbimeve shoqërore.

### **Funksionimi i Rregjistrimit kombëtar të shërbimeve sociale dhe i Njësitë e Vlerësimit dhe Referimit të rasteve.**

Reforma e shërbimeve sociale lidhet ngushtësisht me sistemin e manaxhimit të informacionit, i cili siguron transparencën dhe sigurinë e informacionit. Në nivel vendor ngritja dhe funksionimi i Njësisë së Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit të Rastit është e lidhur direkt me funksionimin e sistemit. Kjo strukturë është përgjegjëse për: a) identifikimin e nevojave për shërbimet shoqërore; b) vlerësimin e nevojave në bazë të hartës së vulnerabiliteti; c) hartimin e planit social vendor të kostuar; ç) kontraktimin e ofruesit të shërbimeve të kujdesit shoqëror me anë të procedurave të prokurimit, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik; d) grumbullimin e informacioneve për rrjete e shërbimeve publike dhe jopublike që veprojnë në territorin e bashkisë. Ndonëse ka patur progress në drejtim të ngritjes së rregjistrimit elektronik të manaxhimit të rasteve, ky sistem nuk përdoret në të gjithë territorin, si dhe nga të gjitha shërbimet sociale (publike dhe jo publike). Njëkohësisht është e nevojshme që ky sistem të komunikojë në mënyrë të integruar me sistemin e pagesave të ndihmës ekonomike dhe sistemin e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar.

<sup>167</sup> UNICEF, 2022, Kujdesi shoqëror në bashki – mjedisi institucional, kapacitetet, problematika.

<sup>168</sup> SHSSH, 2021, Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri.

**Fleksibiliteti në përgjigjen ndaj emergjencave/krizave përmes skemave financiare dhe shërbimeve të kujdesit social.** Buxhetet lokale aktualisht janë shumë të varura nga transfertat kombëtare si dhe të papërgatitura për të përballuar situata të emergjencës, duke mos pasur fleksibilitetin e nevojshëm lidhur me burimet njerëzore dhe financiare<sup>169</sup>. Fondi i kontigjencës për financimin e emergjencave dhe përshtatjen e sistemit të mbrojtjes sociale, me skema shtesë të mbështetjes financiare dhe/apo me shërbime, aktualisht mungon, në të dy nivelet e qeverisjes, për të reaguar shpejt dhe në mënyrë efektive.

Indeksi i lartë në risqet natyrore dhe aksesit i ulët në financë janë dy nga faktorët kryesorë të nevojës për sisteme të mbrojtjes sociale që mbrojnë nga çdo goditje, individët në nevojë dhe ata të disavantazuar<sup>170</sup>. Aktualisht, sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri vuan nga: (a) pamundësia për të identifikuar shpejt njerëzit në nevojë; (b) mungesa e qartësisë së roleve të strukturave dhe punonjësve për rastet e emergjencave, (c) mungesa e një harte të ofrimit të shërbimeve në raste emergjencash dhe/apo krizash; (d) mungesa e kapaciteteve të punonjësve për veprim në raste emergjencash; dhe (e) nivel i ulët i vullnetarizmit dhe si rrjedhim, i përdorimit të vullnetarëve në këto situata.

**Deinstitucionalizimi i kujdesit rezidencial për fëmijët pa kujdes prindëror 0-18 vjec.** Në drejtim të deinstitucionalizimit të shërbimit rezidencial për fëmijët 0-16 vjec ka pësuar progres. Është ngritur dhe funksionon Komiteti Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit 2020-2022 dhe komiteti teknik, me Urdhërin e Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.548, datë 01.20.2020 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e Planit Kombëtar të Deinstitucionalizimit 2020-2022”. Janë vlerësuar dhe hartuar planet individuale 185 fëmijë; 35 fëmijë janë kthyer në familjet biologjike; të birësuar 24 fëmijë; 2 në foster care dhe 30 fëmijë jetesë të pavarur . Konsiderohet si mjaft e rëndësishme monitorimi në vazhdimësi i fëmijëve dhe të rinjve që kanë dalë nga institucionet përmes bashkëpunimit e njësitë e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor dhe nxitja e parandalimit të fëmijëve në situatë rreziku për institucionalizim, mbështetja dhe fuqizimi i prindërve për mirëritjen e fëmijëve, nxitja e shërbimit të kujdestarisë profesionale, si dhe format e tjera alternative për kujdesin ndaj fëmijëve, përfshirë jetesën e pavarur për fëmijët mbi 16 vjec.

---

<sup>169</sup> EU4SI in Albania/GOPA, 2022, Functional Assessment Report

<sup>170</sup> World Bank, 2021, Adaptive Social Protection System in Albania: The case of social assistance.

### III. Vizioni, Shtyllat ose Fushat Strategjike dhe Qëllimet e Politikave

#### 3.1. Vizioni

**“Mbrojtje sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës”.**

#### 3.2. Qëllimet e politikës

**Qëllimi i politikës A:** Zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i jetesës për personat me Aftësi të Kufizuara nëpërmjet skemave financiare të përshtatshme, të përgjegjshme gjinore, transparente për fuqizim dhe integrim, të afta për përballimin e rreziqeve e krizave.

*Objektivi specifik/strategjik A1: Të përmirësohet performanca, përshtatshmëria dhe përgjigjja ndaj krizave e skemave financiare për individët (burra, gra, djem dhe vajza) në skemën e ndihmës ekonomike.*

*Objektivi specifik/strategjik A2: Konsolidimi i vlerësimit bio-psikosocial dhe një sistem i qëndrueshëm dhe i mirëshënjestruar për Personat me Aftësi të Kufizuara.*

*Objektivi specifik/strategjik A3: Përmirësimi i shënjestrimit të fëmijëve, vajza dhe djem përmes skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët.*

**Masat prioritare** që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave specifike/strategjike janë:

1. Përmirësimi i performancës dhe transparencës së skemës së ndihmës ekonomike dhe përfitimeve të tjera për adresimin efektiv dhe të ndjeshëm gjinor të nevojave të çdo individi, të mirëadministruar në të gjitha nivelet.

Pas zbatimit kombëtar të reformës së programit të ndihmës ekonomike, nevojitet të kalohet në një fazë të re për të adresuar inefficiencat e vërejtura si dhe probleme të mjaftueshmërisë të ndihmës. Vlerësimet tregojnë që formula e pikëzimit nuk i përgjigjet sa duhet kontekstit ekonomik dhe social aktual duke u paraqitur e vjetëruar për sa i përket kriterëve të kualifikueshmërisë të parashikuara në të. Përdorimi i formulës së pikëzimit ka prodhuar një rezultat të rëndësishëm lidhur me zvogëlimin e përfitimit të padrejtë të ndihmës ekonomike, por administratorët shoqërorë konfirmojnë që ajo ka funksionuar mirë për zonat urbane, por është evidentuar që ekziston mundësia e përjashtimit të familjeve të varfëra, veçanërisht në zona rurale, familje me një person dhe ato që kanë në përbërje të tyre anëtarë të grupmoshës 50-55 vjeç që hasin vështirësi për t'u punësuar. Moszbulimi i formës së qartë të formulës së pikëzimit krijon probleme për transparencën si dhe ndikon që vlerësimi i efektshmërisë së formulës së pikëzimit të jetë i cunguar në aspektin e shënjestrimit. Gjykohet që pas pesë vitesh aplikim, formula e pikëzimit nuk është plotësisht e panjohur për administratorët shoqërorë dhe ekziston mundësia për ndikim subjektiv tek aplikantët për të deklaruar kushte që i bëjnë ata fitues. Koeficientët e formulës së pikëzimit vlerësohen të jenë të vjetëruar për shkak të ndryshimit të kushteve materiale dhe sociale krahasuar me kohën kur u aprovua ky instrument. Ekziston një sistem ankimi dhe apelimi për familjet e pakualifikuara për të përfituar ndihmë, i cili nuk përdoret formalisht në çdo rast nga ana e aplikantëve të refuzuar. Gjithashtu, pushteti vendor ka në dispozicion fondin 6% dhe të ardhurat e veta për të trajtuar familje të tjera në nevojë, sipas vendimeve të tij. Përqendrimi rajonal i varfërisë në zona ku pushteti lokal ka mungesë të hapësirave



fiskale për mbështetje me fonde të veta si dhe mundësi të ulta punësimi dhe shërbimesh kërkojnë një sistem të diferencuar mbështetjeje mbështetur në kontekstin lokal.

Masa e pagesës së ndihmës, ndonëse ka pësuar rritje të vijueshme përgjatë dekadës së fundit përfshirë dhe rritjet e bëra në kuadrin e masave për të përballuar efektet negative të pandemisë apo për mbështetjen e grupeve të caktuara me një shkallë vulnerabiliteti të rritur si nënat me shumë fëmijë apo viktimat e dhunës në familje, është ende e ulët. Megjithatë, pagesa e Ndhmës Ekonomike rezultoi ende e ulët në raport me kufirin e të ardhurave në rrezik varfërie apo me pagën minimale. Ndikimi i programit të ndihmës ekonomike në reduktimin e rrezikut nga varfëria është i kufizuar, ndërsa të dhënat provojnë që individët e papunë, familjet me shumë fëmijë në ngarkim dhe familjet me në krye gra ekonomikisht joaktive, për shkak edhe të angazhimit të tyre në punë të papaguar në familje janë më të rrezikuar për të renë në varfëri.

Aktualisht, nuk ka një mekanizëm të rishikimit periodik të masës së ndihmës ekonomike dhe nuk ekziston një fond rezervë apo mekanizëm të përgjigjes së shpejtë, i gatshëm për t'u përdorur në raste të krizave të paparashikuara. Familjet në ndihmë ekonomike, mbështeten me një numër të konsiderueshëm lehtësirash financiare apo subvencionimesh. Nuk ekziston një vlerësim financiar i kësaj mbështetjeje sipas përfitimit për secilin anëtar të familjes në ndihmë ekonomike dhe Regjistri Kombëtar i Ndhmës nuk i reflekton përfitimet për çdo familje, cka ndikon dhe në pamundësinë e vlerësimit të mbështetjes së plotë financiare që përfitojnë familjet në ndihmë ekonomike dhe efektit të kësaj mbështetjeje për lehtësimin e varfërisë dhe integrimin.

Decentralizimi administrativ dhe fiskal i vitit 2015 i ka besuar një rol kyç pushtetit vendor lidhur me administrimin e ndihmës ekonomike nëpërmjet krijimit dhe funksionimit të Njërive të Vlerësimit të Nevojave dhe të Referimit. Ndërkohë që vlen të forcohet roli monitorues i strukturave të SHSSH rajonal, ngritja e njërive në të gjithë njësitë administrative mbetet imediate. Për administratorët shoqërorë, pjesë e këtyre strukturave, kërkohet të përmirësohet roli i tyre vlerësues për familjet në nevojë për ndihmë dhe lehtësimi maksimal i kontakteve me to, si dhe të jetë operacional roli referues i tyre për punësim dhe/ose për shërbime të anëtarëve të familjeve në ndihmë ekonomike. Për këtë, ndërtimi i një modeli proaktiv të menaxhimit të integruar të familjes dhe individëve në ndihmë ekonomike dhe shtrirja në të gjitha njësitë vendore mbetet sfidë. Gjithashtu, vlerësimi i vijueshëm i performancës të sistemit të ndihmës ekonomike pazgjithshmërisht me sistemin e mbrojtjes shoqërore në të gjithë nivelet duhet shoqëruar me ndërmarrjen e ndryshimeve të nevojshme rregullatore, institucionale si dhe të ofrimit të çdo lloji asistence të nevojshme në këtë drejtim. Ndërkohë paralelisht me këto procese do të realizohen rishikimet e kuadrit ligjor dhe normativ për të reflektuar ndryshimet dhe rishikimet e nevojshme .

## 2. Të përmirësohet ri integrimi social- ekonomik i individëve, burra dhe gra pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike, përmes lidhjes me punësimin dhe promovimi i ndërmarrjeve sociale.

Realizimi i daljes nga skema e NE të anëtarëve në moshë pune të familjeve përfituese, në përmbushje të përcaktimit ligjor (2019) që parashikon që pagesa e Ndhmës Ekonomike të jetë për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) vjet (me përjashtim të përfituesve mbi moshën e pensionit dhe nënave me fëmijë në ngarkim) është një nevojë imediate për shkak të afrimit të kohës së përfundimit të këtij afati. Integrimi në tregun e punës të individëve në moshë pune është një sfidë e vështirë për shkak të një kompleksi arsyesish të tilla si vështirësitë në kordinim të zyrave të punës dhe organeve të pushtetit vendor, motivimit të ulët të individëve për t'u punësuar, nevojave për shërbime të personave të tjerë në familje si të moshuar, fëmijë etj. Administratorët shoqërorë dhe strukturat lokale nevojitet të jenë aktivë në referimin për punësim dhe shërbime shoqërore sipas nevojave/mundësive të anëtarëve të familjeve. Bashkëpunimi i institucioneve në nivel qendror, rajonal dhe vendor është thelbësor për të rishikuar/ zgjidhur problematikën dhe bërë

efektive të gjithë instrumentet ekzistues në funksion të punësimit dhe shërbimeve si ndërmarrjet sociale, fondin social të punësimit, fondin social, garancinë rinore, etj.

Vlerësimi i vijueshëm i skemës së daljes nga NE dhe i mekanizmit referues për punësim nëpërmjet komunikimit digjital të sistemeve përmirësuese të informacionit të populluara me profilin përkatës të secilit anëtar duhet të reflektojë rezultatin e numrit të individëve të punësuar dhe numrin e familjeve që dalin përfundimisht nga skema. Punësimi i anëtarëve të familjeve në zonat rurale ku është dhe numri më i madh i familjeve të mbështetura me NE mbetet sfida më e vështirë e kësaj strategjie. Gjithashtu, mbështetja e fëmijve të familjeve në NE me arsim dhe e të rinjve të këtyre familjeve për punësim është sfidë e rëndësishme për të mundësuar këputjen e zinxhirit të varfërisë dhe për të mos lejuar trashëgiminë e varfërisë ndër breza dhe në vecanti reduktimin e varfërisë së fëmijëve.

### 3. Të rritet aftësia e skemës dhe përfitimeve financiare për t'iu përgjigjur në kohë vulnerabiliteteve të situatave të krizave dhe emergjencave.

Efektet e tërmetit të vitit 2019, situata pandemike COVID 19 si dhe efektet ekonomike në ofertën dhe çmimet në tregun e mallrave dhe të energjisë të luftës në Ukrainë ishin eksperiencia të reja për Shqipërinë që situatat e emergjencës i ka patur të lidhura kryesisht me problematikën klimaterike e fatkeqësitë natyrore si përmytjet, zjarret etj. Situatat e viteve të fundit evidentuan problematikën dhe boshllëqet e sistemeve të përgjigjes ndaj situatave emergjente përfshirë dhe atë të kordinimit, gjithëpërfshirjes, financiare, kapaciteteve të personeleve të ndryshme, komunikimit etj. Ato krijuan gjithashtu ekperiencia të mira mbi mënyrën se si duhet të adresohen problematikata e krijuara. Strategjia e mbrojtjes sociale do të sigurojë që sistemi i përgjigjes ndaj situatave emergjente për grupet vulnerabël të mos jetë sporadik dhe momental, por i përgatitur dhe i pajisur me kapacitete, mjete dhe buxhete për këtë qëllim. Për këtë, analizat e situatave dhe një roadmap për një sistem mbrojtjeje shoqërore të aftë për t'iu përgjigjur krizave dhe emergjencave do të ndihmonin për hartimin e për zbatimin në praktikë të funksionimit të skemës së ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, si dhe përfitimeve të tjera financiare në raste të mundshme krizash apo emergjencash, rregjistri kombëtar do të përmbajë një modul të veçantë ku të evidentohen individët më vulnerabël në raste emergjencash dhe nevojat potenciale të tyre, personelin e trajnuar për t'iu ardhur në ndihmë në të gjitha nivelet si dhe një plan të dedikuar komunikimi të informacionit.

Të gjithë këto veprime do të jenë në përmbajtje të skenareve të ndryshme për mbrojtjen sociale në raste krizash dhe emergjencash përfshirë dhe buxhetet e nevojshme me qëllim që mbrojtja sociale të jetë e përgjegjshme dhe adaptive, efektive dhe gjithëpërfshirëse për të menaxhuar goditjet që prekin vulnerabël të popullsisë. Ndërhyrjet do të ndihmojnë familjet dhe komunitetet që të kenë akses në burime për të ndërtuar ripërtëritjen dhe për të rikuperuar mjetet e tyre të jetesës kundër fatkeqësive natyrore dhe goditjeve. OJF dhe sektori privat janë partnerë të pazevendësueshëm në këtë përpjekje, ndaj sigurimi i një bashkëpunimi efektiv me to, qysh në fazat planifikuese dhe më tej si faktorë kontribues në skenarët e përgjigjes ndaj emergjencave, është domosdoshmëri.

### 4. Përmirësimi i performancës dhe transparencës së skemës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar me qëllim adresimin efektiv dhe të përgjegjshëm gjinor të nevojave individuale të tyre dhe reagimit ndaj situatave të krizave dhe emergjencave.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar u shoqërua me shkallëzim të përfitimeve, sipas nivelit të aftësisë së kufizuar, megjithatë ndryshimet në pagesa, por edhe niveli mesatar i pagesës së aftësisë së kufizuar nuk janë përcaktuar bazuar në analizën e kostove të shtuara, të shkaktuara nga aftësia e kufizuar.

Pagesa e aftësisë së kufizuar është rekomanduar të jetë në nivele të mjaftueshme dhe nevojitet një mekanizëm rishikues/indeksues periodik për të i aftë për t'iu përgjigjur situatave të krizave dhe emergjencave në përshtatje me nevojat e posaçme të individëve. Ka një trajtim jo të barabartë të pagesave të sigurimeve shoqërore për ndihmësit personal në skema të ndryshme (vetëm ndihmësve personal të personave që përfitojnë nga statusi i para e tetraplegjisë u njihet pagesa e sigurimeve shoqërore).

Nuk ka një raport kombëtar, që të hedhë dritë mbi nivelin e varfërisë mes personave me aftësi të kufizuara të kategorive të ndryshme, por edhe atë të familjeve që kanë në përbërje me persona me aftësi të kufizuara. SILC mat nivelin e jetesës, varfërinë relative dhe privimin material në familjet shqiptare, por anketa nuk ka indikatorë për të matur nivelin e varfërisë tek personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre.

Shqipëria ka një kuadër të plotë ligjor dhe politik<sup>171</sup> të orientuar drejt sigurimit të aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara, por personat me aftësi të kufizuara shpesh nuk kanë akses në zyrat që administrojnë shërbimet sociale apo tek ofruesit e shërbimeve në komunitetet ku ata jetojnë. Personat me aftësi të kufizuara nuk kanë akses sistematikisht dhe në mënyrë të strukturuar në mjetet dhe teknologjinë ndihmëse. Po ashtu, atyre u mungon informacioni në formate të aksesueshme për t'i orientuar ata drejt përfitimeve e shërbimeve në mënyrë të pavarur. Pavarësisht përpjekjeve të kohëve të fundit nga institucionet përgjegjëse, informacioni publik për shërbimet e përkujdesit shoqëror ende nuk është i aksesueshëm për personat që nuk shohin, flasin, dëgjojnë apo ato me aftësi të kufizuara intelektuale. Ndonëse janë zhvilluar tarjime, ka ende nevojë për më shumë investim dhe kapacitete në këtë drejtim. Aktualisht, në vend ofrohen vetëm disa nga tipologjitë e pajisjeve ndihmëse bazë, si karriget me rrota, proteza e orteza dhe pajisje ndihmëse në dëgjim, megjithatë nevojiten rregullime ligjore dhe kapacitete të fuqizuara për të vlerësuar dhe orientuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara në këtë drejtim.

Edhe pse progresi i reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar është tashmë i dokumentuar, investime të mëtejshme nevojiten për të siguruar konsolidimin e skemës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar si: fuqizimi i vijueshëm i kapaciteteve të aktorëve përgjegjës për zbatimin e reformës së vlerësimit; përmirësimi i procedurave dhe instrumenteve në përgjigje të zhvillimeve dhe modeleve të reja (udhëzuesit e formularët); zgjerimi dhe fuqizimi i strukturave të monitorimit dhe të kontrollit për të shmangur gabimet, abuzimet dhe korrupsionin; përmirësimi i regjistrit elektronik të aftësisë së kufizuar; hartimi i protokolleve të standardizuara që do të mundësonin të dhëna të besueshme të gjeneruara nga sistemi i vlerësimit të aftësisë së kufizuar; rritja e kapaciteteve të stafit në ekstraktimin e të dhënave nga sistemi, përpunimin e analizën e tyre me qëllim orientimin e politikave dhe ngritjen e shërbimeve; konsolidimi i sistemit të referimit të përfituesve të pagesave të aftësisë së kufizuar në sistemin e arsimit e formimit profesional dhe punësimit si edhe ndjekja e menaxhimit të integruar të rastit me institucionet e AFP-së dhe punësimit.

## 5. Forcimi i bashkëpunimit dhe mbështetja e vijueshme për zbatimin efektiv të Fondit Social të Punësimit për personat me Aftësi të Kufizuara.

Fondi social i punësimit për personat me aftësi të kufizuar është një instrument i rëndësishëm punësimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe pjesë e Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2023-2030 nën masën prioritare "Integrimi në rritje i personave me aftësi të kufizuara në sistemet e zhvillimit të aftësive dhe të tregut të punës". Fondi social i punësimit pritet të jetë operacional në vitin 2024, me përfshirjen e Drejtorisë së Tatimeve për të mbledhur detyrimet nga punëdhënësit sipas ligjit. Institucionet ndërmjetëse dhe ato punëdhënëse kërkohet të kenë angazhime të rëndësishme për përshtatjen e hapësirave të shërbimeve të punësimit dhe institucioneve të arsimit dhe formimit profesional,

<sup>171</sup> VKM Nr. 276 "Plani Kombëtar për Personat me Aftësi të Kufizuar 2021-2025".

duke bërë ndërhyrje në infrastrukturë, teknologji dhe zhvillim kapacitetesh për stafin. Ndërsa institucionet e përfshira në mbrojtjen sociale duhet të bëjnë një vlerësim cilësor të individëve me aftësi të kufizuara për shkallën e punësueshmërisë së tyre, profilizimin dhe referimin efektiv në zyrat e punësimit. Harmonizimi i veprimeve të Strategjisë së Mbrojtjes Shoqërore dhe të Strategjisë së Punësimit dhe analizat periodike për përmirësimin e zbatueshmërisë së tyre janë thelbësore për të plotësuar objektivat e punësimit dhe për të bërë të suksesshëm Fondin Social të Punësimit.

#### 6. Përmirësimi përfitimeve dhe bashkepunimit ndër-sektorial me fokus fëmijët, vajzat dhe djemtë në skemën e ndihmës ekonomike me synim promovimin e mirëqenies së tyre.

Analiza të mëparshme kanë theksuar nevojën për të ofruar mbështetje të mëtijshme për familjet me fëmijë (të vegjël) në kushtet e pamjaftueshmërisë së skemave ekzistuese të mbështetjes në para dhe përfitimeve të tjera. Aktualisht ekzistojnë disa përfitime për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve në familjet në ndihmë ekonomike. Të tilla janë bonusi i bebes për çdo fëmijë të lindur, stimuli financiar për rregjistrimin në shkollë dhe për vaksinimin, tekste shkollore falas, bursa mësimore etj. Ekzistojnë dhe shërbime të tjera që merren nga një sërë institucionesh lokale dhe qendrore të cilat duhen identifikuar dhe analizuar. Evidentimi i të gjithë llojeve të përfitimeve dhe shërbimeve, analiza e kostove që lidhen me mirëritjen e fëmijëve do të mundësojnë ndërtimin e skenarëve të ndryshëm për të përmirësuar këto përfitime. Ekzistojnë modele dhe praktika ndërkombëtare mbështetjeje me përfitime për fëmijët në familjet në ndihmë ekonomike, të cilat do të njihen dhe do të përdoren për ndërtimin e skenarëve të mbështetjes për fëmijët në të ardhmen. Një material i shkurtër mbi një skemë mbështetjeje për fëmijët e grupmoshës 0-3 vjeç është përgatitur nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Sugjerimet e këtij dokumenti synohet të pilotohen në kuadrin e skemës për “1000 ditët e para të jetës së fëmijës” dhe më pas të vijohet me zbatimin kombëtar të saj të mbështetur në një kuadër të mirë ligjor dhe rregullator. Analiza të vijueshme për impaktin e këtyre skemave në mirëqenien e fëmijëve do të kryhen me qëllim realizimin e modifikimeve të nevojshme.

#### 7. Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial me fokus fëmijët në programin e NE-së dhe plani për Garancinë e Fëmijëve.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hedhur hapa të rëndësishëm dhe konkret drejt një modeli të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale për fëmijët përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. Njëkohësisht lidhja me arsimimin është thelbësore për të garantuar të drejtën e fëmijëve në nevojë për siguruar qëndrimin në shkollë. Në vecanti, orientimi drejt një modeli të koordinuar mes shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësor pritet të jetë një prej prioriteteve të strategjisë së re për garantimin e mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve. Ky intergim i shërbimeve nis që në moshën 0-5 vjeç me paketën bazë të shëndetit të kujdesit parësor dhe programit të vizitave të integruara në familje si një mundësi për të adresuar në vecanti fëmijët vulnerabël, monitorimin e zhvillimit të hershëm dhe identifikimit të hershëm të aftësisë së kufizua si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial për të siguruar ndjekjen e treguesve të zhvillimit të fëmijës. Ky program aktualisht po zbatohet në qarqet Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Berat dhe synimi është të zgjerohet në të gjithë territorin. Hartimi i protokolleve të përbashkëta, organizimi i tryezave të përbashkëta në nivel rajonal mes shërbimeve sociale dhe atyre shëndetësore si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit socio-shëndetësor do të jenë në fokus në strategjinë e re. Njëkohësisht, pjesë e kësaj mase prioritare do të jetë vlerësimi i fizibilitetit, kapaciteteve institucionale dhe personelit për të hartuar një Plan Veprimi për Garancinë e Fëmijëve sipas modelit dhe udhëzimeve të Bashkimit Evropian. Hartimi i një Plani Veprimi për Garancinë e Fëmijëve është një prej rekomandimeve të Bashkimit Evropian si pjesë e kapitullit 19 për hapjen e negociatave si dhe në përputhje

me kapitullin 23 për të drejtat e njeriut. Plani i Veprimit për Garancinë e Fëmijëve, aktualisht po zbatohet në një sërë vendesh të Bashkimit Evropian, dhe ashtu sikurse Plani i Garancisë Rinore do të synojë të ndërtojë modele, mjete dhe financim për adresimin e fëmijëve vulnerabël, të garantojë një plan për reduktimin e varfërisë së fëmijëve dhe nxitur mirëqenien e tyre.

**Qëllimi i politikës B: Zgjerimi i shërbimeve sociale të integruara, të aksesueshme e cilësore dhe të përgjegjshme gjinore si dhe avancimi i deinstitutionalizimit, në partneritet me pushtetin vendor dhe aktorët e tjerë.**

*Objektivi specifik/strategjik B.1: Konsolidimi i procesit të decentralizimit të shërbimeve të kujdesit social për financim të qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm gjinor, mbulim gjeografik, aksesueshmëri dhe që i përgjigjen krizave dhe emergjencave.*

*Objektivi specifik/strategjik B.2: Zbatimi i standardeve dhe forcimi i kapaciteteve njerëzore të personelit të shërbimeve të kujdesit social për shërbime efektive dhe të përgjegjshme gjinore.*

*Objektivi specifik/strategjik B.3: Deinstitutionalizimi i shërbimeve të kujdesit rezidencial dhe zhvillimi i shërbimeve në familje, komunitare dhe ditore duke respektuar parimin e të drejtave dhe lentet gjinore.*

**Masat prioritare** që do të kontribuojnë në arritjen e objektivave specifikë/strategjike janë:

1. Të përmirësohet planifikimi, modeli i financimit të përgjegjshëm gjinor të shërbimeve të kujdesit social në nivel vendor si dhe përgjigja efektive ndaj krizave dhe emergjencave.

NJQV kanë krijuar eksperiencën e tyre për hartimin e planeve sociale lokale si baza e planifikimit vjetor të shërbimeve sociale. Vlerësohet që në këtë fazë nevojitet një unifikim i formateve të planeve sociale vendore. Vlerësimet e nevojave për shërbime sociale në komunitetet lokale janë realizuar si pjesë e hartimit të planeve lokale, por ato kanë qenë të munguara për disa bashki, duke cënuar cilësinë e planifikimeve vjetore dhe afatmesme. Planet e reja sociale duhet të shënojnë një përmirësim cilësor në priorizimin e veprimeve, kostimin dhe specifikimin e qartë të burimeve financiare për realizimin e tyre. Korniza monitoruese e zbatimit të planeve sociale dhe e shërbimeve shoqërore ka qenë e pamjaftueshme dhe NJQVR kanë kapacitete të kufizuara monitoruese. Fushatat e vizibilitetit, dialogu me përfituesit për vlerësimin e nevojave për shërbime, si dhe për informimi lidhur me shërbimet e integruara të kujdesit shoqëror, duhet të jenë pjesë e planeve sociale lokale.

Do të rishikohet VKM e Fondit Social, veçanërisht lidhur me nivelin e kontributeve nga bashkitë si dhe qëndrueshmërinë financiare të shërbimit, orientuar drejt financimit të integruar/bashkuar (buxheti i dedikuar nga MSHMS në programin e përkujdesit social, financimi i vetë bashkive dhe financimi i donatorëve/sectorit privat). Do të rishikohet metodologjia/formula e shpërndarjes së Fondit Social me qëllim përmirësimin e transparencës dhe barazisë së zbatimit për komunitetet lokale, duke marrë në konsideratë pabarazitë e mëdha rajonale dhe lokale, për nga niveli i problematikave dhe i nevojave, por edhe për nga kufizimet në burime të institucioneve lokale (NJQV-ve). Rishikimi do të qartësojë rolet institucionale për alokimin dhe monitorimin e zbatimit të Fondit Social dhe do të mbështetet në kostot për njësi shërbimi dhe prokurimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror. Do të plotësohet kuadri ligjor dhe rregullator që lidhet me prokurimin e shërbimeve nga ana e bashkive si dhe do të mbështetet dhe forcohen kapacitetet lokale për kryerjen e procesit prokurues. Do të mbështetet pushteti vendor me kapacitete për ngritjen e fondeve dhe mobilizim financiar të aktorëve të ndryshëm për një financim të qëndrueshëm të shërbimeve.

Do të nxitet koordinimi dhe bashkëpunimi mes bashkive në nivel lokal dhe promovimi i modeleve të mira dhe inovative të shërbimeve sociale, veçanërisht në komunitetet për të cilat këto shërbime janë të munguara, në kushtet e pamundësive financuese. Trajnimet për rritjen e kapaciteteve lokale për aplikim projektsh në kuadër të Fondit Social në linjë me parashikimet në planet lokale do të rriten gjithashtu.

Indeksi i lartë në risqet natyrore dhe aksesit i ulët në financë janë dy nga faktorët kryesorë të nevojës për sisteme të mbrojtjes sociale që mbrojnë nga çdo goditje, individët në nevojë dhe ata të disavantazuar<sup>172</sup>. Aktualisht, sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri vuan nga: (a) pamundësia për të identifikuar shpejt njerëzit në nevojë; (b) mungesa e qartësisë së roleve të strukturave dhe punonjësve për rastet e emergjencave, (c) mungesa e një harte të ofrimit të shërbimeve në raste emergjencash dhe/apo krizash; (d) mungesa e kapaciteteve të punonjësve për veprim në raste emergjencash; dhe (e) nivel i ulët i vullnetarizmit dhe si rrjedhim, i përdorimit të vullnetarëve në këto situata. Autonomia fiskale e bashkive ka risqe, pasi buxhetet lokale aktualisht janë shumë të varura nga transfertat kombëtare si dhe të papërgatitura për të përballuar situata të emergjencës, duke mos pasur fleksibilitetin e nevojshëm lidhur me burimet njerëzore dhe financiare. Fondi i kontigjencës për financimin e emergjencave dhe përshtatjen e sistemit të mbrojtjes sociale, me skema shtesë të mbështetjes financiare dhe/apo me shërbime, aktualisht mungon, në të dy nivelet e qeverisjes, për të reaguar shpejt dhe në mënyrë efektive.

## 2. Të përmirësohet mbulimi gjeografik, diversifikimi dhe aksesueshmëria, dixhitalizimi dhe ndjeshmëria gjinore e shërbimeve të kujdesit social.

Mbulimi i popullsisë me shërbime mbetet ende i ulët. Është rritur numri i bashkive që sigurojnë shërbime sociale komunitare për të paktën 3 kategori përfituesish (PAK, fëmijë, të moshuar), por mbulimi në zonat urbane mbetet i pamjaftueshëm dhe në zonat rurale i ulët. Nuk ka një vlerësim periodik të vulnerabilitetit sipas zonave, por evidentohet që individët në vështirësi ekonomike, sociale e shëndetësore hasin vështirësi në aksesin në shërbime. Shërbimet lëvizëse për të mbështetur zonat periferike e rurale janë ende të nënzhvilluara. Do të realizohet zgjerimi i hartës së shërbimeve, i cili do të shoqërohet me diversifikimin dhe futjen e shërbimeve të reja e inovative, duke patur në vëmendje individin dhe familjen. Do të përgatitet harta e vulnerabilitetit e rifreskuar (hartëzimi i nevojave) dhe në bazë të kësaj harte të unifikuar do të realizohet vlerësimi i nevojës për shërbime të reja të kujdesit shoqëror, në funksion të zgjerimit të hartës së shërbimeve, nga përpjekjet e koordinuara të të gjithë aktorëve, publikë dhe jopublikë.

Sistemi i integruar i shërbimeve shoqërore do të zhvillohet drejt tipologjive të reja e me mbulim të arësyeshëm gjeografik duke reduktuar pabarazitë rajonale aktuale, mbështetur me rritje të financimit të shërbimeve sociale, rritje të kapaciteteve njerëzore, për përmirësimin e funksionimit dhe eficiencës së shërbimeve komunitare dhe në familje si dhe forcimin e modelit të manaxhimit të rastit përgjatë zinxhirit të shërbimeve, përmes integritit të skemave dhe sistemeve. Aktualisht, ofrimi i shërbimeve sociale të integruara e njëkohësisht të qëndrueshme, inovative dhe gjithëpërfshirësë, si dhe me standarde Europiane mbetet sfidë për sektorin e mbrojtjes sociale dhe strategjisë së ardhshme në këtë fushë. Kjo sfidë synon mobilizimin e burimeve njerëzore dhe financiare, përdorimin e teknologjisë, si dhe nxitjen e partneriteteve mes aktorëve publikë dhe jopublikë.

---

<sup>172</sup> World Bank, 2021, Adaptive Social Protection System in Albania: The case of social assistance

Orientuar drejt deinstitutionalizimit dhe decentralizimit, sistemi i mbrojtjes sociale do të zhvillohet edhe në lidhje me fleksibilitetin për t'u përgjigjur shpejt dhe në mënyrë efektive krizave dhe emergjencave, duke mos cënuar mbështetjen me shërbime ndaj individëve dhe familjeve në nevojë të shtuar.

Për të mbështetur zgjerimin e hartës së shërbimeve dhe vlerësuar shkallën e kënaqësisë së individëve që përfitojnë prej tyre, një vemendje të posaçme do të marrë përmirësimi i rregjistrimit elektronik të shërbimeve, lidhja e tij me rregjistra të tjerë me informacion të dobishëm, kapacitimi i personelit për të populluar rregjistrin me të dhëna dhe për t'i përdorur ato për analiza, mbështetja me infrastrukturë dhe materiale udhëzuese e strukturave të NJVRN.

### 3. Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve ekzistuese dhe të reja përmes zbatimit, monitorimit dhe inspektimit të standardeve si dhe të përgjegjshme nga pikëpamja gjinore.

Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve do të konsistojë në vendosjen e standardeve minimale për shërbimet, bazuar në kategorizimin e tyre; rishikimin e standardeve minimale ekzistuese dhe identifikim të standardeve të reja funksionale dhe strukturore sipas rastit dhe tipologjive të shërbimit, përfshirë standardet e shërbimeve të integruara të kujdesit shoqëror. Ka perpjekje për të hartuar metodologji të përcaktimit të kostos për njësi për shërbimet e kujdesit social bazuar në standardet minimale strukturore dhe standardet minimale funksionale, me ndihmën e partnerëve Europianë. Sfida aktuale e konsolidimit të sistemit të shërbimeve sociale është lidhja e rëndësishme mes standardeve të rishikuara, kostimit për njësi të shërbimit, shpërndarjes së Fondit Social në përputhje me hartën e vulnerabilitetit në mbulim kombëtar, si dhe monitorimi i zbatimit të standardeve të rishikuara.

Do të kalohet nga praktika e raportimit për shërbimet shoqërore në atë të monitorimit bazuar në një metodologji për vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të kujdesit shoqëror, impaktit, eficiencës apo kosto-efektivitetit të tyre. Do të rishikohen metodologjitë e monitorimit dhe inspektimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror si dhe kompetencat institucionale. Procesi i monitorimit dhe inspektimit do të shoqërohet me përmirësimin e sistemeve të cilat do të realizojnë dokumentimin digjital të situatës, do të japin informacion dhe do të mundësojnë raportime dhe analiza periodike. Njëkohësisht, është planifikuar të ketë një rishikim të kuadrit ligjor të Ligjit 121/2006, për të reflektuar qartësimet e nevojshme si rezultat i zhvillimit të sektorit, aspekteve të decentralizimit, roleve dhe detyrave të shërbimeve, roleve dhe detyrave të strukturave të inspektimit dhe monitorimit si dhe aspekte të tjera të lidhura me këtë ligj.

### 4. Forcimi i kapaciteteve dhe statusit të personelit të shërbimeve të kujdesit social për të siguruar shërbime cilësore, efektive dhe të përgjegjshme gjinore;

Reforma e shërbimeve të kujdesit social të cilat synojnë zhvillimin e mëtejshëm të tipologjive të shërbimeve të reja, zbatimin e standardeve të cilësisë, orientimin drejt praktikave më të mira sipas standardeve Evropiane dhe atyre të vendeve të Bashkimit Evropian, kërkojnë zhvillimin dhe profesionalizimin e personelit të shërbimeve shoqërore, dhe në mënyrë prioritare të punonjësve social, psikologëve, edukatorëve, kujdestarëve etj. Kuadri ligjor për cilësimin dhe përcaktimin e forcës së punës së shërbimeve sociale ka nevojë të rishikohet dhe zhvillohet më tej duke synuar të: a) rishikojë dhe saktësojë përcaktimet për forcën e punës; b) përcaktimin e kornizës së kualifikimeve; d) konsolidimin e procesit të licensimit përmes partneritetit me Urdhërin e Punonjësve Social, Urdhrit të Psikologut e kështu me radhë. Njëkohësisht do të synohet edhe prezantimi i profesionistëve të rinj që i përgjigjen shërbimeve të domosdoshme dhe të reja, si roli i asistentit profesional. Si pjesë e kësaj mase prioritare do të ndërtohet një bazë të dhënash për profesionistët e shërbimeve në nivel kombëtar si pjesë e hartës së shërbimeve sociale dhe që do të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme. Ndërtimi i një kuadri rregullator për

kualifikimin dhe trajnimin e vazhdueshëm do të jetë një aktivitet thelbësor për të mbështetur me tej forcimin e kapaciteteve të personelit. Pjesë e kësaj pakete do të jetë dhe hartimi i një pakete trajnimi të targetuar për përgjigjen ndaj emergjencave të shërbimeve të kujdesit social për punonjësit publikë dhe jopublik, si dhe akreditimi i ofruesve të programeve të trajnimit dhe edukimit në vazhdimësi për punonjësit social të shërbimeve sociale, monitorimi i zbatimit të programeve të trajnimit dhe edukimit në vazhdimësi, si dhe rishikimi i vazhdueshëm i përshkrimeve të punës dhe forcimi i statusit dhe vlerësimit financiar të këtij personeli për të garantuar hedhjen e një hapi cilësor në drejtim të profesionalizimit të forcës së punës në këto shërbime.

#### 5. Avancimi i procesit të deinstitutionalizimit të sistemit rezidencial për fëmijët;

Proçesi i deinstitutionalizimit të sistemit të kujdesit për fëmijët, synon ndryshimin e tipologjisë së shërbimeve të ofruara, nga institucione rezidenciale në shërbime ditore, si dhe shërbime të tjera alternative, me bazë komunitare në integrimin e fëmijëve në familje, qofshin ato biologjike apo kujdestare, në komunitet dhe më gjerë në shoqëri. Kuadri ligjor për shërbimet shoqërore për mbrojtjen dhe përkujdesjen e fëmijëve në proçes deinstitutionalizimi do të rishikohet dhe do të harmonizohet me aspektet e tjera ligjore, administrative dhe procedurale përfshirë dhe një kuadër financiar të rishikuar që do të mbështesë këtë proçes.

9 institucionet publike shtetërore të shërbimeve të përkujdesjes do të transformohen në shërbime multidisiplinare e multifunksionale për fëmijën dhe familjen. Qëllimi primar i deinstitutionalizimit do të vijojë të jetë parandalimi i ndarjes së fëmijës nga familja dhe fokusi do të jetë fuqizimi i bërthamës familjare, përmes mbështetjes në një aspekt shumë planësh, nga mbështetja ekonomike tek ajo sociale. Njëkohësisht, ofrimi i kujdesit alternativ profesional nëpërmjet shërbimeve të menaxhuara nga strukturat në nivel vendor dhe qendror, si dhe krijimi i rrjetit të familjeve kujdestare, mbetet një tjetër sfidë e rendësishme. Si pjesë e proçesit të deinstitutionalizimit, fuqizimi i familjeve biologjike dhe identifikimi i familjeve kujdestare janë përgjegjësi dhe sfidë e rendësishme për autoritetet lokale.

Institucionet e përkujdesit do të krijojnë modele për shërbime të reja alternative për fëmijët. Rezultatet e pilotimit të proçesit të deinstitutionalizimit në Vlorë dhe në Korçë do të shërbejnë për një qartësim të mëtejshëm të problematikës që lidhet me këtë proçes jo vetëm shumë të rendësishëm, por edhe shumë delikat. Ky proçes do të shoqërohet me rritje të kapaciteteve të personelit përgjegjës si dhe me një monitorim të kujdesshëm dhe profesional nga autoritetet monitoruese dhe inspektuese.

#### 6. Zgjerimi i rrjetit të shërbimeve të përkujdesit shoqëror për persona me aftësi të kufizuara që jetojnë në institucione rezidenciale, ose në rrezik institucionalizimi;

Në zbatim të kuadrit ligjor për mbështetjen me shërbime sociale të personave me aftësi të kufizuara, do të bëhet vlerësimi i nevojës sipas planeve individuale si dhe kostimi i këtyre shërbimeve. Skenarët e ofrimit të shërbimeve do të përfshijnë të gjithë spektrin e mundshëm si mbështetja nëpërmjet kujdestarisë së përkohshme, shërbimet lëvizëse të specializuara në mënyrë që të përmirësohet mbulimi i zonave periferike dhe atyre rurale, shërbimet në komunitet, zhvillimi i shërbimeve të kujdestarisë etj.

Vëmendje do i kushtohet financimit që është një faktor kryesor për qëndrueshmërinë e shërbimeve. Në mbështetje të Ligjit për shërbimet sociale i cili parashikon informimin si shërbim parashoqëror një strategji komunikimi do të ndihmojë për të kryer informimin e personave me aftësi të kufizuara dhe familjarëve të tyre për ndryshimet ligjore dhe politikat shtetërore në mënyrë që të njihen mundësitë dhe alternativat që ekzistojnë në fushën e shërbimeve. Kujdes duhet për kordinimin dhe bashkërendimin e



punës me institucionet lokale e rajonale, përgjegjëse për çështje të aftësisë së kufizuar në mënyrë që të lehtësohet procesi i menaxhimit të rastit nëpërmjet një rrjeti efikas bashkëpunimi që adreson çdo aspekt (arsimi, shëndetësia, punësimi, formimi profesional, shërbimet sociale, strehimi, transporti dhe infrastruktura, organizatat që ofrojnë shërbime dhe organizata të personave me aftësi të kufizuara).

## 7. Nxitja dhe mbështetja e shërbimit në familje për moshën e tretë.

Në kuadrin e moshimit të popullsisë, trajtimi i nevojave të kujdesit afatgjatë mbetet një sfidë kyçe për shumë vende përfshirë edhe Shqipërinë. Duke vlerësuar pamjaftueshmërinë e shërbimeve për moshën e tretë, një vemendje e posaçme për këtë kategori do të kushtohet për vitet në vijim me qëllim parandalimin e varfërisë dhe vulnerabilitetit tek të moshuarit.

Kujdesi afatgjatë për të moshuarit do të ofrohet përmes: shërbimeve komunitare, shërbimeve të integruara sociale dhe shëndetësore, qendrave ditore, vizitave të infermiereve dhe kujdestarëve profesionale; shërbime të bazuara në shtëpi, ndihmë në shtëpi, përfitimet në para për kujdestarët, grupet mbështetëse për kujdestarët; kujdes institucional më pak intensiv; kujdesi intensiv institucional. Në ofrimin e shërbimeve për moshën e tretë, do të mbahen në konsideratë diferencat gjinore mes grave dhe burrave të moshuar, duke ofruar shërbime që i përshtaten nevojave specifike të tyre.

Ofrimi i shërbimeve cilësore të kujdesit afatgjatë do të synojë të rrisë mirëqenien e të moshuarve, ndërsa mbështeten familjet dhe zhvendosen përgjegjësitë nga kujdestarët e papaguar të familjes tek punëtorët e kualifikuar, të zvogëlohet numri i hospitalizimeve të panevojshme në mjediset e kujdesit shëndetësor sekondar dhe terciar për ata që nuk kanë mundësi të tjera.

DRAFT

## IV. Llogaridhënia, monitorimi dhe analizat vlerësuese

### Mekanizmat e Zbatimit dhe Koordinimit

Strategjia do të zbatohet përgjatë periudhës 2024-2030. Rol udhëheqës në zbatimin e Strategjisë do të ketë Ministria e Shëndetsisë dhe Mbrojtjes Sociale si institucioni përgjegjës për fushën e mbrojtjes sociale. Përgjegjësia për zbatimin e secilës masë dhe çdo ndërhyrje brenda masës është përcaktuar në planin e veprimit të Strategjisë i cili është paraqitur në Shtojcën 1. Ndërsa, nën aktivitetet e secilës ndërhyrje do të pasqyrohen në planin vjetor operativ të secilit institucion përgjegjës për zbatimin e Strategjisë.

Ministria do të krijojë Grupin Koordinues për Polikat e Integtuara për Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor si dhe Grupi tematik për Mbrojtjen Sociale si mekanizmin kryesor për koordinimin dhe monitorimin e zbatimit të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale, i cili do të drejtohet nga Zëvendësministri për mbrojtjen sociale dhe do të përbëhet nga zyrtarë përgjegjës të Ministrisë, si dhe të Shërbimit Social Shtetëror dhe Inspektoriatit të Punës dhe të Shërbimeve si dhe të Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë dhe institucionit të saj të varësisë në fushën e formimit dhe të punësimit dhe të mbrojtjes sociale, sidhe përfaqësues të donatorëve dhe partnerëve kryesor strategjik. Detyrat dhe përgjegjësit e Grupit Koordinues janë:

- Shqyrtimi i progresit në zbatimin e Strategjisë në bazë të informatave të mbledhura;
- Ofrimi i mbështetjes teknike dhe udhëzimeve për njësitë organizative të Ministrisë, institucioneve vartëse dhe institucioneve tjera përkatëse në të gjitha aspektet që lidhen me zbatimin e Strategjisë;
- Shqyrtimi dhe miratimi i masave ose/dhe veprimeve plotësuese për të siguruar zbatimin e Strategjisë;
- Përgatitja e raporteve periodike të progresit dhe monitorimit të zbatimit të Strategjisë si dhe paraqitja e raporteve të rregullta të progresit pranë Qeverisë së Shqipërisë;
- Organizimi i takimit me partnerë më të gjerë si dhe paraqitja e raporteve të rregullta të progresit;
- Organizimi i ushtrimit të vlerësimit të jashtëm dhe reflektimi i gjetjeve kryesore në përgatitjen e planit të veprimit, etj.

Takimet e Grupit Koordinues do të mbahen së paku dy herë në vit dhe sipas nevojës mund të organizohen takime më të shpeshta. Gjatë përcaktimit të masave si dhe përgatitjes së planit të veprimit ka pasur një bashkërendim të mirë me nismat mes partnerëve zhvillimorë të Qeverisë, ku bëjnë pjesë donatorët, si dhe organizata vendore dhe ndërkombëtare që kanë shprehur gatishmërinë e tyre për të kontribuar në zbatimin e Strategjisë. Ky bashkërendim do të vazhdojë edhe gjatë zbatimit dhe rishikimit të Strategjisë. Për këtë qëllim, Grupi Koordinues do të mbajë së paku një herë në vit takime me partnerë zhvillimor të Qeverisë si dhe me partnerët social për të paraqitur progresin dhe sfidat kryesore me të cilat ballafaqohen gjatë zbatimit të Strategjisë.

Një ndër aspektet e rëndësishme të zbatimit është vlerësimi i kapaciteteve të strukturave në nivel qendror dhe rajonal për të garantuar që angazhimet e ndërmarra në këtë strategji do të realizohen. Vlerësimi i nevojës për burime njerëzore, financiare dhe rishikimet e nevojshme të strukturave zbatuese do të jetë hapi i parë për të ndërtuar strategjinë për garantimin e zbatimit në praktikë.

Strategjia do të jetë pjesë përberëse e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) sipas Urdhërit të Kryeministrit nr. 157, miratuar me datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

## V. Monitorimi dhe Vlerësimi

Monitorimi është një proces i vazhdueshëm i mbledhjes dhe analizimit të informacionit në lidhje me zbatimin e veprimeve dhe masave prioritare. Monitorimi gjurmon veprimet, ndërhyrjet, burimet financiare të alokuara dhe të shpenzuara në baza të rregullta dhe krahason ato me planin e veprimit për të vlerësuar se në çfarë mase po zbatohet Strategjia. Monitorimi i performancës nga ana tjetër, monitoron rezultatet e arritura në nivele të ndryshme: (i) masat prioritare, (ii) objektivat specifike dhe (iii) synimet afatgjata të cilat përcaktohen si qëllimet e politikës (siç është shkalla e punësimit) kundrejt çaqeve të caktuara. Monitorimi do të bëhet në bazë të informacionit të mbledhur rregullisht përmes sistemit të monitorimit. Megjithatë, monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve brenda masave prioritare, si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të bëhet në bazë të planit vjetor të punës së institucioneve përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë si dhe sipas planin e veprimit të Strategjisë. Nga ana tjetër, monitorimi i performancës ose monitorimi i rezultateve do të bëhet në bazë të kornizës së monitorimit dhe vlerësimit që është përgatitur për këtë qëllim (bashkëngjitur në Shtojcë 2) ku janë caktuar treguesit të performancës për masat prioritare, objektivat specifike dhe qëllimet kryesore të politikës dhe është përcaktuar përgjegjësia për mbledhjen e të dhënave.

Monitorimi i zbatimit të veprimeve dhe ndërhyrjeve si dhe monitorimi i burimeve financiare të alokuara dhe të shpenzuara do të realizohet nga Grupin Koordinues për zbatimin e Strategjisë së paku për çdo gjashtë (6) muaj, ndërsa monitorimi i performancës në baza vjetore. Ministria do të ketë përgjegjësinë të sistematizojë informacionin e monitorimit të gjeneruar nga institucione të ndryshme dhe të prezantojë në raportin që do t'i dorëzohet Qeverisë, por edhe do të diskutohet me akterë më të gjerë.

Sa i përket vlerësimit të Strategjisë do të kryhen dy ushtrime vlerësimi. Një pas përfundimit të fazës së parë të Strategjisë (2024-2026) dhe një në përfundim të Strategjisë (2030). Grupi Koordinues për zbatimin e Strategjisë do të jetë përgjegjës për koordinimin e vlerësimeve afatmesme dhe përfundimtare.

Ushtrimi i parë i monitorimit dhe vlerësimit do të analizojë zbatimin e masave prioritare si dhe rezultatet e arritura. Duke bërë krahasimin me situatën bazë, vlerësimi i ndërmjetëm do të nxjerrë në pah ndryshimet në kontekstin e përgjithshëm dhe do të gjykojë nëse objektivat, masat prioritare dhe ndërhyrjet mbeten të rëndësishme përpara fillimit të fazës së dytë të Strategjisë për periudhën 2026-2028. Ky vlerësim do të shqyrtojë gjithashtu nëse ka ende një koherencë të plotë midis objektivave të strategjisë dhe prioriteteve dhe politikave kombëtare. Vlerësimi i ndërmjetëm do të mbështetet në informacionin e nxjerrë nga sistemi i monitorimit dhe nga konteksti i përgjithshëm dhe do të ofrojë udhëzime për rishikimin e planit të veprimit të Strategjisë por edhe për hartimin e planeve operative më të detajuara vjetore për periudhën e ardhshme cili do të mbulojë periudhën 2026-2028. Pjesë e monitorimit dhe vlerësimit të përvitshëm dhe atij afatmesëm dhe përfundimtar do të jetë konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile.

Vlerësimi përfundimtar, që do të kryhet në vitet 2029 dhe 2030, do të gjykojë të gjithë ecurinë e Strategjisë. Ky vlerësim do të raportojë mbi efektivitetin (d.m.th. shkallën në të cilën janë arritur rezultatet e pritshme), rëndësinë (d.m.th. masën në të cilën objektivat e politikës së punësimit iu përgjigjën nevojave dhe prioriteteve kombëtare), efikasitetin (d.m.th. nëse objektivat u arritën me koston më të ulët të mundshme) dhe qëndrueshmërinë (d.m.th. masën në të cilën rezultatet, përfshirë ndryshimet institucionale, janë të qëndrueshme me kalimin e kohës) e masave prioritare të Strategjisë. Pjesë thelbësore e vlerësimit do të jetë analiza dhe vlerësimi financiar, përfshirë analizën e investimeve dhe hendeqeve financiare, vlerësimin e ndihmës së huaj si dhe evidentimin e instrumentëve financiar për të mbështetur zbatimin e plotë të strategjisë dhe synimit për arritjen e rezultateve.

VI. Burimet financiare për zbatimin e Strategjisë

<b>Buxheti Total 2024-2030 (ALL)</b>			
Qëllimi I politikës 1	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.1:		
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.2:		
	OBJEKTIVI SPECIFIK 1.3:		
Qëllimi I politikës 2	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.1:		
	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.2:		
	OBJEKTIVI SPECIFIK 2.3:		
		<b><u>Total</u></b>	

## VII. Shtojcat

- Matrica për Monitorim dhe Vlerësim
- Plani i Veprimit i kostuar

DRAFT